

SFG2276 REV



RAPORT

**Projekti për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin
Kuadri i Menaxhimit Mjedisor dhe Social**

Përgatitur nga

Dr. Zef PREÇI, Ekspert i Mbrojtjes Sociale

Prof. Dr. Seit SHALLARI, Ekspert i Mjedisit

Rishikuar nga:

Njësia Mjedimore dhe Sociale e FSHZH-së

Korrik 2020

LISTA E SHKURTESAVE

ACER	Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
FSH	Financim Shtesë
SMB	Strategjia për Menaxhimin e Bregdetit
NJMS	Njësia Mjedisore dhe Sociale
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VNM	Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor
KMMS	Kuadri i Menaxhimit Mjedisor dhe Social
PMMS	Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social
QSH	Qeveria e Shqipërisë
MSHA	Mekanizmi i Shqyrtimit të Ankesave
IMK	Instituti i Monumenteve të Kulturës
ZRPP	Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
KVA	Komisioni Vendor i Ankesave
NJQV	Njësi e Qeverisjes Vendore
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AKZM	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
SKZHT	Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Territorit
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
MZHU	Ministria e Zhvillimit Urban
POM	Plani Operacional i Menaxhimit
ZM	Zonë e Mbrojtur
PPP	Persona të Prekur nga Projekti
NJKP	Njësi Koordinuese e Projektit

PZHIUT	Projekti për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin
PVR	Plani i Veprimit për Risistemimin
KPR	Kuadri i Politikave të Risistemimit
BB	Banka Botërore

Përmbledhje Ekzekutive

Qeveria e Shqipërisë, përmes Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, kërkon Fonde Shtesë (FSH) nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka) për të mbështetur zgjerimin e Projektit aktual për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin (PZHIUT), për financimin e zhvillimit të integruar urban dhe turizmit, si dhe zgjerimin e tregut të turizmit dhe zhvillimin e produkteve në vendndodhje të reja në jug të Shqipërisë. Investimet për zgjerim do të përqendrohen në Ksamil dhe Orikum, të cilat lidhen me bashkitë pjesëmarrëse në Projektin mëmë. FSH-ja tregoi nevojën për të përditësuar raportin e KMMS-së, me qëllim mbulimin e objektit të zgjeruar.

Objektivi i Kuadrit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (KMMS) është përgatitja për të vlerësuar, për të analizuar, dhe për të shqyrtuar ndikimin mjedisor dhe social të aktiviteteve në lidhje me zhvillimin, në suazën e komponentëve të zgjeruar të PZHIUT-së. Rrjedhimisht, KMMS-ja përcakton masa zbutëse të përshtatshme duke shmangur, duke eliminuar ose duke ulur ndikimin e mundshëm negativ mjedisor dhe social. Krahas kësaj, KMMS-ja përcakton dispozita për përlogaritjen dhe buxhetimin e kostove të masave alternative, si pjesë e zbatimit të udhëzimeve për zbutjen.

Qasja ndaj KMMS-së përfshin rishikimin dhe përditësimin e raportit të mëparshëm të KMMS-së për PZHIUT-në, duke ndërthurur objektin e zgjeruar. Për këtë arsye, aktivitetet kyçe parashikojnë rishikimin e dokumenteve të mëparshme të projektit dhe literatura të ndryshme, krahas angazhimit të palëve të interesit me disa aktorë të tjerë të identifikuar të projektit. Aktivitete të tjera përfshijnë përgatitjen e formularëve me lista kontrolli për shqyrtimin mjedisor dhe social.

Objektivat e zhvillimit të projektit janë:

- përmirësimi i infrastrukturës urbane;
- përmirësimi i aseteve turistike; dhe
- forcimi i kapacitetit institucional për të mbështetur zhvillimin ekonomik vendor në lidhje me turizmin, në zonat e përzgjedhura në jug të Shqipërisë.

Komponentët fillestarë të Projektit janë si vijon:

- Komponenti 1. Përmirësimi i Urbanistikës dhe Infrastrukturës – 44.3 milionë euro)
- Komponenti 2 (Përmirësimi i Zonave Turistike – 8.4 milionë euro)
- Komponenti 3 (Tregu i Turizmit dhe Zhvillimi i Produkteve – 7.7 milionë euro)
- Komponenti 4 (Mbështetje në Zbatim – 3.2 milionë euro)

FSH-ja do të përdoret për të mbështetur aktivitetet e mëposhtme, që përmbushin objektivin e zhvillimit të Projektit:

- Komponenti 1: Përmirësimi i Urbanistikës dhe Infrastrukturës (27.05 milionë euro – 30.52 milionë amerikanë nga FSH-ja). Zgjerimi i investimeve në përmirësimin e urbanistikës dhe infrastrukturës në dy vendndodhje të reja në jug të Shqipërisë, përkatësisht Ksamili dhe Orikumi.
- Komponenti 3: Tregu i Turizmit dhe Zhvillimi i Produkteve (1.3 milionë euro – 1.46 milionë amerikanë nga FSH-ja). FSH-ja do të përdoret për t'i mbështetur bashkitë në përshtatjen me ndryshimet e kushteve të tregut, në kuadër të pandemisë së shkaktuar

nga COVID-19, si në promovim, ashtu edhe në prezantim (duke marrë parasysh distancimin fizik dhe social, kërkesat për pajisjet e mbrojtjes personale (PMP), hyrjen dhe daljen pa kontakt fizik në zonat turistike, etj.)

- Komponenti 4: Mbështetje në Zbatim (1.5 milionë euro – 1.6 milionë dollarë amerikanë nga FSH-ja). Krahas kësaj, FSH-ja do të përdoret për rritjen e financimit të kostove operative, duke mbajtur parasysh shtyrjen e datës mbyllëse të huasë për FSH-në.

Legjislacioni dhe rregulloret përkatëse për mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri janë si vijon:

- Kuadri ligjor kombëtar mbi mjedisin
- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit
- Ligji për Zonat e Mbrojtura dhe Biodiversitetin
- Kuadri për Mbrojtjen e Mjedisit Fizik
- Ligji për Procedurën e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor
- Ligji dhe Rregullorja në fushën e trashëgimisë kulturore

Politikat e Mbrojtjes të Bankës Botërore, që synojnë mbështetjen e objektivave të zhvillimit të projektit, përfshijnë Vlerësimin Mjedisor (OP/BP 4.01), Habitatet Natyrore (OP/BP 4.04), Burimet e Kulturës Fizike (OP/BP 4.11), dhe Risistemimin e Pavullneshëm (OP/BP 4.12), Pylltarinë (OP 4.36), Menaxhimin e Insekteve (4.09), si dhe Udhëzimet e Bankës Botërore për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë.

Rreziqet dhe ndikimet mjedisore dhe sociale të mundshme që lidhen me aktivitetet specifike të komponentëve të projektit dhe masat zbutëse janë si vijon:

Ndikimi Mjedisor, Social dhe Shëndetësor	Masat zbutëse të propozuara
Cilësia e Ajrit	<p>Faza e ndërtimit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ngarkesat e dherave/rërës dhe çimentos gjatë transportit do të mbuloohen mirë për të reduktuar ngritjen e niveleve të pluhurit mbi ato të pranueshme. • Grumbujt e dherave të ekspozuar dhe rrugët e pashtuara të kalimit do të spërkaten me ujë për të kontrolluar nivelet e pluhurit. • Do të përdoren karburant dhe lubrifikantë cilësorë në automjete, pajisje dhe makineri. • Do të sigurohet që pirgjet me rërë që transportohen për punimet e ndërtimit të jenë të mbuluara me mushama të gomuar për të parandaluar shpërhapijen e grimcave të dheut me anë të erës dhe ujit. • Do të fiken motorët e automjeteve, makinerive dhe pajisjeve të tjera kur nuk janë në përdorim. • Do të kryhet shërbim dhe mirëmbajtje e rregullt e planifikuar e të gjitha mjeteve dhe pajisjeve për të minimizuar emetimet e gazrave. • Punimet e ndërtimit dhe ato civile do të pakësohen ose do kontrollohen për të reduktuar emetimet nga pajisjet dhe makineritë në përdorim. <p>Faza operationale</p> <ul style="list-style-type: none"> • Do të vendosen shenja të përshtatshme rrugore në rrugët me pluhur për të kufizuar shpejtësinë e mjeteve • Do të vendosen rampa shpejtësie të projektuara dhe të ndërtuara siç duhet në rrugët e kalimit
Dridhja dhe Zhurma	<p>Faza e ndërtimit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Gërmimet dhe veprimtaritë ndërtimore do të kryhen gjatë orëve të ditës. • Betonieria, makineritë dhe pajisjet e tjera të ndërtimit do të vendosen larg receptorëve mjedisorë të ndjeshëm. • Pajisjet dhe makineritë e ndërtimit do të mirëmbahen dhe do t'iu kryhet rregullisht shërbimi për të reduktuar prodhimin e zhurmës gjatë përdorimit. • Do të fiken motorët e mjeteve, makinerive dhe pajisjeve të tjera kur nuk janë në

	<p>përdorim.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Punimet tokësore dhe veprimtaritë e tjera ndërtimore do të pakësohen ose do të kontrollohen për të reduktuar prodhimin e zhurmës gjatë ndërtimit. • Banorët fqinjë dhe aktivitetet tregtare do të njoftohen paraprakisht lidhur me projektin, përpara përgatitjes së kantierit nga Kontraktori • Puna nuk do të kryhet gjatë orareve/periudhave të ndjeshme të ditës/vitit, me qëllim shmangien e shqetësimit të faunës. <p>Faza Operacionale</p> <ul style="list-style-type: none"> • Do të vendosen shenja të dukshme në vende të posaçme, që lajmërojnë turistët për zhurma të larta të Cilat mund të shqetësojnë faunën apo aktivitete të tjera.
Ndërhyrjet Pamore	<ul style="list-style-type: none"> • Do të njoftohet publiku mbi projektin nëpërmjet shenjave dhe tabelave të posaçme përpara aksesimit të kantierëve nga ana e Kontraktorit; • Aktivitetet ndërtimore do të kryhen në seksione, me qëllim reduktimin e ndikimeve të ndryshimit dhe ndërhyrjeve pamore për publikun e përgjithshëm. • Kantieret e ndërtimit do të jenë të veçuara nga publiku. • Në kantieret e ndërtimit do të ndiqen masat e mirëmbajtjes së duhur, si pastrimi. • Do të sigurohet një kantier i pranueshëm pas ndërtimit sipas dispozitave të kontratës. • Objektet për turistët do të projektohen dhe do të ndërtohen në mënyrën e duhur për t'u përshtatur me mjedisin natyror.
Ndotja e burimeve të ujit	<p>Faza e ndërtimit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Punimet nuk do të ekzekutohen në kushte atmosferike agresive, si reshjet e shiut ose stuhitë. • Në asnjë seksion të vijave ujore nuk do të hidhen mbetje të ngurta, karburante ose naftë. • Ndërtimi do të kryhet në seksione për të minimizuar ndikimet dhe ekspozimin e dherave. • Materialet e gërmuara dhe lymi, që nuk mund të përdoren, do të hidhen në zonat e përshtatshme sipas Planit të Menaxhimit të Mbetjeve të përgatitur nga Kontraktori dhe të miratuar nga Asambleja. • Në zona të pjerrëta do të ngrihen barriera të përkohshme sedimenti për të parandaluar depërtimin e lymit në rrjedhat ujore. • Mirëmbajtja, mbushja me karburant dhe pastrimi i automjeteve dhe pajisjeve do të kryhet në punishte, jashtë kantierit, duke zbatuar masa të përshtatshme për parandalimin e rrjedhjeve. <p>Faza operacionale</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në zonat turistike do të ngrihen mjedise të përshtatshme sanitare për shmangien e shkarkimit të mbetjeve në trupat ujorë. • Komunitetet pritëse do të pajisjen me tualete të mjaftueshme dhe do të sensibilizohen për përdorimin e tyre, me qëllim shmangien e kryerjes së nevojave në publik.
Prodhimi dhe hedhja e mbetjeve	<p>Duhet të zbatohen parimet e Reduktimit, Riciklimit, Ripërdorimit dhe Rikuperimit për menaxhimin e mbetjeve nëpërmjet veprimeve të mëposhtme:</p> <p>Faza e ndërtimit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Materialet e gërmuara nga toka, në masën maksimale të mundshme, do të ripërdoren për mbylljen e gropave, me qëllim reduktimin e mbetjeve. • Mbetjet e ngurta të gërmuara nga kanalet e kullimit që janë të papërshtatshme për mbylljen e gropave do të grumbullohen në kantier, do të lihen të zbrazen dhe do të grumbullohen për t'u hedhur në landfillet e miratuara. • Do të sigurohet dorëzimi i numrit të nevojshëm të materialeve të ndërtimit në kantier, me qëllim reduktimin e gjasave për tepricë materialesh. • Do të vendosen kosha në kantier për mbajtjen e përkohshme të mbeturinave, si: mbajtësit e lubrifikantëve, pakot e ujit të pijshëm dhe çantat mbajtëse/materialet e paketimit. • Do të sigurohet përdorimi i duhur i materialeve të ndërtimit, si tubat, lateritet, rëra etj., për të reduktuar mbetjet. • Kontraktori do të punojë sipas një Plani të përgatitur dhe të miratuar për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta. <p>Faza Operacionale</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në pika të posaçme do të vendosen kosha mbeturinash për përdorim nga publiku. • Në vende të përshtatshme do të vendosen shenja paralajmëruese kundër ndotjes, bashkërisht me sanksionet e mundshme. • Do të kryhen ujdi me shoqëritë e grumbullimit të mbetjeve nëpërmjet Asamblesë, me qëllim grumbullimin dhe hedhjen e rregullt të mbetjeve të ngurta.
Shëndeti Publik, Siguria	Faza e ndërtimit

dhe Mbrojtja	<ul style="list-style-type: none"> • Punimet në kanalet e ekspozuara dhe materialet nga toka, në masën maksimale të mundshme, do të përfundojnë përpara gërmimeve të reja dhe hapjes së kanaleve të reja. • Zonat e punimeve do të kufizohen në mënyrën e duhur, me qëllim shmangien e shkelësve kureshtarë, veçanërisht fëmijëve. • Përreth zonave të punimeve do të vendosen shenja paralajmëruese për të shkurajuar shkelësit. • Kontraktorët do të garantojnë sigurinë e duhur në kantieret e ndërtimit për të shmangur vjedhjen ose shkatërrimin e pronës. • Do të sigurohet shikueshmëri gjatë natës nëpërmjet ndriçimit të përshtatshëm. <p>Faza Operacionale</p> <ul style="list-style-type: none"> • Duhet të nxiten drejtuesit e komunitetit që të krijojnë komitete vëzhgimi për të përmirësuar sigurinë • Duhet të punohet me policinë për të ngritur pika policie në të gjitha pikat turistike kryesore • Pikat e ndihmës së parë do të jenë të disponueshme në të gjithë kantieret me përshtatjet e duhura me pikat shëndetësore vendase për të trajtuar urgjencat.
Shëndeti dhe Siguria në Vendin e Punës	<p>Faza e ndërtimit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Duhet të angazhohen mjeshtër me përvojë për punimet e ndërtimit. • Të gjithë punonjësve duhet t’iu ofrohen udhëzime/orientime të përshtatshme mbi sigurinë. • Kontraktorët do të kenë Politika dhe Procedura për Shëndetin dhe Sigurinë me qëllim orientimin e veprimtarive të ndërtimit. • Pajisjeve dhe makinerive do t’iu kryhen shërbimet rregullisht për të siguruar që janë në gjendje të mirë pune. • Duhet të mundësohen kuti të ndihmës së parë në kantier, si dhe një person i trajnuar për dhënien e ndihmës së parë, duhet të mundësohen dhe të zbatohet përdorimi i pajisjeve të mbrojtjes personale (PMP) të përshtatshme, si: çizme mbrojtëse, xhaketa reflektuese, kaska, doreza për duart, tapa veshësh, maska mbi hundë, etj. • Do të kërkohet një dëshmi kompetence për të gjithë operatorët e pajisjeve/makinerive dhe kjo do të vërtetohet nëpërmjet shqyrtimit të licensave ose dokumenteve të vlefshme të drejtuesve ose operatorëve. • Do të kërkohet përmbushja e të gjitha rregullave dhe rregulloreve në kantier. • Do të vendosen sanksione në rastet e mosrespektimit të procedurave të sigurisë. ✓ Takimet në kantier duhet të rrisin ndërgjegjësimin mbi Shëndetin dhe Sigurinë në Punë. <p>Faza Operacionale</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mbikëqyrësit e parkut do të pajisjen me PMP për mbrojtjen kundër kafshëve të rrezikshme • Mbikëqyrësit e parkut do të armatosen për mbrojtjen kundër gjuetarëve pa leje. • Pikat e ndihmës së parë do të jenë të disponueshme në të gjithë kantieret me përshtatjet e duhura me pikat shëndetësore vendase për të trajtuar urgjencat.
Problematikat e marrjes së tokës dhe kompensimit.	<ul style="list-style-type: none"> • Konsultimi me pronarët/përdoruesit/komunitetet e pronës në fjalë dhe marrja e miratimit të tyre në fazën e hershme të procesit të zhvillimit të projektit • Lejimi i personave të prekur që të rikuperojnë pronat e tyre (duke përfshirë të mbjellat) përpara mobilizimit të kantierit për fillimin e punës • Sigurimi i pagesës së kompensimit të drejtë dhe duhur për të gjithë personat e prekur përpara nisjes së veprimtarive të ndërtimit në përputhje me dispozitat e KPZH-së. • Marrja e lejeve të zhvillimit të kërkuara nga Asambletë përkatëse përpara fillimit të punës
Mbajtja e mjeteve të jetesës	<ul style="list-style-type: none"> • Duhet të sigurohet pagesa e kompensimeve të përshtatshme ndaj PPP-ve sipas KPZH-së. • Komuniteteve vendase do t’iu jepen mundësi punësimi dhe të tjera sa më shumë të jetë e mundur.
Rreziku natyror	<ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i një Plani të Gatishmërisë dhe Reagimit në rast Emergjence (PGRE) nga ana e Njësisë Zbatuese të Projektit në përputhje me Udhëzimin e Bankës Botërore për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë. PGRE duhet të përmbajë minimalisht informacion të përcaktuar në Udhëzimin e Bankës Botërore për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë. • Duhet të vendosen fikse të zjarrit në vende të ndryshme të zonës së projektit • Duhet të kryhen përshtatje për menaxhimin e fatkeqësive në zonat me gjasa për fatkeqësi
Rreziqet e zjarrit	<ul style="list-style-type: none"> • Caktimi i një pike grumbullimi në rast zjarri

	<ul style="list-style-type: none">• Caktimi i zonave të posaçme për ndezjen e zjarreve në kampin e ndërtimit• Zhvillimi i planit të gatishmërisë dhe reagimit në rast emergjence nga ana e Kontraktorit në përputhje me Udhëzimet e Bankës Botërore për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë
--	---

Përgjegjësia e përgjithshme për zbatimin e projektit bie mbi FSHZH-në. NJKP-ja, nën Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë do të kryejë mbikëqyrjen dhe udhëzimin e NJZP-së. NJZP-ja do të jetë përgjegjëse për koordinimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të përditshëm të projektit.

Përgjegjësia për monitorimin mjedisor në terren të aktiviteteve të kontraktorit do të bjerë mbi NJZP-në, me mbështetjen e NJQV-ve. Një konsulent i pavarur i punësuar nga MZHU-ja do të jetë përgjegjës për monitorimin sociale, me mbikëqyrjen dhe udhëzimet e Bankës Botërore.

Krijimi i kapaciteteve do të përfshijë workshop-e trajnuese dhe hartimin e raporteve udhëzuese, si dhe zhvillimin e instrumenteve. Programet trajnuese të propozuara që do të zbatohen për krijimin e kapaciteteve të ekipit zbatues të projektit paraqiten në raportin kryesor.

LISTA E TABELAVE

Tabela 1	Legjislacioni Shqiptar për Biodiversitetin në lidhje me Projektin	13
Tabela 2:	Legjislacioni për Mbrojtjen e Mjedisit Fizik	14
Tabela 3.	Ligjet e miratuara pas ratifikimit të konventave ndërkombëtare nga Republika e Shqipërisë	20
Tabela 4	Legjislacioni për Shëndetin dhe Sigurinë	20
Tabela 5	Legjislacioni Kombëtar Përkatës	21
Tabela 6	Konventa Ndërkombëtare të Nënshkruara/Ratifikuara nga Shqipëri	22
Tabela 7	Zonat e Mbrojtura në Rajon	30
Tabela 8	Ndikimi Mjedisor dhe Social dhe Zbutja	33
Tabela 9	Plani i Propozuar i Ndërtimit të Kapaciteteve	41
Tabela 10	Monitorimi Mjedisor dhe Social	48

LISTA E FIGURAVE

Figura 1	Procedura e dhe Kohështrirja e VNM-së sipas Legjislacionit Shqiptar	18
Figura 2	Harta e Shqipërisë sipas Sesionit Hartografik të OKB-së	27
Figura 3	Hartë e Zonave të Mbrojtura në Shqipëri	31
Figura 4	Grafiku i Procesit të MSHA-së	45

1. Hyrje

1.1 Informacione paraprake

Qeveria e Shqipërisë (QSH) aktualisht po zbaton reformat e zhvillimit rajonal, që synojnë arritjen e kohezionit territorial më të madh, duke ulur pabarazitë rajonale në aksesin ndaj shërbimeve, si dhe duke mbështetur zhvillimin me anë të aseteve rajonale dhe vendore ekzistuese. Krahas kësaj, pritet që në planin afatmesëm, reforma të kontribuojë në aderimin në Bashkimin Evropian (BE) dhe përthithjen e fondeve të zhvillimit rajonal.

Turizmi është identifikuar si një ndër faktorët shtytës të rritjes ekonomike dhe krijimit të vendeve të punës në Shqipëri. Industria e turizmit ka rol madhor në ekonomi, duke dhënë një kontribut të drejtpërdrejtë prej 2.8 për qind të produktit të brendshëm bruto (PBB) në vitin 2019. Ky kontribut është edhe më i madh duke marrë parasysh efektin e tërthortë të shpenzimeve të turistëve në aktivitetet ekonomike të tjera, që në vitin 2019 arrinin 21.2%.¹ Kontributi në punësim është i madh, duke mbështetur drejtpërdrejtë 58,000 vende pune në vitin 2017, dhe përllogaritet që ky numër do të arrijë deri në 220,000 në vitin 2025.²

QSH-ja e ka identifikuar jugun e Shqipërisë, si prioritet për zhvillimin rajonal, duke marrë parasysh potencialin turistik me burime natyrore unike dhe asete të trashëgimisë kulturore. Megjithatë, ekzistojnë disa pengesa që nuk e lejojnë jugun e Shqipërisë të realizojë potencialin e plotë ekonomik dhe turistik. Këto pengesa përfshijnë infrastrukturë urbane bazë të papërshtatshme, menaxhim të pakoordinuar të aktiviteteve turistike, si dhe aktivitete turistike që nuk diversifikohen mjaftueshëm.

Vitin e kaluar, Qeveria e Shqipërisë, nëpërmjet Ministrisë së Zhvillimit Urban (MZHU), hartoi instrumente strategjike me rëndësi për zhvillimin e territorit në nivel kombëtar, duke përfshirë jugun e Shqipërisë. Instrumentet strategjike përfshijnë Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin e Territorit (SKZHT) dhe Strategjinë për Menaxhimin e Bregdetit (SMB). Këto dokumente strategjike (SKZHT, SMB) mundësojnë një vizion të shëndoshë dhe një drejtim strategjik për zhvillimin e vendit për 15 vitet në vazhdim (2015-2030). Me deklaratën e saj mjedisore më 9 maj 2016, Ministria e Turizmit miratoi një Vlerësim Mjedisor Strategjik (VMS) të këtyre dy strategjive³.

Projekti i vazhdueshëm për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin (PZHIUT) ndjek qasjen për zhvillimin e integruar urban dhe turizmin, duke u përqendruar te: (i) përmirësimi i infrastrukturës urbane për t'i bërë më tërheqëse dhe të qëndrueshme katër qendrat urbane në jug të Shqipërisë, përkatësisht Beratin, Gjirokastrën, Sarandën dhe Përmetin; (ii) përmirësimi i imazhit turistik dhe menaxhimi i qëndrueshëm i aseteve të përzgjedhura të trashëgimisë kulturore në jug të Shqipërisë; (iii) forcimi i kapaciteteve bashkiake për të ofruar shërbime dhe menaxhimi i destinacioneve turistike, në bashkëpunim me Qeverinë e Shqipërisë.

Qeveria e Shqipërisë kërkon Fonde Shtesë (FSH) nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka) për të mbështetur zgjerimin e aktiviteteve aktuale të PZHIUT-së, për

¹Këshilli Botëror i Turizmit dhe Udhëttimeve. Raport Ekonomik për Shqipërinë 2019.

²INSTAT. Shqipëri. Turizmi në shifra. 2018, 2019.

³<http://www.mjedisi.gov.al/al/dokumenta/vleresimi-strategjik-mjedisor-vsm>

financimin e zhvillimit të integruar urban dhe turizmin, si dhe zgjerimin e tregut të turizmit dhe zhvillimin e produkteve në vendndodhje të reja në jug të Shqipërisë. Investimet për zgjerim do të përqendrohen në Ksamil dhe Orikum, të cilat lidhen me bashkitë pjesëmarrëse në Projektin mëmë.

FSH-ja do të ndjekë të njëjtën qasje për zhvillimin e integruar urban dhe turizmin. Fushëveprimi i FSH-së do të ndjekë objektivat fillestare të zhvillimit të projektit (OZHP), të cilat do të mbeten të pandryshuara. FSH-ja do të përdoret për mbështetjen e komponentëve të mëposhtëm:

- Komponenti 1: Përmirësimi i Urbanistikës dhe Infrastrukturës
- Komponenti 3: Tregu i Turizmit dhe Zhvillimi i Produkteve
- Komponenti 4: Mbështetje në Zbatim

FSH-ja nuk do të nxisë masa mbrojtëse shtesë. Projekti i PZHIUT-së klasifikohet si kategoria B, në përputhje me WB OP/BP 4.01, mbi Vlerësimin Mjedisor. Parashikohet që ky klasifikim do të përdoret edhe për FSH-në, pasi në kuadër të projektit mëmë do të ketë edhe investime të ngjashme.

1.2 Qëllimi dhe Objektivat e KMMS-së

Duke qenë se vlerësimi teknik (p.sh. studimet e fizibilitetit, projektimet e detajuara) dhe vendndodhjet e ndërhyrjeve specifike në kuadër të projektit nuk do të identifikohen dhe/ose përgatiten plotësisht, dhe ndikimi i tyre specifik nuk do të dallohet nga vlerësimi i projektit, KMMS-ja për Projektin mëmë u rishikua dhe u përditësua në përputhje me kërkesat e legjislacionit dhe rregulloreve kombëtare të Shqipërisë, dhe politikave të mbrojtjes së Bankës Botërore. KMMS-ja parashtron parimet, udhëzimet dhe procedurat për të vlerësuar ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale. Përcakton masat dhe planet e përshtatshme për të shmangur, për të reduktuar, për të zbutur dhe/ose për të zvogëluar ndikimet mjedisore dhe sociale, si pjesë të përgatitjes së nënprojekteve. Krahas kësaj, jep udhëzime për shëndetin dhe sigurinë e stafit, punonjësve dhe përfituesve të projektit.

KMMS-ja përvijon parimet dhe procedurat për vlerësimin dhe zbutjen e ndikimit, rregullimet institucionale, shqyrtimin e ankesave, konsultimin, pjesëmarrjen, dokumentacionin dhe raportimin, deklaratën për mospranimin e përgjegjësisë, monitorimin dhe vlerësimin, si dhe trajnimin dhe buxhetimin. Veç kësaj, ofron formate të termave të referencës (TeR) për kryerjen e VNMS-së, PMMS-së dhe vlerësimit social të projektit. KMMS-ja shërben si instrument i mbrojtjes mjedisore dhe sociale për të ofruar një kuadër që agjencitë përkatëse të përgatitin dhe të zbatojnë projektin e PZHIUT-së.

Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS) specifik për investimet e identifikuarat gjatë zbatimit të projektit mëmë do të përdoret si shembull i mirë për t'u ndjekur. Formatit për PMMS-në specifike paraqitet në Aneks. PMMS-ja dhe Kuadri i Politikës së Risistemimit (KPR), përgatitur në kuadër të Projektit të PZHIUT-së, përvijon udhëzimet dhe procedurat për të vlerësuar dhe për të zbutur ndikimet mjedisore dhe sociale, që lidhen me zbatimin e projektit, çka do të ndiqet edhe nga FSH-ja. Ky KMMS do të jetë pjesë integrale e Manualit Operacional të Projektit (MOP) dhe lidhet me të gjitha investimet e financuara në zonat e projektit, pavarësisht burimit të financimit apo agjencisë zbatuese.

2.0 Përshkrimi i Projektit

2.1 Objektivat dhe Komponentët e Projektit

Projekti i propozuar i PZHIEU-së do të jetë një katalizator për zhvillimin rajonal në Jug të Shqipërisë, duke nxitur përfitimin e fondeve nga partnerët e tjerë të zhvillimit dhe Fondi i Zhvillimit Rajonal. Projekti do të mbështesë vizionin e Qeverisë Shqiptare për të promovuar zhvillimin rajonal duke përmirësuar infrastrukturën urbane, rritjen e vlerave kulturore dhe forcimin e kapaciteteve institucionale për të mbështetur zhvillimin ekonomik vendor në zonat e përzgjedhura në Jug të Shqipërisë.

Projekti do të ofrojë një model për replikim në rajone të tjera për të përdorur një qasje të integruar për të nxitur ndihmat dhe sektorët konkurrues për një rritje të qëndrueshme ekonomike. SKZHT-ja dhe SMB-ja e identifikojnë turizmin dhe kulturën (turizmi me bazë kulturore) si një ndër faktorët shtytës kryesorë të zhvillimit ekonomik në Jug të Shqipërisë. Parashikohet që Projekti të financojë aktivitete që synojnë promovimin e zhvillimit të një ekonomike vendore të diversifikuar, konkurruese dhe të qëndrueshme, që shfrytëzon potencialin e njohur të sektorit të turizmit.

OZHP-të e Projektit mëmë janë:

- përmirësimi i infrastrukturës urbane;
- përmirësimi i asetëve turistike; dhe
- forcimi i kapacitetit institucional për të mbështetur zhvillimin ekonomik vendor në lidhje me turizmin, në zonat e përzgjedhura në jug të Shqipërisë.

Komponentët fillestarë të Projektit janë si vijon:

Komponenti 1. Përmirësimi i Urbanistikës dhe Infrastrukturës – 44.3 milionë euro financon përmirësimin e infrastrukturës në bashkitë e përzgjedhura (Berat, Përmet, Sarandë dhe Gjirokastrë), duke përfshirë përgatitjen e studimeve dhe projekteve të fizibilitetit, restaurimin e objekteve të përzgjedhura të trashëgimisë, dhe përmirësimin e hapësirave publike, rrjeteve rrugore, dhe infrastrukturës përkatëse.

Të gjitha studimet dhe punimet për rehabilitimin e infrastrukturës do të marrin parasysh rreziqet e ndryshimeve klimatike sipas vendndodhjes, dhe do t'i adresojnë përmes përgatitjes së një projekti të synuar. Krahas kësaj, përmirësimi i infrastrukturës do të rrisë efikasitetin e energjisë. Të gjitha ndërhyrjet e mbështetura nga projekti do të shpërndahen dhe do të diskutohen në publik për t'u siguruar se komentet e përfituesve dhe palëve të tjera të interesit do të merren parasysh në përzgjedhjen dhe projektimin e zonave, dhe se qytetarët do të informohen mbi rezultatet e procesit të konsultimi pas çdo workshop-i konsultimi me palët e interesit.

Komponenti 2 (Përmirësimi i Zonave Turistike – 8.4 milionë euro) financon investimet që synojnë përmirësimin e zonave turistike të përzgjedhura në korridorin turistik të Jugut të Shqipërisë, duke restauruar zonat e përzgjedhura të trashëgimisë dhe asetet kulturore, si dhe duke përmirësuar infrastrukturën turistike përkatëse, dhe përfshin përgatitjen e studimeve të fizibilitetit, planeve të menaxhimit dhe projekteve inxhinierike. Të gjitha studimet dhe punimet për përmirësimin e zonave do të marrin parasysh rreziqet e ndryshimeve klimatike sipas vendndodhjes, dhe do t'i adresojnë përmes përgatitjes së një projekti të synuar. Krahas

kësaj, përmirësimi i infrastrukturës do të rrisë efikasitetin e energjisë. Të gjitha ndërhyrjet e mbështetura nga projekti do të shpërndahen dhe do të diskutohen në publik për t'u siguruar se komentet e përfituesve dhe palëve të tjera të interesit do të merren parasysh në përzgjedhjen dhe projektimin e zonave, dhe se qytetarët do të informohen mbi rezultatet e procesit të konsultimi pas çdo workshop-i konsultimi me palët e interesit.

Komponenti 3 (Tregu i Turizmit dhe Zhvillimi i Produkteve – 7.7 milionë euro) synon forcimin e kapacitetit të bashkive për të ofruar shërbime bashkiake përmes ofrimit të sistemeve për menaxhimin e aseteve, sistemeve të informacioneve gjeografike, dhe pajisjeve për mbledhjen e mbetjeve të ngurta; si dhe krijimin e kapaciteteve për menaxhimin e zonave për të përmirësuar veprimtaritë e aseteve të rehabilituara. Krijimi i kapaciteteve do të përfshijë trajnime për ndryshimet klimatike (zbutja dhe përshtatja) që lidhen me turizmin në zonat e synuara. Masat për menaxhimin e mbetjeve do të kontribuojnë në reduktimin e emetimeve të gazeve serrë. Të gjitha aktivitetet e mbështetura nga projekti do të shpërndahen dhe do të diskutohen në publik për t'u siguruar se komentet e përfituesve dhe palëve të tjera të interesit do të merren parasysh në projektim, dhe se qytetarët do të informohen mbi rezultatet e procesit të konsultimi pas çdo workshop-i konsultimi me palët e interesit.

Komponenti 4 (Mbështetje në Zbatim – 3.2 milionë euro) ofron mbështetje për zbatimin e Projektit, duke përfshirë edhe M&V e Projektit dhe financimin e Kostove Operative të Rritura.

Financim Shtesë - korrik 2020

Në përgjigje të kërkesës zyrtare nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) më 14 maj 2020, dhe mbështetur mbi propozimin teknike nga FSHZH-ja më 21 korrik 2020, FSH-ja do të përdoret për të mbështetur zgjerimin e investimeve në dy vendndodhje të reja në jug të Shqipërisë, për përmirësimin e urbanistikës dhe infrastrukturës, si dhe për forcimin e tregut të turizmit dhe zhvillimit të produkteve, në kuadër të ndryshimeve të objektit dhe shkallës së kërkesës, si pasojë e krizës së COVID-19. Investimet për zgjerimin do të përqendrohen në Ksamil dhe Oriku, që lidhen ngushtësisht me bashkitë pjesëmarrëse në Projektin mëmë dhe zonat e tyre turistike. Investimet në Ksamil dhe Oriku do të jenë pjesë e fushëveprimit të Komponentit 1 dhe Komponentit 3 në kuadër të Projektit mëmë, duke përfshirë një kombinim të përmirësimit të aksesit me automjete, në këmbë, dhe mënyra të tjera në qytet dhe pika turistike, duke forcuar sistemet e gjurmëve dhe kalimeve të këmbësorëve, duke përmirësuar sistemet rrugore dhe zonat/parqet rekreative, si dhe duke përshtatur ripërdorimin e strukturave të përzgjedhura, dhe duke fuqizuar tregun e turizmit dhe zhvillimin e produkteve.

Financimi Shtesë dhe Ristrukturimi do të përdoren për të mbështetur aktivitetet e mëposhtme, që iu përgjigjen objektivave të zhvillimit dhe arsyesimit të Projektit, dhe paraqiten nga Komponentët e Projektit:

Komponenti 1: Përmirësimi i Urbanistikës dhe Infrastrukturës (27.05 milionë euro – 30.52 milionë amerikanë nga FSH-ja). FSH-ja do të përdoret për të mbështetur zgjerimin e investimeve për përmirësimin e urbanistikës dhe infrastrukturës, në dy vendndodhje të reja në jug të Shqipërisë, përkatësisht Ksamil dhe Oriku, që lidhen ngushtësisht me bashkitë dhe zonat turistike të mbështetura nga Projekti mëmë. Investimet shtesë treguese në këto bashki do të përshtaten me fushëveprimin aktual të Komponentit 1 në kuadër të Projektit mëmë, dhe ngjasojnë me investimet e vazhdueshme në kuadër të Komponentit 1 të Projektit, duke përfshirë një kombinim të përmirësimit të aksesit me automjete, në këmbë, dhe mënyra të

tjera në qytet dhe pika turistike, duke forcuar sistemet e gjurmëve dhe kalimeve të këmbësorëve, duke përmirësuar sistemet rrugore dhe zonat/parqet rekreative, si dhe duke përshtatur ripërdorimin e strukturave të përzgjedhura.

Krahas investimeve në këto dy vendndodhje të reja, FSH-ja e përzgjedhur do të mbështesë investime shtesë në përmirësimin e urbanistikës dhe infrastrukturës në bashkitë e Projektit aktual, përkatësisht Berati, Përmeti, Saranda dhe Gjirokastra, për të plotësuar kërkesën për investime shtesë në kuadër të Komponentit 1, që do të kontribuojë në objektivat e zhvillimit të Projektit, por nuk mund të mbulohet nga huaja fillestare. Këto investime shtesë do të identifikohen mbështetur në rezultatet e konsulencës së vazhdueshme për projektimin e përmirësimit të integruar urban për katër bashkitë, fondin e parashikuar për secilën bashki nga huaja fillestare, si dhe buxhetin e disponueshëm nga FSH-ja pas investimeve në Ksamil dhe Orikum.

Komponenti 3: Tregu i Turizmit dhe Zhvillimi i Produkteve (1.3 milionë euro – 1.46 milionë amerikanë nga FSH-ja). FSH-ja do të përdoret për t'i mbështetur bashkitë në përshtatjen me ndryshimet e kushteve të tregut, në kuadër të pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, si në promovim (më të synuar), ashtu edhe në prezantim (duke marrë parasysh distancimin fizik dhe social, kërkesat për pajisjet e mbrojtjes personale (PMP), hyrjen dhe daljen pa kontakt fizik në zonat turistike, etj.) të përvojave turistike. Ksamili dhe Orikumi, dy vendndodhjet e reja, lidhen ngushtësisht me bashkitë e mbështetura nga projekti mëmë. Aktivitetet treguese shtesë në këto bashki do të përshtaten me fushëveprimin aktual të Komponentit 3 në kuadër të Projektit mëmë dhe ngjasojnë me investimet e vazhdueshme në kuadër të Komponentit 3, duke përfshirë zhvillimin e produkteve të reja turistike, duke iu shtuar vlerë produkteve ekzistuese, duke forcuar zinxhirët e vlerës së turizmit, duke iu përshtatur protokolleve për COVID-19, si dhe duke synuar dhe duke i lidhur produktet në treg.

Komponenti 4: Mbështetje në Zbatim (1.5 milionë euro – 1.6 milionë dollarë amerikanë nga FSH-ja). Krahas kësaj, FSH-ja do të përdoret për rritjen e financimit të kostove operative, duke mbajtur parasysh shtyrjen e datës mbyllëse të huasë për FSH-në. Të gjitha kostot operative të rritura në mbështetje të menaxhimit të përditshëm të projektit, që do të kryhet nga agjencia zbatuese, do të financohen në kuadër të projektit. Këto shpenzime përfshijnë rogat (edhe tarifat sociale) të stafit të FSHZH-së, përgjegjës për zbatimin e projektit, si dhe shpenzimet e zyrës së doganave, krahas kostove për komunikim dhe udhëtim.

2.2 Përfituesit e Projektit

Përfituesit kryesorë të projektit të propozuar janë banorët e bashkive të përzgjedhura (Berat, Gjirokastrë, Sarandë dhe Përmet), që do të përfitojnë nga përmirësimi i infrastrukturës, objekteve, shtimi i mundësive ekonomike dhe për punësim, si rrjedhojë e fluksit të njerëzve në rajon, si dhe nga rritja e sigurisë dhe shëndetit të banorëve dhe vizitorëve. Vizitorët në jug të Shqipërisë do të përfitojnë nga përmirësimi i shërbimeve të infrastrukturës urbane dhe ofertave turistike. Në katër bashkitë jetojnë rreth 84,000 dhe jugu i Shqipërisë si i tërë vizitohet, çdo vit, nga 572,000 turistë. Qeveria do të përfitojë nga fitimet e rritura prej turizmit, shtimi i vendeve të punës si për banorët, ashtu edhe për jo banorët, si dhe përmirësimi i kapaciteteve institucionale të bashkive dhe agjencive qeveritare të përzgjedhura.

3.0 Kuadri rregullator, ligjor, dhe i politikave.

3.1 Kuadri Ligjor Kombëtar mbi Mjedisin

Kushtetuta e Shqipërisë, e cila është ratifikuar nga Parlamenti në vitin 1998, sanksionon të drejtën për një mjedis të shëndetshëm si një detyrim institucional për brezat e sotëm e të ardhshëm. Në dekadën e fundit, dhe veçanërisht që prej vitit 2001, janë hartuar dhe janë miratuar një sërë ligjesh dhe aktesh të tjera ligjore për mjedisin. Kuadri ligjor kombëtar është harmonizuar shumë me legjislacionin e BE-së. Në Shqipëri, kuadri ligjor që lidhet me çështjet mjedisore dhe socioekonomike, bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe përbëhet nga ligje dhe akte nënligjore rregullatore, si: Vendimet e Këshillit të Ministrave (VKM), akte në nivel ministrie, rregullore, udhëzime dhe standarde.

3.2 Ligji për mbrojtjen e mjedisit

Kuadri ligjor në fushën e mjedisit kryesohet nga ligji “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, Nr. 10431, datë 09.06.2011.3. Ky Ligj përcakton parimet, kërkesat, përgjegjësitë, rregullat dhe procedurat për të siguruar një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe përfshin dispozita për vlerësimin e ndikimit në mjedis, si një instrument për mbrojtjen e mjedisit duke identifikuar dhe duke vlerësuar efektet e mundshme të drejtpërdrejta dhe të tërthorta në mjedis dhe parandalimin e tyre.

Në nenin 6 të ligjit përcaktohet parimi i zhvillimit të qëndrueshëm ku parashikohet: “Autoritetet publike, përmes hartimit, miratimit dhe zbatimit të akteve normative, strategjive, planeve, programeve e projekteve brenda kompetencave të tyre, nxitin zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror, duke përdorur burimet natyrore në atë mënyrë që të plotësohen nevojat aktuale dhe të ruhet mjedisi, pa cenuar mundësinë e brezave të ardhshëm për të plotësuar nevojat e tyre”.

Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit mundëson politika kombëtare dhe vendore për mbrojtjen e mjedisit, kërkesat për përgatitjen e vlerësimit të ndikimit mjedisor dhe vlerësimin të strategjisë mjedisore, kërkesat për lejimin e aktiviteteve që ndikojnë në mjedis, parandalimin dhe reduktimin e ndotjes mjedisore, normat dhe standardet mjedisore, monitorimin dhe kontrollin e mjedisit, detyrat e institucioneve shtetërore në lidhje me problematikat mjedisore, rolin e publikut, si dhe sanksionet në rast të shkeljes së ligjit.

3.3 Ligji për zonat e mbrojtura dhe mbrojtjen e biodiversitetit

Ligji Nr. 8906, datë 06.06.2002 “Për zonat e mbrojtura”, parashtron kuadrin për shpalljen, administrimin, menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura dhe burimeve biologjike natyrore. Krahas kësaj, ligji formon bazën për zhvillimin dhe zbutjen e turizmit mjedisor dhe përfitime të tjera ekonomike, si dhe për ofrimin e informacioneve dhe edukimin e publikut të gjerë. Qëllimi kryesor i ligjit është ofrimi i mbrojtjes së veçantë të komponentëve më të rëndësishëm të rezervave natyrore, biodiversitetit dhe natyrës së përgjithshme, përmes zbatimit të rregullave të zonave të mbrojtura, mbështetur në sistemin e kategorive të Unionit Ndërkombëtar për Konservimin e Natyrës (UNKN)⁴. Krahas kësaj, ligji përcakton prioritetet dhe objektivat strategjike për menaxhimin e çdo kategorie të

zonave të mbrojtura.

Zona të mbrojtura në Shqipëri konsiderohen kryesisht hapësirat pyjore, të cilat administroheshin nga ish-Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave (DPPK), në sistemin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Pyjeve. Në kuadër të Ligjit Nr. 8906 /2002 “Për zonat e mbrojtura”, Ministria e Mjedisit ndërmoi rolin kryesor mbikëqyrës për zonat e mbrojtura në Shqipëri dhe është përgjegjëse për:

- Propozimet për zonat që duhet të vendosen në mbrojtje.
- Përgatitjen e procedurave ligjore dhe menaxhuese për propozimin dhe shpalljen e zonave të mbrojtura.
- Hartimin e planeve për menaxhimin e zonave të mbrojtura.
- Monitorimi/Rregullimi i menaxhimit në vazhdimësi.

Sipas ligjit për zonat e mbrojtura, ndonëse rolin kryesor menaxhues e luajnë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe DPPK-ja, duhen marrë parasysh edhe interesat e ministrive të tjera. Zonat e mbrojtura në Shqipëri përfshijnë: 15 Parqe Kombëtare, 5 Peizazhe të Mbrojtura, 4 Rezervate Strikte Natyrore, 26 Rezerva Natyrore të Menaxhuara, dhe zona të tjera të mbrojtura. Shumica e zonave të mbrojtura janë pajisur me sinjalistikë, ndërsa reformat për menaxhimin, si: krijimi i qendrave të informacionit, po zbatohen gradualisht⁵. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) është krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 102, datë 04.02.2015, dhe synon mbrojtjen, menaxhimin, zhvillimin dhe zgjerimin e sipërfaqes së zonave të mbrojtura, e cila aktualisht arrin në 16% e territorit të Shqipërisë. AKZM-ja menaxhon rrjetin e zonave të mbrojtura dhe rrjete të tjera si Natyra 2000.

Ministria e Mjedisit, përmes Drejtorisë së Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave Mjedisore dhe Jetësimit të Prioriteteve, mbulon çështjet në lidhje me hartimin e politikave për mbrojtjen e natyrës dhe dokumenteve strategjike në këtë fushë. Bashkëpunimi shtrihet në departamente të tjera të Ministrisë dhe me institucionet e mëposhtme zbatuese:

- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM);
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM);
- Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Pyjor;
- Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve.

Legjislacioni shqiptar për mbrojtjen e diversitetit që lidhet me Projektin përmbledhet në Tabelën 1 më poshtë:

³ Ky ligj është përafuar me Direktivën 2004/35/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 21 prill 2004 për detyrimet mjedisore, referuar parandalimit dhe korrigjimit të dëmtimit të mjedisit. Fletorja Zyrtare L 143 , 30/04/2004 P. 0056 - 0075

Tabela 1 Legjislacioni Shqiptar për Biodiversitetin në lidhje me Projektin

Legjislacioni	Vështrim i përgjithshëm
Ligji Nr. 9587 (20.07.2006)	“Për mbrojtjen e biodiversitetit” (i ndryshuar) - Ky ligji parashikon kërkesa për ruajtjen dhe mbrojtjen e diversitetit biologjik, duke përfshirë zonat e mbrojtura, habitatet dhe speciet e ndjeshme. Ligji kërkon vlerësimin biologjik, si pjesë e vlerësimit mjedisor dhe mbledhjes së të gjitha të dhënave përkatëse për procesin e vendimmarrjes.
Ligji Nr. 81/2017, datë 04.07.2017	“Për zonat e mbrojtura” - Ky ligj i qeveris të gjitha çështjet në lidhje me Zonat e Mbrojtura në Shqipëri. Përcakton kategoritë e zonave të mbrojtura në Shqipëri, rregullat e menaxhimit dhe rolet në procesin e vendimmarrjes. Kërkon përputhshmërinë me rregulla specifike gjatë aksesit, punës dhe kryerjes së aktiviteteve pranë dhe/ose brenda zonave të mbrojtura.
Urdhër Nr. 1280, datë 20.11.2013	“Për miratimin e listës së kuqe të florës dhe faunës së egër” (i ndryshuar) - Ky urdhër rendit statusin e konservimit të florës dhe faunës në Shqipëri.

Ligji Nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura” përcakton kategoritë e ndryshme dhe mënyrat e menaxhimit të ZM-ve në Shqipëri. Ligji Nr. 81/2017 për ZM përcakton 7 kategori të ZM-ve, ku secila kërkon shkallë të ndryshme të mbrojtjes, që janë konstatuar në fushën e studimit:

- Rezervë strikte natyrore/rezervat shkencor (kategoria I)
- Park kombëtar (kategoria II)
- Monument natyror (kategoria III)
- Rezervat natyror i menaxhuar/park natyror (kategoria IV)
- Peizazh i mbrojtur (kategoria V)
- Zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara (kategoria VI)
- Zona të mbrojtura me interes ndërkombëtar (asnjë kategori specifike e mbrojtjes)

Ligjet kyçe në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe zonat e mbrojtura janë si vijon:

- Ligji Nr. 5/2016, datë 04.02.2016 “Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji Nr. 11/2015, datë 19.2.2015 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen shumëpalëshe ndërmjet vendeve të Evropës Juglindore për zbatimin e konventës “Për vlerësimin e ndikimit mjedisor në kontekst ndërkufitar””
- Ligji Nr. 68/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9587, datë 20.7.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, të ndryshuar”
- Ligji Nr. 7/2014 “Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji Nr. 10234, datë 18.2.2010 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin “Për integrimin e menaxhuar të zonës bregdetare në Mesdhe”, të konventës së Barcelonës “Për mbrojtjen e mjedisit detar dhe të rajoneve bregdetare të Mesdheut”.
- Ligji nr. 9867, datë 31.01.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për tregtimin ndërkombëtar të llojeve të rrezikuara të faunës dhe florës së egër”

- Ligji Nr. 10 006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”
- Ligji Nr. 9587, datë 20.07.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”
- Ligji Nr. 8905, datë 06.06.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi” • Ligji Nr. 8906, datë 06.06.2002 “Për zonat e mbrojtura”
- Ligji Nr. 8294, datë 02.03.1998 “Për ratifikimin e Konventës së Bernës “Për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror të Evropës”
- VKM Nr. 31, datë 20.01.2016 “Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike për mbrojtjen e biodiversitetit”.
- VKM Nr. 102, datë 04.02.2015 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të inspektoratit shtetëror të mjedisit dhe pyjeve”.

3.4 Kuadri për mbrojtjen e mjedisit fizik

Shqipëria ka hartuar legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit fizik, duke përfshirë udhëzime, si dhe pragje dhe kufi emetimesh. Legjislacioni në lidhje me ujin, ajrin, emetimet e pajisjeve dhe automjeteve, cilësinë e karburanteve, mbetjet dhe ujin e ndotur, përmbledhet në Tabelën më poshtë:

Tabela 2: Legjislacioni për mbrojtjen e mjedisit fizik

Legjislacioni	Vështrim i përgjithshëm
Ligji Nr. 111/2012, i ndryshuar me Ligjin Nr. 6/2018	“Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, ndryshuar me Ligjin Nr. 6/2018 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, mbështetur në Direktivën Kuadër të Ujit 2000/60/KE. Qëllimi i ligjit përqendrohet në: (i) mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit ujor, të ujërave sipërfaqësore, qofshin të përkohshme apo të përhershme, të ujërave të brendshme detare, të ujërave territoriale, zonave ekonomike ekskluzive, shelfit kontinental, të ujërave ndërkuftare, të ujërave nëntokësore, si dhe të statusit të tyre; (ii) sigurimin, ruajtjen, zhvillimin dhe shfrytëzimin sa më racional të burimeve ujore, mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotja, etj. Ky ligj parashikon përkufizimin e trupave ujore dhe përcakton disa kufizime të përdorimit dhe mbrojtjes, si dhe kërkon që të tjerët të miratohen nga disa akte nënligjore. Ky ligj përcakton brigjet e burimeve ujore, kufizimet e aktiviteteve të caktuara ndërtimore të dëmshme në brigje ⁴ dhe zonat e mbrojtura ujore.
VKM Nr. 177 (31.03.2005)	“Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse” - parashikon normal e lejuara për derdhjet në mjedis, për zonat e mbrojtura ujore.
VKM Nr. 379 (25.05.2016)	“Për miratimin e rregullores ⁵ “Cilësia e ujit të pijshëm”” - Objektivi është mbrojtja e shëndetit të njeriut nga efektet negative të kontaminimit të ujit për konsum nga njerëzit, duke u siguruar që ofrohet i pastër dhe me shumicë. Rregullon disa çështje në lidhje me testimin e ujit të pijshëm dhe zonat e mbrojtura përreth burimit të ujit ose depozitës së ujit nëntokësor komunitar. Rregullorja përcakton tri zona të mbrojtjes (zona buferike) nga uji nëntokësor ose depozitat e ujit në sipërfaqe. Zona imediate e mbrojtjes luhet nga 15 në 100 m nga fillimi i pusit ose depozitës. Distanca e saktë përcaktohet mbështetur në vlerësimin e formacioneve gjeologjike nga eksperti hidroekologjik. Zona e dytë dhe e tretë buferike rrethojnë zonën e parë. Për këto zona, rregullorja nuk përcakton kriteret e distancës, por kufizon aktivitetet që mund të

4 “Brigjet” janë rripat anësore të tokës përgjatë deteve, liqeneve, rezervuarëve, lagunave dhe pellgjeve, si dhe përgjatë rrjedhës së shtratit të lumenjve e përrrenjve që, në funksion të përdorimit, përfshijnë të paktën dy zona: i. me gjerësi 5 m në drejtim normal me tokën nga brinja e sipërme e shtratit natyror në brigjet e pjerrëta dhe 20 m nga vija e nivelit maksimal të plotave me probabilitet përsëritjeje, një herë në 25 vjet, të ujit në brigjet e sheshta, që përdoret për qëllime publike me dispozita të veçanta; me gjerësi 100 m në drejtim normal me tokën nga brinja e sipërme e shtratit natyror në brigjet e pjerrëta dhe 200 m nga vija e nivelit maksimal të plotave me probabilitet përsëritjeje një herë në 25 vjet të ujit në brigjet e sheshta, në të cilën çdo veprimtari e zhvilluar përcaktohet nga organet e administrimit të menaxhimit të burimeve ujore.

5 Mbështetur në Direktivën e Këshillit 98/83/KEE më 3 nëntor 1998, mbi cilësinë e ujit të synuar për konsum nga njerëzit) lidhet me cilësinë e ujit për konsum nga njerëzit.

Legjislacioni	Vështrim i përgjithshëm
	ndikojnë në cilësinë e ujit, si: derdhja ose groposja e mbetjeve, gërmimi, etj.
VKM Nr. 416, datë 15/03/2015 (ANEKSI C)	“Për Miratimin e Kushteve të Përgjithshme e të Posaçme, Dokumenteve shoqëruese, Afatit të Vlefshmërisë, Formularëve të Aplikimit për Autorizim dhe Leje, Procedurave të Shqyrtimit e Vendimmarrjes dhe Formateve të Autorizimit e Lejes për Përdorim të Burimeve Ujore”
Ligji Nr. 162 (04.12.2014 zbatuar në janar 2018)	“Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, përafuar plotësisht me Direktivën 2008/50/KE “Për cilësinë e ajrit në mjedis dhe një ajër më të pastër në Evropë”, si dhe Direktivën 2004/107/KE “Për arsenikun, kadmiumin, merkurin, nikelin dhe hidrokarburet aromatike policiklike në ajrin e ambientit”. Ky Ligj hyri në fuqi më 1 janar 2018 dhe parashikon kuadrin institucional, rregulloret, rolet dhe penalitetet për të garantuar përputhshmërinë. Ligji parashikon se personat fizikë dhe juridikë, publikë ose privatë, vendas ose të huaj, kanë detyrimin të mbajnë ajrin e pastër dhe ta mbarojnë nga ndotja e shkaktuar prej aktiviteteve, që kryejnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
Udhëzimi Nr. 6527 (24.12.2004)	Ministri i Mjedisit dhe Ministri i Transportit “Mbi vlerat e lejueshme të elementeve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore, dhe mënyrat e kontrollit të tyre”, ndryshuar me Udhëzimin Nr. 12, datë 15.06.2010 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin Nr. 6527, datë 24.12.2004 shoqëruar nga Manuali i Kontrollit të Automjeteve.
Urdhër i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës Nr. 149 (07.04.2014)	“Mbi përcaktimin e rregullave implementuese për vlefshmërinë ajrore dhe certifikimin mjedisor të avionëve, produkteve, pjesëve dhe pajisjeve të ngjashme me to, gjithashtu dhe për certifikimin e organizatave projektuese dhe prodhuese”, i përafuar plotësisht me Rregulloren e BE-së Nr. 748/2012, datë 3 gusht 2012, që përcakton rregullat zbatuese për certifikimin e vlefshmërisë ajrore dhe mjedisore të avionëve dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve të lidhura me të, si dhe për certifikimin e organizatave të projektimit dhe prodhimit.
Udhëzimi Nr. 6527 (24.12.2004)	“Mbi vlerat e lejueshme të elementeve ndotëse të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore dhe mënyrat e kontrollit të tyre”- Ky udhëzim përfshin kërkesat për inspektimin e përvitshëm të automjeteve dhe emetimet e lejueshme në ajër. Të gjitha automjetet duhet t'i respektojnë këto norma.
VKM Nr. 613 (07.09.2011)	“Për miratimin e rregullit teknik për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve në mjedise të hapura në lidhje me emetimin e zhurmave”. Përcakton normat për emetimin e zhurmave nga pajisje të caktuara që emetojnë zhurma, si gjeneratorët e energjisë elektrike, traktorët, kompresorët, etj. Rregullorja rendit pragje të caktuara.
Udhëzimi Nr. 10 (30.05.2015)	“Në lidhje me miratimin e llojit të traktorëve bujqësorë ose pyjorë, rimorkiove dhe makinerive të tyre të ndër-këmbyeshme, bashkë me sistemet, komponentët dhe njësitë teknike të ndara”, mbështetur në Direktivën e BE-së 2003/37/KE, datë 26.05.2003.
Ligji Nr. 9774, datë 12.07.2007, ndryshuar me Ligjin Nr. 39/2013	“Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” - përcakton kërkesat për mbrojtjen mjedisore nga zhurma, shmangien, parandalimin, reduktimin dhe eliminimin e efekteve të dëmshme të ekspozimit ndaj tyre, duke përfshirë edhe shqetësimet nga zhurmat. Ky ligj synon mbrojtjen e shëndetit të njeriut nga efektet negative të shkaktuara nga emetimet e zhurmave, dhe përcakton rregulla të përgjithshme, autoritete, inspektive, etj.
VKM Nr. 587, datë 07.07.2010	“Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike” - përcakton rregullat dhe rregulloret për mbrojtjen nga gjenerimi i zhurmave dhe administrimi i nivelit të zhurmave në zonat urbane dhe turistike.
VKM Nr. 1063 (23.12.2015)	“Për miratimin e rregullit teknik për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve në mjedise të hapura në lidhje me emetimin e zhurmave” - parashikon normat për emetimin e zhurmave nga pajisje të caktuara që emetojnë zhurma, si

Legjislacioni	Vështrim i përgjithshëm
	gjeneratorët e energjisë elektrike, traktorët, kompresorët, etj.
Udhëzimi Nr. 8 (27.11.2007)	Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Shëndetësisë “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara” - përcakton vlerat numerike të zhurmave në zona specifike dhe synon garantimin e mbrojtjes së shëndetit të njeriut nga ekspozimi ndaj zhurmave.
Udhëzimi Nr. 6527 (24.12.2004)	“Mbi vlerat e lejueshme të elementeve ndotës. të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave”, i ndryshuar - Përfshin kërkesa për inspektimin e përvitshëm të automjeteve dhe emetimeve të lejuara në ajër. Të gjitha automjetet duhet t’i respektojnë këto norma.
VKM Nr. 147 (21.03.2007)	“Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diezel”.
VKM Nr. 781 (14.11.2012)	“Për cilësinë e lëndëve të djegshme, të lëngshme, për përdorim teknik, civil e industrial, si dhe për përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)”.
Ligji Nr. 10463 (22.09.2011), i ndryshuar	“Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” (i ndryshuar) - synon mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe të mjedisit, si dhe garantimin e menaxhimit mjedisor të shëndoshë të mbetjeve përmes menaxhimit të integruar.
VKM Nr. 99 (18.02.2005), i ndryshuar	“Katalogu shqiptar i mbetjeve” (i ndryshuar) - bën klasifikimin e mbetjeve, mbështetur në llojin e industrisë dhe kriteret për vlerësimin e rrezikshmërisë së mbetjeve. Rregullorja kodifikon llojet e mbetjeve sipas Katalogut Evropian të Mbetjeve.
VKM Nr. 229 (23.04.2014)	“Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme” - Kjo rregullore e zbatuar së fundmi kërkon transferimin e mbetjeve në shoqëri të licensuara dhe garantimin e depozitimit përfundimtar në objekte të miratuara. Ky akt kërkon dokumentimin e transferimit të mbetjeve dhe ofrimin e certifikatës së depozitimit përfundimtar te AKM-ja. Rregullorja kërkon që të gjitha shoqëritë që gjenerojnë mbetje të regjistrohen pranë AKM-së dhe të marrin një numër personal për gjenerimin e mbetjeve.
VKM Nr. 371 (11.06.2014)	“Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre” - Kjo rregullore e zbatuar së fundmi kërkon transferimin e mbetjeve në një shoqëri të licensuar dhe garantimin e depozitimit përfundimtar në objekte të miratuara. Ky akt kërkon dokumentimin e transferimit të mbetjeve dhe ofrimin e certifikatës së depozitimit përfundimtar te AKM-ja. Rregullorja kërkon që të gjitha shoqëritë që gjenerojnë mbetje të regjistrohen pranë AKM-së dhe të marrin një numër personal për gjenerimin e mbetjeve.
Ligji Nr. 9115/2003 (24/07/2003)	“Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura” - ofron rregullore që parashtrajnë nevojën për trajtimin e ujërave të ndotura përpara depozitimit të tyre. Neni 6 parashikon detyrime e personave fizikë dhe juridikë, veprimtaritë e të cilëve shkarkojnë ujëra të ndotura. Personat fizikë e juridikë, veprimtaria e të cilëve shkarkon ujëra të ndotura, detyrohen të marrin masat që: a) të ulin në vijimësi sasinë e ujërave të përdorura, që shkarkojnë në mjedisin pritës; b) të pakësojnë shkallën e ndotjes së ujërave që shkarkojnë, sidomos të ndotjeve me lëndë e mbetje të rrezikshme; c) të administrojnë dhe të trajtojnë ujërat e ndotura Për plotësimin e këtyre detyrimeve, personi fizik ose juridik, veprimtaria e të cilit shkarkon ujëra të ndotura, harton programin e masave teknike, teknologjike e organizative të trajtimit të tyre, i cili kontrollohet nga Inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit, organi që e ka licencuar veprimtarinë dhe nga organet e qeverisjes vendore të zonës.

3.5 Ligji për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor dhe procedurën e VNM-së

Të gjitha projektet e lidhura me ndikimin e mundshëm mbi mjedis janë objekt i VNM-së përpara fillimit të zbatimit. Raporti i VNM-së dhe dokumente të tjera të nevojshme i

paraqiten Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (MTM), që do të transferojë dosjet e projektit tek AKM-ja për rishikim. Projekti miratohet me Vendim/Deklaratë Mjedisore nga AKM-ja dhe MTM-ja. Procedura e VNM-së detajohet në VKM Nr. 686, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, i ndryshuar.

Grafiku i procedurës së VNM-së ilustron në Figurën 1 më poshtë: Mbështetur në kërkesat ligjore të Ligjit Nr. 10440/ 2011, “Për vlerësimin e ndikimit mjedisor”, i ndryshuar, Aneksi II, Pika 10 Projekte infrastrukture, b) projekte të zhvillimit urban, duke përfshirë ndërtimin e qendrave tregtare dhe parkimeve.

Sipas Ligjit Nr. 10440/ 2011 (Neni 11), në përfundim të procesit të VNM-së, AKM-ja do të vendosë nëse do të lëshojë një Deklaratë Mjedisore ose nëse kërkohen studime të mëtejshme (nëse kërkohet VNM “e thelluar”). Është parashikuar që në fund të procesit të VNM-së, MTM-ja do të lëshojë një Deklaratë Mjedisore, përmes një procesi aplikimi online, pra një aplikim për Deklaratë Mjedisore do të bëhet pranë MTM-së. Dokumentet kryesore që kërkohen nga kuadri ligjor dhe duhen paraqitur te MTM-ja për të marrë Deklaratën Mjedisore janë:

- Raport paraprak i VNM-së (i nënshkruar elektronikisht nga një Ekspert Mjedisori);
- Përmbledhje teknike dhe DWG (e nënshkruar elektronikisht nga një Arkitekt i licensuar);
- Dokumente ligjore në lidhje me statusin e pronësisë së zonës së projektit;
- Dosje e plotë me dokumente zyrtare të Ekspertit të Mjedisit, të angazhuar me procedurën e VNM-së;
- Një kopje e skanuar e tarifës së shërbimit, sikundër përcaktohet në legjislacionin përkatës.

Njësia dhe agjencitë kombëtare, rajonale dhe bashkiake që luajnë rol në procesin e VNM-së janë si vijon:

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit
- Drejtoria Rajonale e Mjedisit
- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM)
- Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura (ARZM)
- Bashkitë

Krahas legjislacionit që lidhet konkretisht me nevojën për VNM, ekzistojnë edhe politika, ligje dhe rregullore kombëtare që zbatohen për Projektin e propozuar dhe aspektet e tij mjedisore dhe sociale. Veç kësaj, Shqipëria ka zhvilluar standarde mjedisore, që bazohen kryesisht te Direktivat e Komisionit Evropian. Standardet ekzistuese përfshijnë mbrojtjen e biodiversitetit, trashëgimisë kulturore, emetimet në ajër, nivelet e zhurmës, cilësinë dhe derdhjen e ujit, si dhe menaxhimin e mbetjeve.




Figura 1 Procedura dhe Kohështrirja sipas Legjislacionit Shqiptar

3.6 Ligjet dhe Rregullorja në Fushën e Trashëgimisë Kulturore dhe Gjetje Rastësore

Projektet për të gjitha llojet e godinave mbi dhe nën tokë, si dhe projektet infrastrukturore inxhinierike në mbarë vendin bazohen në standardet dhe kërkesat teknike të akteve ligjore në fuqi. Ligji Nr. 10119/09 “Për planifikimin e territorit”, ndryshuar me ligjin Nr. 10258, datë 21.04.2010 dhe Ligjin Nr. 10315, datë 16.09.2010, është rregullatori kryesor ligjor në Shqipëri që lidhet me planifikimin urban, dhe synon të përfshijë kuadrin ligjor të planifikimit urban në një ligj të vetëm.

Ligji Nr. 10119/09 ka hyrë në fuqi më 30 shtator 2011. Qëllimi kryesor i këtij ligji është të sigurojë një zhvillim të qëndrueshëm të territorit nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe burimeve natyrore. Ky ligj përfshin konceptet e mbrojtjes së trashëgimisë natyrore dhe kulturore, mbrojtjen e shëndetit dhe të sigurisë të komunitetit. Krahas kësaj, ligji përmend instrumente të integruara të planifikimit, të konceptuara për zonat bregdetare, për trashëgiminë kulturore, natyrore dhe peizazhet, si dhe për fusha të tjera me rëndësi ose interes të përbashkët.

Mbrojtja e trashëgimisë kulturore në Shqipëri trajtohet nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe disa institucione të specializuara në kuadër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Nën varësinë e Ministrisë, Departamenti i Trashëgimisë Kulturore mbikëqyr Institutin e Monumenteve, nëntë Muzetë Kombëtarë, dhe Qendrën e Regjistrimit të Pasurive Kulturore. Trashëgimia kulturore përfshin: vendet arkeologjike, ndërtesat historike (të izoluara dhe në rrethe), varrezat dhe vendet e investuara në kuptimin tradicional me natyrë historike, kulturore ose fetare.

Ligji Nr. 9048 ("Akti për Trashëgiminë Kulturore"), miratuar më 7 prill, 2003 (ndryshuar me Ligjin Nr. 9592, datë 27.07.2006; Ligjin Nr. 9882, datë 28.02.2008) është kuadri ligjor kryesor, që rregullon menaxhimin e pasurive kulturore materiale dhe jomateriale në Shqipëri. Ligji Nr. 9048 përfaqëson përpjekjen e parë për të zgjeruar mbrojtjen ligjore në fushën e trashëgimisë kulturore jomateriale. Këtu përfshihen: Kategoritë e trashëgimisë kulturore shqiptare për t'u mbrojtur (p.sh. materiale, jomateriale, të luajtshme, të paluajtshme); përkufizime dhe shembuj të trashëgimisë materiale dhe jomateriale; përgjegjësitë e institucioneve përkatëse dhe organeve qeveritare; penaltetet për personat që dëmtojnë trashëgiminë kulturore; dhe procedurat lehtësuese.

Neni 4 rendit pasuritë e paluajtshme, materiale për t'u mbrojtur, që përfshijnë, por nuk kufizohen në: Vende arkeologjike; struktura historike (duke përfshirë vendet e adhurimit); qytetet dhe lagjet historike; varrezat dhe varret, si dhe peizazhe historike. Ligji Nr. 9048 u ndryshua me Ligjin Nr. 9592, datë 27.07.2006. Ndryshimet përfshinin: 1) prezantimin e Komitetit Kombëtar të Trashëgimisë Kombëtare, si organ këshillues, dhe 2) krijimin e Komitetit Kombëtar për Trashëgiminë Jomateriale (KKTJ). Ligji Nr. 9048 u ndryshua përsëri me Ligjin Nr. 9882, datë 28.02.2008. Ndryshimet e vitit 2008 përfshinë nene për rindërtimin e rrjetit të institucioneve të specializuara të trashëgimisë kulturore dhe nene që kanë të bëjnë me krijimin e Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë dhe institucioneve të specializuara, si Shërbimi Arkeologjik Shqiptar.

Sipas ligjit, nëse diçka e pazakontë gjendet gjatë procesit të gërmimeve, kontraktori e ndalon punën menjëherë, informon urgjentisht autoritetet vendore, Institutin e Monumenteve të Kulturës dhe Ministrinë e Kulturës. Ata dërgojnë arkeologë dhe specialistë të fushës për të verifikuar dhe për të vlerësuar objektin arkeologjik të supozuar dhe punimet rifillojnë vetëm pas dhënies së lejes zyrtare nga Instituti i Monumenteve të Kulturës. Krahas kësaj, Shqipëria respekton detyrimet ndërkombëtare të parashikuara nga konventat dhe marrëveshjet e ratifikuara nga Shqipëria në fushën e trashëgimisë kulturore.

Tabela 1. Legjislacioni për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore

Legjislacioni	Vështrim i përgjithshëm
Trashëgimia Kulturore	
Ligji Nr. 27/2018 (17.05.2018)	"Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë" - Të gjitha çështjet në lidhje me trashëgiminë kulturore në Shqipëri qeverisen nga ky ligj. Ligji përcakton ruajtjen dhe procedurat e gjetjeve rastësore (objekte ose sende arkeologjike me vlerë të trashëgimisë kulturore, që zbulohen rastësisht), që do të përdoren gjatë zbatimit të Projektit.
Neni 146	Iu kërkon dhe i ngarkon personat, të cilët gjatë punimeve bujqësore apo ndonjë fakti çfarëdo ndeshin gjetje rastësore, të pezullojnë punimet menjëherë dhe të informojnë autoritetet vendore përkatëse brenda tri ditëve. Autoritetet përkatëse përbëhen nga zyra e qeverisjes vendore (bashkia), Drejtoria e Policisë dhe Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë

	Kulturore (DRTK). DRTK-ja verifikon situatën/gjetjet dhe raporton tek Instituti i Monumenteve të Kulturës (IMK). Këto institucione janë përgjegjëse për vlerësimin e vlerës arkeologjike të objekteve të gjetura, dhe për përcaktimin nëse punimet mund të vijojnë ose të vazhdojnë të jenë të pezulluara derisa të jenë kryer hetime të mëtejshme në terren.
Neni 5, pika 64 dhe Neni 31	Përcakton konservimin e trashëgimisë kulturore jomateriale përmes masave që synojnë ruajtjen afatgjatë të këtyre pasurive kulturore.

Tabela 3. Ligjet e miratuara pas ratifikimit të konventave ndërkombëtare nga Republika e Shqipërisë

Emri i konventës	Ratifikuar nga Shqipëria
Ligji Nr. 9490, datë 13.03.2006 "Për ratifikimin e Konventës për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jo-Materiale", Paris 2003	2006
Ligji Nr. 9806, datë 17.09.2007 "Për Ratifikimin e Konventës Evropiane "Për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkeologjike""	2007
Ligji Nr. 10 027, datë 11.12.2008 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Nënujore", Paris 2001	2008

Burimi: <http://www.kultura.gov.al/al/baza-ligjore>

3.7 Kuadri i shëndetit dhe sigurisë

Ligji Nr. 10237/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" garanton sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit përmes parandalimit të rreziqeve profesionale, duke eliminuar faktorët që përbëjnë rrezik dhe aksidente, si dhe duke informuar, duke këshilluar, duke ekuilibruar pjesëmarrjen, në përputhje me ligjin. Ky ligj aplikon direktivat në vijim:

- Direktiva e Këshillit Evropian 89/391/KEE, datë 12 korrik 1989, "Për zbatimin e masave që inkurajojnë përmirësime të sigurisë dhe shëndetit të punonjësve në punë";
- Direktiva e Këshillit Evropian 94/33 KEE, datë 22 korrik 1994, "Për mbrojtjen e të rinjve në punë", Neni 6; dhe
- Direktiva e Këshillit Evropian 92/85 KEE, "Mbi paraqitjen e masave për të inkurajuar përmirësimet në sigurinë dhe shëndetin në punë të punëtoreve shtatzëna dhe punëtoreve, të cilat sapo kanë lindur ose janë me fëmijë në gji".

Legjislacioni shqiptar për shëndetin dhe sigurinë dhe rëndësia e tij për projektin theksohen në tabelën më poshtë:

Tabela 4 Legjislacioni për Shëndetin dhe Sigurinë

Legjislacioni	Vështrim i përgjithshëm
Ligji Nr. 10237/2010	"Për sigurinë dhe shëndetin në punë" - Ky ligj rregullon kuadrin e shëndetit dhe

Legjislacioni	Vështrim i përgjithshëm
(18/02/2010)	sigurisë në vendin e punës dhe përcakton rolet e secilës palë, objekt i ligjit.
Ligji Nr. 9863/2008	Inspektorati Sanitar Shtetëror synon mbrojtjen e punonjësve nga ndikimi i kushteve negative të punës, si ekspozimi ndaj substancave toksike, rrezatimit, zhurmave jopraktike, dridhjeve, mikroklimës së pafavorshme, dhe kontrollit të nivelit të sëmundjeve profesionale dhe aksidenteve në punë, si pasojë e kushteve negative.
Ligji Nr. 9863/2008 (28/01/2008)	“Për ushqimin” - specifikon rregullat e sigorisë së ushqimit në Shqipëri
Ligji Nr. 10433/2011 (16/06/2011)	“Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”
VKM Nr. 562/2013 (03/07/2013)	Vendim i Këshillit të Ministrave në lidhje me miratimin e rregullores për kërkesat minimale të sigorisë dhe shëndetit në vendin e punës.
VKM Nr. 312/2010 (05/05/2010)	“Për sigurinë në kantier” - parashikon rregullat e sigorisë për aktivitetet ndërtimore.
Vendimi Nr. 692/2001 (13/12/2001)	“Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”
VKM Nr. 842/2014 (03/12/2014)	“Për mbrojtjen e sigorisë dhe shëndetit të punëmarrësve nga risqet e lidhura me zhurmën në vendin e punës” - iu kërkon punëdhënësve të vlerësojnë nivelet e zhurmës në vendin e punës dhe të sigurojnë mbrojtjen e punonjësve të tyre

3.8 Legjislacioni kombëtar përkatës

Rregulloret kombëtare përkatëse në lidhje me PZHIUT-në paraqiten në Tabelën 6.

Tabela 5. Legjislacioni kombëtar përkatës

Legjislacioni	Vështrim i përgjithshëm
Ligji Nr. 107/2014	“Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” - Ky ligj synon integrimin e kuadrit legjislativ të planifikimit urban në një ligj të vetëm, dhe përfshin konceptin e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe natyrore, si dhe shëndetin dhe sigurinë e komunitetit për planifikimin e territorit.
VKM Nr. 408 (13.05.2015 ndryshuar me VKM Nr. 231/2017)	Rregullorja për zhvillimin territorial.
Ligji Nr. 9244/2004	“Për mbrojtjen e tokës bujqësore” - përcakton statusin e mbrojtjes të fushave bujqësore.

Legjislacioni	Vështrim i përgjithshëm
Ligji Nr. 8752/2001 (26/03/2001), i ndryshuar disa herë	"Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", ndryshuar me Ligjin Nr. 10257/2010 rregullon çështjet e përdorimit të tokës, dhe përputhshmërinë e tyre me Planifikimin Rajonal.

3.9 Konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare

Shqipëria është palë nënshkruese e disa konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare për konservimin e biodiversitetit, mbrojtjen e mjedisit, dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Konventat dhe marrëveshjet kryesore që lidhen me projektin janë si vijon:

Tabela 6: Konventa dhe Marrëveshje Ndërkombëtare të Nënshkuara/Ratifikuara nga Shqipëria

Konventa/Marrëveshja	Vështrim i përgjithshëm	Ratifikuar
Konventa Aarhus për Aksesin në Informacion, Pjesëmarrjen Publike në Vendimmarrje dhe Aksesin në Drejtësi në Çështjet Mjedisore (1998)	Konventa përcakton një sërë të drejtash të publikut në lidhje me mjedisin, duke përfshirë aksesin në informacione mjedisore, pjesëmarrjen publike në vendimmarrjen mjedisore dhe aksesin në drejtësi ⁶ .	26 tetor 2000
Konventa kuadër e OKB-së për ndryshimet klimatike (UNFCCC) (1992) hyri në fuqi në vitin 1994	Organizata e Kombeve të Bashkuara Konventa Kuadër për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC) ka qenë kyçe për adresimin e ndryshimeve klimatike dhe nevojën për reduktimin e emetimeve të gazeve serrë. Objektivi përfundimtar i Konventës është stabilizimi i përqendrimit të gazeve serrë (GS) në atmosferë, në një nivel që parandalon ndërhyrjen e rrezikshme nga njerëzit në sistemin klimatik.	01 dhjetor 1994
Marrëveshja e Parisit në COP21 në Paris më 12 dhjetor 2015, që ka hyrë në fuqi më 4 nëntor 2016	Marrëveshja e Parisit mbështetet mbi Konventën për Ndryshimet Klimatike për të luftuar ndryshimet klimatike ⁷ .	21 shtator 2016
Protokolli i Kiotos	Protokolli i Kiotos është një marrëveshje ndërkombëtare që lidhet me Konventën Kuadër të OKB-së për Ndryshimet Klimatike; palët nënshkruese janë angazhuar për përcaktimin e synimeve ndërkombëtare për reduktimin e emetimeve ⁸	1 prill 2005
Konventa për Mbrojtjen dhe Përdorimin e Rrjedhave Ujore	Shmangia ose minimizimi i efekteve negative mbi burimet ujore dhe cilësinë e	5 janar 1994

⁶ <http://ec.europa.eu/environment/aarhus/index.htm>

⁷ http://unfccc.int/files/paris_agreement/application/pdf/qa_paris_agreement_entry_into_force.pdf

⁸ <https://unfccc.int/process-and-meetings/the-kyoto-protocol/what-is-the-kyoto-protocol>

Konventa/Marrëveshja	Vështrim i përgjithshëm	Ratifikuar
Ndërkufitare dhe Liqeneve Ndërkombëtare (1992)	ujit.	
Konventa për Diversitetin Biologjik (KDB) (1992)	Shmangia ose minimizimi i efekteve negative mbi habitatet dhe species e rëndësishme, zonat natyrore të konservimit, të caktuara natyrshëm ose ndërkombëtarisht; konservimi, përdorimi i qëndrueshëm dhe i drejtë i biodiversitetit.	5 prill 1994
Konventa për Mbrojtjen e Florës dhe Faunës së Egër dhe Habiteteve Natyrore në Evropë (Konventa e Bernës) (1976)	Konventa synon garantimin e konservimit të specieve të florës dhe faunës së egër dhe habiteteve të tyre. Vëmendje e veçantë iu është kushtuar specieve në rrezik dhe të cenueshme, duke përfshirë speciet migratore në rrezik dhe të cenueshme ⁹ ; shmangia ose minimizimi i efekteve negative mbi habitatet dhe speciet e rëndësishme, zonat natyrore të konservimit, të caktuara natyrshëm ose ndërkombëtarisht.	2 mars 1998
Konventa për Ruajtjen e Specieve Migruese të Kafshëve të Egra (Konventa e Bonit) (1979)	Shmangia ose minimizimi i efekteve negative mbi speciet migratore	1 shtator 2001
Marrëveshja mbi Ruajtjen e Shpendëve Ujorë Shtegtarë Afrikano-Euroaziatikë (1995)	Marrëveshja mbi Ruajtjen e Shpendëve Ujorë Shtegtarë Afrikano-Euroaziatikë (MRSHUSHAE) mbulon 254 specie shpendësh, që varen ekologjikisht në ligatina për të paktën një pjesë të ciklit të tyre vjetor. Të gjitha speciet e përfshira në këtë Marrëveshje i kalojnë kufijtë ndërkombëtarë gjatë shtegimit të tyre dhe kërkojnë habitate cilësore për çiftëzim, si dhe një rrjet zonash të përshtatshme për të mbështetur udhëtimet e tyre vjetore ¹⁰ . Shmangia ose minimizimi i efekteve negative mbi speciet e shpendëve ujorë migratorë.	1 shtator 2001
Konventa për tregtinë ndërkombëtare të specieve të rrezikuara të faunës dhe florës së egër (CITES) (1975)	CITES është një marrëveshje ndërkombëtare midis qeverive. Ajo synon të garantojë se tregtia ndërkombëtare e ekzemplarëve të kafshëve dhe bimëve të egra nuk kërcënon mbijetesën e tyre ¹¹ .	27 qershor 2003
Konventa për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore (1989)	Shmangia e efekteve negative mbi zonat e Trashëgimisë Kulturore Botërore dhe Shqiptare; minimizimi i efekteve negative mbi zonat e trashëgimisë kulturore jomateriale dhe të panjohur, aseteve materiale dhe infrastrukturës.	10 korrik 1989
Konventa e ILO-s 29Konventa për	Objekti dhe qëllimi i saj është eliminimi i	25 qershor

⁹ <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/104>

¹⁰ <https://www.cms.int/en/legalinstrument/aewa>

¹¹ <https://www.cites.org/eng/disc/what.php>

Konventa/Marrëveshja	Vështrim i përgjithshëm	Ratifikuar
Punën e Detyruar (1930) dhe Konventa e ILO-s Nr. 105 për Eliminimin e Punës së Detyruar (1957))	punës së detyruar në të gjitha format, pavarësisht natyrës së punës ose sektorit të aktivitetit ku mund të zhvillohet.	1957 27 Shkurt 1997
Konventa e ILO-s 87 Liria e grumbullimit dhe Mbrojtja e të Drejtës për t'u Organizuar (1948)	Mbron të drejtat e punëmarrësve dhe punëdhënësve për t'iu bashkuar organizatave të zgjedhura nga vetë ata, pa autorizim paraprak.	3 qershor 1957
Konventa e ILO-s 98E drejta e organizimit dhe marrëveshjes kolektive	Kjo konventë parashikon të drejtën e punonjësve për t'iu bashkuar sindikatave dhe për t'u angazhuar me marrëveshje kolektive.	3 qershor 1957
Konventa e ILO-s 100E drejta për shpërblim të barabartë (1951)	Çdo anëtar, me anë të mjeteve të përshtatshme me metodat që përdoren për përcaktimin e përqindjeve, promovon dhe, për aq kohë sa bashkërendohet me këto metoda, garanton zbatimin e shpërblimit të barabartë për të gjithë punonjësit dhe punonjëset për punën me vlerë të barabartë.	03 qershor 1957

3.10 Politikat Mbrojtëse të Bankës Botërore

Në këtë pjesë paraqiten Politikat Mbrojtëse që lidhen me projektin e PZHIUT-së dhe përshkruhet shkurtimisht përmbajtja e tyre.

- **OP 4.01 Vlerësimi mjedisor**

Banka Botërore kërkon vlerësim mjedisor (VM) për projektet e propozuara për financim nga Banka, për të garantuar se janë të qëndrueshme dhe të shëndosha nga pikëpamja mjedisore, si dhe për të ndihmuar në vendimmarrje. OP-ja përcakton procesin e VM-së dhe lloje të ndryshme të instrumenteve të VM-së. Ky projekt i PZHIUT-së klasifikohet si “Kategoria B”, në përputhje me WB OP/BP 4.01, mbi Vlerësimin Mjedisor. Ndikimet kanë gjasa të jenë në shkallë të vogël, të lokalizuara dhe të një natyre të pakthyeshme. Duke qenë se natyra dhe vendndodhja e saktë e nënprojekteve të propozuara nuk janë identifikuar, KMMS-ja është përgatitur në përputhje me OP 4.01, që e përcakton KMMS-në si “Një instrument që shqyrton çështjet dhe ndikimet shoqëruese kur një projekt përbëhet nga një program dhe/ose një sërë nënprojektesh, dhe ndikimet nuk mund të përcaktohen derisa të jenë identifikuar detajet e programit ose të nënprojektit.

KMMS-ja përcakton parimet, rregullat, udhëzimet dhe procedurat për vlerësimin e ndikimeve mjedisore dhe sociale. Përmban masat dhe planet për të reduktuar, për të zbutur dhe/ose për të zvogëluar ndikimet negative dhe për të përmirësuar ndikimet pozitive, dispozitat për përlllogaritjen dhe buxhetimin e kostove të këtyre masave, dhe informacionet për agjencinë/të përgjegjëse për adresimin e ndikimeve të projektit. Nëse shqyrtimi i projektit që përdoret nga

agjencitë zbatuese konstaton se kërkohet planifikim më i detajuar, Planet e Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS) mund të përgatiten.

- *Projekte që përfshijnë nënprojekte*

Për projektet që përfshijnë përgatitjen dhe zbatimin e planeve vjetore të investimit ose nënprojekteve, identifikuar dhe zhvilluar gjatë projektit ose gjatë përgatitjes së secilit nënprojekt të propozuar, subjekti koordinues i projektit ose institucioni zbatues kryen VM-në e përshtatshme, sipas kërkesave kombëtare dhe të kësaj politike. Banka vlerëson, dhe nëse është e nevojshme, përfshin në komponentët e Nivelit të Integritetit të Sigurisë, forcimin e kapaciteteve të subjektit koordinues ose institucionit zbatues

- a) shqyrtimin e nënprojekteve,
- b) përfitimin e ekspertizës së nevojshme për të kryer VM-në,
- c) rishikimin e të gjitha gjetjeve dhe rezultateve të VM-së për nënprojekte individuale,
- d) garantimin e zbatimit të masave zbutëse (duke përfshirë, ku gjen zbatim, një PME), dhe
- e) monitorimin e kushteve mjedisore gjatë zbatimit të projektit.

Nëse Banka çmon se nuk ekziston kapacitet i mjaftueshëm për kryerjen e VM-së, të gjitha nënprojektet e Kategorisë A, dhe sipas nevojës, nënprojektet e Kategorisë B, duke përfshirë raportet për VM-në, i nënshtrohen rishikimit dhe miratimit paraprak nga Banka.

- **OP 4.04 Habitatet natyrore**

Konservimi i habitateve natyre, si masat e tjera që mbrojnë dhe përmirësojnë mjedisin, është kyç për zhvillimin e qëndrueshëm afatgjatë. Ndaj, Banka mbështet mbrojtjen, mirëmbajtjen, dhe rehabilitimin e habitateve natyrore dhe funksioneve të tyre. Ky OP aktivizohet për të mbështetur mbrojtjen, mirëmbajtjen, dhe rehabilitimin e habitateve natyrore dhe funksioneve të tyre.

- **OP 4.09 Menaxhimi i insekteve:**

Objektivi i kësaj OP-je është mbështetja e strategjisë që promovon përdorimin e metodave të kontrollit biologjik ose mjedisor, dhe redukton mbështetjen mbi pesticide kimike sintetike.

- Reduktimi i ekspozimit të njeriut dhe rreziqeve shëndetësore
- Reduktimi i kontaminimit mjedisor
- Ndihma për të zhvilluar kapacitetet kombëtare për MII-në dhe rregullimin/monitorimin e insekteve.

- **OP 4.11 Burimet fizike dhe kulturore**

Kjo politikë mbron zonat e trashëgimisë kulturore, fizike ose arkeologjike, ndihmon në ruajtjen dhe shmang eliminimin e tyre. OP-ja aktivizohet pasi disa nga ndërhyrjet e projektit do të kryhen në ose pranë zonave të njoftuara të trashëgimisë kulturore, fizike ose arkeologjike dhe monumenteve të Swat.

- **OP 4.12 Risistemimi i pavullnetshëm**

OP 4.12 – Risistemimi i pavullnetshëm mbulon ndikime direkte ekonomike dhe sociale, që vijnë si rrjedhojë e përvetësimit të tokës për zhvillimin, zhvendosjen ose humbjen e strehës, aseteve ose aksesit në asete, si dhe humbjen e të ardhurave ose mjeteve të jetesës. Politika gjen zbatim të gjithë personat e prekur, pavarësisht titullit/pronësisë dhe seriozitetit të ndikimeve, qofshin të drejtpërdrejta ose të tërthorta. Politika kërkon vëmendje të veçantë ndaj nevojave të grupeve të cenueshme, sidomos të atyre nën vijën e varfërisë, personave pa tokë, të moshuarve, grave dhe fëmijëve, grupeve indigjene, pakicave etnike, jetimëve, dhe personave të tjerë të pafavorizuar. Kuadri i Politikave të Risistemimit (KPR) do të adresojë çdo çështje të mundshme të përvetësimit të tokës. Kjo OP aktivizohet pasi ndërhyrjet e projektit mund të kërkon tokë nga mbajtësit publikë ose privatë të tokës.

- **OP 4.36 Pylltaria**

Objektivi i kësaj politike është t'i ndihmojë huamarrësit në shfrytëzimin e potencialit të pyjeve për të reduktuar varfërinë në mënyrë të qëndrueshme, për t'i integruar pyjet me efektshmëri në zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm, dhe për të mbrojtur shërbimet mjedisore jetike vendore dhe botërore dhe vlerën e pyjeve. Nëse për përmbushjen e këtyre objektivave nevojitet restaurimi i pyjeve dhe zhvillimi i plantacioneve, Banka i ndihmon huamarrësit me aktivitete të restaurimit të pyjeve, që mirëmbajnë ose përmirësojnë funksionalitetin e ekosistemit dhe biodiversitetit. Krahas kësaj, Banka i ndihmon huamarrësit me ngritjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të plantacioneve pyjore, që janë të përshtatshme nga pikëpamja mjedisore, sjellin përfitime sociale, dhe mund të zhvillohen nga pikëpamja ekonomike, për të ndihmuar në përmbushjen e kërkesave në rritje për të mira dhe shërbime pyjore

- **Siguria e digave (OP 4.37)**

Kjo Politikë kërkon garantimin e ndërmarrjes së masave të përshtatshme, dhe ofrimin e burimeve të mjaftueshme për sigurinë e digave në projektin e financuar nga BB-ja. OP-ja aktivizohet kur projektet e BB-së financojnë ndërtimin dhe rehabilitimin e digave, dhe kur kryerja e një projekti të financuar nga BB-ja varet nga një digë ekzistuese. Kjo politikë kërkon mbrojtjen e popullsisë dhe ekosistemeve të rrjedhës së poshtme nga pasojat e problemeve me digat. Politika kërkon që një panel i pavarur nga diga të vlerësojë projektimin/ndërtimin; planet e detajuara për ndërtimin/sigurimin e cilësisë; tërësinë e instrumenteve, operacionet & mirëmbajtjen, si dhe kërkesat e gatishmërisë ndaj emergjencave në kuadër të kujdesit të duhur.

- **Udhëzimet e Grupit të Bankës Botërore për Mjedisin, Shëndetin, dhe Sigurinë**

Udhëzimet për Mjedisin, Shëndetin, dhe Sigurinë (MSHS) janë dokumente referuese teknike me shembuj të përgjithshëm dhe specifike, sipas industrisë, të Praktikave të Mira të Industrisë Ndërkombëtare (PMIN). Kur një ose më shumë anëtarë të Grupit të Bankës Botërore përfshihen në projekt, këto Udhëzime MSHS zbatohen, sipas kërkesave të politikave dhe standardeve përkatëse. Këto Udhëzime MSHS të Përgjithshme janë konceptuar për t'u përdorur së bashku me Udhëzimet MSHS të Sektorit të Industrisë, që ofrojnë udhëzime për përdoruesit mbi çështjet MSHS në sektorët specifike të industrisë. Për projekte komplekse, mund të nevojitet përdorimi i disa udhëzimeve sipas sektorit të industrisë.

4.0 Përshkrimi i Mjedisit Ekzistues

4.1 Hyrje

Shqipëria ndodhet në rajonin jug-perëndimor të gadishullit të Ballkanit. Sipërfaqja e përgjithshme e vendit është 28,748 km², çka e bën atë një nga vendet më të vogla në Evropë. Vendet fqinje janë Mali i Zi në veriperëndim, Serbia në verilindje, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë në veri dhe lindje dhe Greqia në jug dhe juglindje. Shqipëria ka një vijë bregdetare prej 487 km që ndahet ndërmjet detit Adriatik dhe atij Jon.

Klima ndryshon sipas topografisë. Rajonet klimatike kryesore në vend janë ultësitat bregdetare me klimë tipike Mesdhetare dhe rajonet malore me një klimë Mesdhetare-kontinentale. Këto rajone të përgjithshme klimatike ndikohen kryesisht nga gjerësia gjeografike dhe ndryshimet në lartësi. Mbi 70 për qind e vendit përbëhet nga terren i thyer dhe male kryesisht të paarrtshëm. Për shkak të bashkimit të rrymave të ajrit nga Deti Mesdhe dhe masave ajrore kontinentale, niveli mesatar i reshjeve është i lartë. Niveli mesatar vjetor i reshjeve në male mund të arrijë vlera deri në 3,000 mm, ndërsa në zonën bregdetare, niveli mesatar është rreth 1,000 mm. Shumica e reshjeve shkarkohen në lumenj dhe derdhen në Detin Adriatik. Temperaturat mesatare në muajin gusht, që është muaji më i nxehtë, variojnë nga 17° në 31°C. Në muajin janar, që është muaji më i ftohtë, temperaturat mesatare variojnë nga 2° në 12°C. Shqipëria ndahet në 12 njësi administrative të quajtura qarqe, të cilat përbëhen nga 36 rrethe.

Projekti i propozuar pritet të përqendrohet në jug të Shqipërisë duke përfshirë zonën ndërmjet Vlorës dhe Sarandës duke mbuluar bregdetin dhe pjesën në brendësi (duke përfshirë Beratit, Përmetin dhe Gjirokastrën). Bregdeti Jonian i Shqipërisë konsiderohet si burimi më i rëndësishëm nga varet zhvillimi i ardhshëm i vendit.

Peizazhi i rajonit bregdetar jugor është i karakterizuar nga një topografi e thyer e cila përcakton kuadrin për zhvillimin natyror të habitateve dhe ndikimin e njeriut në këto habitate gjatë kohës. Rezultati është një rajon i ndikuar nga dy forma të peizazhit, konkretisht peizazhet natyrore (relieve, zonat natyrore dhe habitate të zhvilluara natyrshëm); dhe peizazhet kulturore (ndërtesat tradicionale me veçoritë e tyre, pasuri të tjera të trashëgimisë me veçoritë e tyre, së bashku me bujqësinë, pemëtarinë dhe forma të tjera të përdorimit të tokës).

FSH do të përdoret për të mbështetur rritjen e investimeve për përmirësimin urban dhe infrastrukturor në dy vendndodhje të reja në jug të Shqipërisë, konkretisht në Ksamilit dhe Orikum, që janë të lidhura ngushtësisht me bashkitë dhe shtetet turistike të mbështetura nga Projekti mëmë.

Ksamili është një qytezë bregdetare në jug të Shqipërisë nën administrimin e Bashkisë së Sarandës. Kjo qytezë ndodhet në bregun jugor të Detit Mesdhe pranë kufirit grek dhe sitit UNESCO të Butrintit, dhe është një destinacion i preferuar i turizmit veror pasi kombinon vendet kulturore me ato natyrore. Parku Kombëtar i Butrintit, ishujt e Ksamilit, Liqeni i Butrintit dhe Kanali i Vivarit janë pasuritë kryesore në Ksamilit dhe përreth. Qyteza e Ksamilit ka rreth 10,000 banorë të regjistruar, por përllogaritet që vetëm 3,141 prej tyre jetojnë në zonë përgjatë vitit, dhe në periudhën e verës, numri i njerëzve në qytezë mund të arrijë deri në 70,000 së bashku me turistët, çka përbën ngarkesë të konsiderueshme për

infrastrukturën.

Qyteza e Orikut ndodhet në pjesën jugore të Rivierës Shqiptare dhe në afërsi të qytetit të Vlorës. Orikumi njihet për bregdetin e jashtëzakonshëm dhe ullishtat kodrinore, si dhe për afërsinë me Parkun Kombëtar të Llogarasë, gadishullin e Karaburunit dhe Lagunen e Orikut. Gjithashtu, kjo qytezë që ndodhet në një plazh ranor pranë një lagune të qetë, ofron pasuri arkeologjike, historike dhe kulturore, për shkak të afërsisë me pjesën arkeologjike të Qytetit Antik të Orikut, bazën ushtarake të Pashalimanit si dhe kishën e Marmiroit.



Figura 2. Harta e Shqipërisë e bazuar në Seksionin Kartografik të OKB-së

Burimi: Seksioni Kartografik i OKB-së

(Harta e Shqipërisë e bazuar në Seksionin Kartografik të OKB-së: Zonat bregdetare dhe tokësore që do të ndikohen nga projekti)

4.2 Mjedisi Fizik

Cilësia e Ajrit. Aktualisht, në vend kryhet një monitorim shumë i kufizuar i ajrit. Sipas Komunikatës së Parë Kombëtare (KPK), Shqipëria ka një nivel relativisht të ulët të emetimeve neto të gazrave serrë (GS), me emetim relativisht të ulët të dioksidit të karbonit (CO₂) për frymë, kryesisht për shkak se mbi 90% e energjisë së përdorur në vend prodhohet nga hidrocentralet.

Hidrologjia dhe ujërat sipërfaqësore. Cilësia e ujërave sipërfaqësore nuk njihet mirë për shkak të monitorimit të vazhdueshëm shumë të kufizuar të emetimeve të ujërave të ndotura dhe cilësisë së ujërave. Në përgjithësi, cilësia e ujërave shpesh përbën problem për shkak të ndotjes që vjen nga shkarkimi i ujërave të ndotura të patrajuara nga vendbanimet urbane, si dhe nga industritë me teknologji të vjetruara. Shkarkimi i ujërave të ndotura në trupat ujorë, veçanërisht në zonat turistike bregdetare dhe ekosistemet delikate, është një shqetësim mjedisor madhor për Qeverinë, komunitetin e biznesit dhe publikun.

Cilësia e ujërave, bazuar në matjet e kryera nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, të raportuara në Raportin Kombëtar të Gjendjes së Mjedisit, 2015, duket se është përmirësuar me 50% në plazhin e Sarandës. Në vitin 2015, u vendos një impiant i ri i trajtimit të ujërave për Sarandën, që përmirësoi më tej cilësinë e ujërave në bregdetin e Sarandës.

Degradimi i tokës, ujërave nëntokësore dhe erozioni i tokës janë një nga problematikat mjedisore kryesore në vend. Ngarkesa e madhe ndotjes në ujërat sipërfaqësore po çon drejt përkeqësimit të cilësisë së ujërave nëntokësore dhe ka prekur veçanërisht zonat e ulëta, ku jeton shumica e popullsisë dhe zhvillohet pjesa më e madhe e veprimtarive industriale dhe bujqësore. Kullotja e pakontrolluar e kafshëve në kullota dhe prerja e drurëve për ngrohje janë disa nga faktorët kryesorë të degradimit të tokës dhe erozionit. Raporti i Gjendjes së Mjedisit 2009-2010 tregon se erozioni i tokës vazhdon të jetë i konsiderueshëm dhe se sasi sedimenti deri në 8-24 ton/ha në vit transportohen nga ujërat lumore.

Ndryshimi klimatik. Shqyrtimi i literaturës tregon se efektet e ndryshimeve klimatike në Shqipëri përfshijnë karakteristikat dhe kohëzgjatjen e stinëve (dimri është më i butë dhe i shkurtër, vera më e gjatë dhe e nxehtë); thatësira në verë dhe ndonjëherë edhe në vjeshtë, dhe më pas përmbajtje të menjëhershme, erozionin bregdetar përgjatë gjithë Adriatikut si pasojë e rritjes së nivelit të detit; shkatërrimin e pyjeve dhe bimësisë bregdetare; rritjen e kripësisë në lagunat dhe fushat pranë brigjeve; dhe shtimin e zjarreve në pyje.

4.3 Meteorologjia

Kantieri i projektit ndodhet në zonë mesdhetare të ulët qendrore, që mbulon thuajse të gjithë ultësirën bregdetare të Shqipërisë. Kjo klimë mesdhetare karakterizohet nga vera të nxehta dhe të thata, dhe dimra të ftohtë dhe të lagësht. Sasia mesatare vjetore e reshjeve është rreth 950 - 1,200 mm/vit, dhe shumica e reshjeve ndodhin gjatë periudhës tetor-mars (70-80%). Për shkak të bashkimit të rrymave të ajrit nga Deti Mesdhe dhe masave ajrore kontinentale, niveli mesatar i reshjeve është i lartë. Temperatura mesatare vjetore është ndërmjet 15° -18° C. 29 vlerat më të larta të temperaturave maten gjatë periudhës qershor-gusht, me vlera maksimale 30°-35° C. Temperaturat më të ulëta janë në muajin janar, me vlera 6.5°-7.5° C. Faktorët që karakterizojnë klimën në këtë zonë janë: a) Pozita gjeografike (afërsia me detin); b) Ndikimi i cikloneve dhe anticikloneve që e rregullojnë atë, dhe c) Morfologjia e rajonit (nga VNM

Paraparak për Naim Frashëri 2016).

4.4 Mjedisi Biologjik

• Flora

Rajoni Bregdetar Jugor i Shqipërisë karakterizohet nga një diversitet i konsiderueshëm i florës, habitateve dhe shoqërimeve bimore me një rëndësi të veçantë kombëtare. Një sërë specimesh të bimësisë së zonës shfaqen në listën kombëtare të specieve të rralla, një numër i konsiderueshëm i bimëve dallohen për interesin e tyre të veçantë shkencor, ndërkohë që shumë prej tyre janë me vlera të veçanta ekonomike si bimë mjekësore, vajore, industriale ose bimë dekorative etj. Bregdeti Jugor i Shqipërisë përfaqëson një udhëkryq të rëndësishëm të rrugëve migratore të florës në rajonin e Ballkanit. Zona është shumë e pasur me pothuajse 1,400 specie të bimëve vaskulare (që përfaqësojnë më shumë se 40% të totalit të florës së Shqipërisë). Llojet kryesore të habitateve me bimësi natyrore që gjenden në zonat Bregdetare Jugore janë¹⁰:

- Bimësia e ultësirave ose pyje me gjelbërim të përhershëm dhe shkurre,
- Pyjet mesdhetare me pisha (Shoq. *Pistacio- Pinetum halepensis*), që nuk janë indigjene për zonën,
- Komunitete bimore të mbizotëruara nga *Euphorbia dendroides*, *Pistacialentiscus-Allianca oleo*
- *Ceratonion*(Shoq. *Pistacxio – Euphorbietum dendroides*),
- Bimësi Frigana (Shoq. *Chrysopogono – Phlometum fruticosae*, Shoq. *Ericetum manipuliflorae*),
- Bimësia pseudo-stepë e mbizotëruar nga *Brachypodium ramosum* (Shoq. *Brachypodium ramosi*),
- Pyje me lisa gjetherënës (Shoq. *Quercetum frainetto*),
- *Quercus ithaburensis subsp. macrolepsis*,
- Pyjet halore malore (Shoq. *Pineto – Abietetum borissi-regis*), dhe
- Pyje që mbizotërohen nga *Pinus leucodermis* (Shoq. *Pinetum leucodermis typicum*).

Një numër i madh i specieve të rralla dhe të rrezikuara të Shqipërisë gjenden në këtë zonë. Shumë specie bimore endemike dhe relikte gjenden brenda zonës së studimit.

• Fauna

Bregu i Jugut të Shqipërisë ka një diversitet të pasur të faunës. Në veçanti, zona ka një faunë shumë të pasur me insekte (jo vertebrorë). Krahas kësaj, 11 lloje amfibësh (nga 15 specie të njohura në vend), 30 specie zvarranikësh (nga 37 specie të njohura në vend) mund të gjenden në këtë zonë. Rreth 250 specie zogjsh janë raportuar nga zona, nga 330 lloje të njohura në vend, duke e bërë rajonin e Bregdetar Jugor një zonë shumë të rëndësishme për zogjtë. Zona është një vend i rëndësishëm për shpendët grabitqarë me skifterin kthetrazi dhe hutën egjiptiane. Shpendët këngëtarë po ashtu kanë një diversitet të lartë falë larmisë së konsiderueshme të topografisë dhe habitateve. Zogjtë ujqorë janë të rëndësishëm në pjesën jugore të zonës, ku Liqeni i Butrintit është përcaktuar së fundmi si një zonë Ramsar, për shkak të numrit të madh të zogjeve ujqorë.

Zona e studimit është shumë e pasur me gjitarë. Rreth 55 specie nga 71 specie të njohura në Shqipëri mund të hasen përgjatë Bregdetit Jugor të Shqipërisë. 17 lloje gjitarësh renditen në Listën e Kuqe të Gjitarëve të Kërcënuar Botërisht.

¹⁰ nga: MedWedCoast 2005: Management Plan. Complex: Llogara - Rrëza e Kanalit - Dukat - Orikum - Tragjas Radhimë - Karaburun. Final Draft. [Drafti Përfundimtar i Planit të Menaxhimit. Kompleksi: Llogara - Rrëza e Kanalit - Dukat - Orikum - Tragjas Radhimë - Karaburun] GEF/UNDP-MM Conservation of Wetland and Coastal Ecosystem in the Mediterranean Region [Konservimi i Ekosistemeve të Ligatinave dhe Bregdetare në Rajonin Mesdhetar].

• Zonat e Mbrojtura

Një gamë e gjerë habitatesh gjenden në zonën e studimit të tilla si: ekosistemet e maleve të larta (deri në 2,000 m); kullota alpine dhe sub-alpine; lloje të ndryshme të pyjeve (halore të përziera dhe gjethegjërë, gjethegjërë të përzierë të mbizotëruar nga pemë me gjelbërim të përherëshëm, shkurre dhe makiet, pyjet aluviale); kullota fushore; rërë dhe shkëmbinj bregdetare; ligatinat bregdetare si ajo e liqenit të Butrintit, Liqeni i Bufit (Rreza) dhe Laguna e Orikumit; përrrenjtë dhe burimet karstike; shpella, etj.

Përmbledhja në Aneksin Nr. 3 paraqet statusin dhe të dhënat gjeografike të zonave të mbrojtura natyrore të cilat janë në zonën e influencës së projektit. Një tabelë e zonave të mbrojtura në zonën e projektit është paraqitur më poshtë referuar Agjencisë së Zonave të Mbrojtura.

http://akzm.gov.al/qgis2web_2019_05_13-09_58_25_161000/index.html.

Tabela 7. Zonat e Mbrojtura në Rajon

Nr.	Emri i Zonave të Mbrojtura	Vendndodhje	Shënime
1	Vjosë-Nartë	Vlorë	Peizazh i mbrojtur
2	Karaburun	Vlorë	Rezervë natyrore e mbrojtur dhe Park Natyror
3	Karaburun-Sazan	Vlorë	Park Kombëtar
4	Llogara	Vlorë	Park Kombëtar
5	Porto Palermo	Vlorë	Peizazh i mbrojtur
6	Butrinti	Saranda	Park Kombëtar, Zonë e Trashëgimisë Kulturore UNESCO, dhe zonë

4.5 Socio-ekonomike

Përgjithësisht, grupet e cënueshme dhe të disavantazuara në Shqipërinë e jugut ku do të zbatohet projekti së bashku me FSH përfshijnë të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, personat me sëmundje kronike, migrantët, familjet me prind të vetëm, banorët në zonat malore me akses të kufizuar dhe komuniteti Rom dhe egjiptian. Grupet e cënueshme dhe të disavantazuara që mund të ndikohen nga ose që kanë gjasë të përfitojnë nga ndërhyrjet e projektit do të identifikohen si pjesë e procesit të vlerësimit M & S të nivelit të nënprojektit, dhe do të merren masa për të siguruar që ata nuk do të hasin ndikime negative në nivel të konsiderueshëm dhe se do të marrin përfitimet nga nënprojekti.

Bazuar në Censurin e viti 2011, popullsia e bashkisë Sarandë ka pasur një rritje me 18% gjatë 10 viteve të fundit. Në këtë bashki ka gjithashtu një mbizotërim të vogël të meshkujve. Sektorët ekonomikë kyç përfshijnë shërbimet publike, arsimin, ndërtimin, shërbimet financiare dhe biznesin, transportin, telekomunikacionin, prodhimin, turizmin dhe argëtimin, industrinë kulturore, bujqësinë dhe blegtorinë. Në territorin e vet, bashkia përfshin Liqenin e Butrintit (rreth 14 km larg), që është një zonë me rëndësi për prodhimin e midhjeve dhe peshkimit në lagunë.

Papunësia përbën problem në Sarandë, sikurse dhe në mbarë vendin. Numri zyrtar i të papunësuarve është i lartë, por duhet të përmendet se një pjesë e rëndësishme e forcës punëtore punon në mënyrë joformale, megjithëse janë ndërmarrë hapa nga qeveria qendrore për të reduktuar joformalitetin. Shumica e popullsisë është e punësuar në ndërmarrje private, por edhe në zyra shtetërore.

4.6 Trashëgimia Kulturore

Qendra urbane e Sarandës konsiderohet dhe miratohet si një zonë arkeologjike e kategorisë A dhe B. Zona e kategorisë A ka mbrojtje më të lartë. Zona të rëndësishme të identifikuara në këtë bashki përfshijnë

- segmentin nga fillimi i shëtitores “Hasan Tahsini” deri në zonën e Limanit ku gjendet dhe rrënoja më me vlerë dhe e ruajtur, ajo e “Portës së hyrjes së Onhezmit”.
- Zona përreth Hotel Republikës ku ndodhen rrënojat e Depozitave Romake
- Zona përreth Shkallares E ku mendohet se ndodhen muret hipotetike të Kështjellës së Onhezmit.

Site të tjera në këtë bashki që janë me interes të veçantë për sa i përket trashëgimisë arkeologjike, janë parku arkeologjik i Butrintit dhe objekte të tjera të rëndësishme si Manastiri i 40 Shenjtorëve, Kalaja e Lëkurësit, Manastiri i Shën Gjergjit, rrënojat e fortesës së qytetit (nga VNM Paraparak për Naim Frashëri 2016).




Figura 3. Harta e Zonave të Mbrojtura të Shqipërisë

5.0 Ndikimet e Parashikuara Mjedisore dhe Sociale dhe Masat Zbutëse

Ky seksion paraqet ndikimet e parashikuara mjedisore dhe sociale të projektit të propozuar dhe gjithashtu paraqet dhe masat e përgjithshme zbutëse për të minimizuar, e pse jo eliminuar, ndikimet e mundshme negative, me qëllim sigurimin që ndërhyrjet sipas projektit të propozuar të mos shkaktojnë ndikime mjedisore dhe/ose sociale përtej nivelit të pranueshëm.

5.1 Rreziqet e Përgjithshme Mjedisore dhe Sociale

PZHIUT-ja e vazhdueshme përqendrohet në përmirësimin e infrastrukturës urbane për të rritur tërheqjen dhe banimin në katër qendra urbane në jug të Shqipërisë, konkretisht Berat, Gjirokastrë, Sarandë dhe Përmet; në rritjen e tërheqjes turistike dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pasurive të përzgjedhura të trashëgimisë kulturore në jug të Shqipërisë; në ngritjen e kapacitetit të bashkisë për të ofruar shërbime dhe për menaxhimin e destinacioneve turistike, në bashkëpunim me Qeverinë kombëtare. FSH-ja do të ndjekë të njëjtën qasje sikurse PZHIUT-ja e vazhdueshme dhe do të rrisë investimin në dy vendndodhje të reja në jug të Shqipërisë (Ksamil dhe Orikum).

Veprimtaritë në Komponentët 1, 2 dhe 3 do të përfshijnë përmirësimin e shërbimeve infrastrukturore (punimet civile, veprimtari të rehabilitimit dhe ndërtimit) në këto qytete të përzgjedhura.

5.2 Ndikimet Pozitive të Projektit

Projekti i propozuar parashikohet të ketë ndikime pozitive në ekonomi dhe në marrëdhëniet shoqërore të zonave të projektit dhe të vendit. Disa nga ndikimet pozitive përfshijnë:

- Akses më i lehtë në destinacionet turistike
- Numër më i lartë turistësh
- Struktura turistike të përmirësuara
- Fuqizim i sektorit turistik
- Rritje ekonomike
- Mundësi punësimi/biznesi
- Përmirësim të stilit të jetesës së komunitetit vendas
- Mbrojtje mjedisore e siteve turistike/të trashëgimisë
- Pjesëmarrja e grave në industrinë e turizmit mund të krijojë më shumë mundësi për turistet femra

5.3 Ndikimet e Parashikuara të Projektit

Ky KMMS është përgatitur për të përcaktuar udhëzimet për agjencinë e zbatimit të FSHZH-së për të përgatitur më tej PMM-të/PVZH-në për të zbutur ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale për shkak të nënprojekteve gjatë fazës së ekzekutimit. Më poshtë renditen ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale të veprimtarive të projektit të propozuar:

➤ Erozioni i tokës dhe Kontaminimi

Janë parashikuar ndikimet e mëposhtme në cilësinë e dherave si rezultat i ndërhyrjeve të projektit të propozuar:

- Operacionet e gërmimit/prerjes së tokës, pastrimi i bimësisë dhe veprimtaritë e nivelimit të tokës mund të destabilizojnë sipërfaqen e tokës përreth.
- Materialet e papërdorura dhe mbeturinat e prodhuara nga materialet e shfrytëzuara, nëse lihen siç janë dhe lejohen të përzihen me dherat nëntokë, mund të përkeqësojnë cilësinë e dherave ekzistues.
- Rrjedhjet e naftës, lubrifikantëve, lëndëve kimike dhe lëndëve të tjera të ngjashme nga vendet e depozitimit të tyre dhe nga motorët e gjeneratorëve, makinerive, pajisjeve dhe mjeteve mund të dëmtojnë dherat ekzistues dhe mund të cenojnë aftësinë e dherave të dëmtuar për të mbështetur rritjen e bimësisë dhe bimëve.

Zbutja:

- Gërmimet duhet të jenë të kufizuara në përputhje me skicat inxhinierike dhe shtresa e sipërme pjellore e dherave duhet të veçohet dhe të plugohet sërish pas përfundimit të detyrave.
- Të gjithë dherat e dëmtuar do të flaken në zonat e përcaktuara dhe zona do të rikthehet sërish në gjendjen fillestare.
- Duhet të shmanget përdorimi i makinerive të rënda në dhera të lagësht për të parandaluar dëmtimin e strukturës së tokës.
- Nafta, lubrifikantët, lëndët kimike dhe materialet e tjera të rrezikshme të përcaktuara duhet të ruhen në mënyrë të sigurt në vendet e caktuara, depot ose magazinat, që duhet të jenë të mbrojtura nga reshjet dhe larg burimeve të mundshme të zjarrit. Duhet të zbatohet Udhëzimi i Bankës Botërore për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë mbi Rreziqet Kimike.
- Të gjithë materialet e papërdorura dhe të tepruara duhet të hiqen plotësisht nga kantieri pas përfundimit të ndërtimit dhe zona do të rikthehet në gjendjen fillestare ose thuajse fillestare.

➤ **Ndotja e Ajrit**

- Cilësia e ajrit do të ndikohet nga emetimet e punimeve nga kantieri i ndërtimit nëpërmjet makinerive, impianteve të asfaltit, rrugëve të kalimit, guroret dhe qarkullimit të mjeteve etj.
- Emetimet mund të përshkojnë distanca të gjata në varësi të shpejtësisë dhe drejtimit të erës, temperaturës së ajrit dhe qëndrueshmërisë atmosferike. Ndotja e ajrit mund të shkaktojë sëmundje të rrugëve të frymëmarrjes.

Zbutja:

- Emetimet dhe cilësia e ajrit të ambientit do të menaxhohen në bazë të Udhëzimeve të Bankës Botërore për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë për Emetimet e Ajrit dhe Cilësinë e Ajrit të Ambientit.
- Teknikat e pakësimit të pluhurit, si për shembull spërkatja e rregullt me ujë, duhet të kryhen për të pakësuar emetimet e tepërta të pluhurit.
- Mjetet që përdoren për ndërtim duhet të përshtaten si duhet dhe rregullisht për të

kontrolluar emetimet e gazrave.

- Punëtorët e ndërtimit duhet të pajisjen me maska për t'u mbrojtur ndaj thithjes së tymit.
- Shpejtësia e mjeteve në zonën e projektit duhet të jetë më e ulët se sa 20 km/orë dhe të kontrollohet zbatueshmëria.

➤ **Ndotja Akustike**

- Zhurmat parashikohen të prodhohen nga kampet e ndërtimit, makineritë e rënda si buldozerët, eskavatorët, stabilizuesit, makinat e përzierjes së betonit, çekiçet pneumatikë dhe pajisjet e tjera.
- Zhurma që prodhohet nga makineritë e ndërtimit ka gjasa të ndikojë receptorët e ndjeshëm të vendosur brenda një rrezeje prej 500 metrash nga zona e projektit.
- Rreziqet shëndetësore që lidhen me ekspozimin ndaj niveleve të vazhdueshme të zhurmës përfshijnë rritjen e presionit të gjakut, hipertensionin, bezdisjen dhe shqetësimet e gjumit etj.

Zbutja:

- Pajisja e punëtorëve të ndërtimit me mbrojtje të përshtatshme të dëgjimit si tapat e veshëve ose veshoret dhe trajnimi i punëtorëve mbi përdorimin e tyre.
- Përdorimi i pajisjeve me nivele më të ulëta të zhurmës
- Instalimi i mbytësve të zhurmës për ventilatorët
- Instalimi i mbytësve të zhurmës të përshtatshëm në marmitën e motorit dhe komponentët e kompresorit
- Kufizimi i orëve të përdorimit të pajisjeve të caktuara ose veprimeve me to, veçanërisht mjeteve që përbëjnë burim ndotjeje që përdoren në zonat komunitare
- Caktimi i pikave të përzierjes së betonit dhe depozitimit të materialeve të paktën 2 km larg zonave të banuara, veçanërisht shkollave dhe qendrave shëndetësore
- Përzgjedhja e impianteve ose pajisjeve moderne dhe të mirëmbajtura me nivele të ulëta zhurme të mundësuar nga teknika të integruara të reduktimit të zhurmës ose pajisje të posaçme për mbytjen e zhurmës;
- Makineritë e rënda si çekiçet me perkusion dhe pneumatikë nuk duhet të përdoren gjatë natës
- Zbatoni Udhëzimet e Bankës Botërore për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë mbi Menaxhimin e Zhurmës

➤ **Kontaminimi i Burimeve të Ujërave Sipërfaqësore**

- Veprimtaritë e përfshira në këtë projekt mund të dëmtojnë dhe kontaminojnë burime të rëndësishme ujore në zonat e projektit. Burimet e ndotjes së ujërave sipërfaqësore përfshijnë
- rrjedhjet nga kantieret e ndërtimit me ngarkesë të lartë sedimentesh, derdhja e karburanteve, lëndëve kimike dhe lubrifikantëve dhe ujërave të ndotura nga punimet e ndërtimit.
- Megjithatë, ndikimi do të jetë i përkohshëm dhe vetëm për kohëzgjatjen e ndërtimit dhe rehabilitimit.

Zbutja:

- Shmangia e shkarkimit të ujërave të ndotur nga punimet e ndërtimit në trupat ujore
- Shmangia e erozionit të tokës në zonat ujëndarëse për të mbrojtur burimet ujore
- Devijimi i shkarkimeve nga kantieri i ndërtimit në një mjedis pritës
- Mundësimi i rezervuarëve septikë për kampet e ndërtimit
- Shmangia e hedhjes së materialeve të rrezikshme veçanërisht pranë lumenjve dhe përrrenjve sezonalë.
- Përgatitja nga ana e Kontraktorit e Planit të Reagimit në rast Emergjence për adresimin e derdhjes aksidentale të karburanteve dhe materialeve të rrezikshme.
- Zbatoni Udhëzimin e Bankës Botërore për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë për shkarkime të ndotësve të prodhuar nga veprimtaritë e lidhura me projektin.

➤ **Pastrimi i Bimësisë/Prerja e Pemëve**

- Disa aspekte të nënprojekteve mund të kërkojnë prerjen e pemëve, duke ndikuar pamjen e zonës dhe duke reduktuar përhithjen e karbonit.
- Prerja e pemëve mund të shkaktojë humbjen e habitateve të disa specieve të gjallesave të egra. Disa nga pemët në zonë mund të jenë me rëndësi ekologjike dhe të shërbejnë si identifikuese të ekosistemit përkatës.

Zbutja:

- Përshtatja dhe projektimi i kantierit për të minimizuar prerjen e pemëve.
- Shmangia e zonave kritike të çiftimit të kafshëve.
- Mbjellja e një numri të caktuar pemësh të së njëjtës specie me ato të prera për t'i kompensuar në raport me 1 pemë të cenuar.
- Politikat Operacionale të Bankës Botërore mbi Habitatet Natyrore (OP/BP 4.04) dhe Pyjet (OP/BP 4.36) duhet të zbatohen rreptësisht.

➤ **Shqetësimi i Habitatit Natyror**

Ndërhyrjet e projektit do të kryhen në zona me prani të biodiversitetit dhe habitateve natyrore. Veprimtaritë e projektit mund të shkaktojnë shqetësim të këtyre habitateve natyrore gjatë ndërtimit dhe veprimeve. Duhet të tregohet kujdes për të mbrojtur veçoritë natyrore kryesore duke përfshirë pemët dhe bimët.

Zbutja:

- Zhvillimi i një plani të posaçëm menaxhimi për kantierin për çdo zonë të mbrojtur
- Politikat Operacionale të Bankës Botërore mbi Habitatet Natyrore (OP/BP 4.04) dhe Pyjet (OP/BP 4.36) duhet të zbatohen rreptësisht.

➤ **Shëndeti dhe Siguria në Vendin e Punës**

- Aksidentet në vendin e punës mund të shkaktojnë lëndime dhe vdekje.
- Punëtorët mund të ekspozohen ndaj një mjedisi pune të pasigurt dhe/ose të pafavorshëm për shkak të ruajtjes, trajtimit dhe transportit të materialeve të rrezikshme ndërtimore.

- Veprimtaritë ndërtimore dhe lëvizja e mjeteve në kantieret e ndërtimit dhe rrugët e shërbimit mund të shkaktojnë aksidente rrugore që prekin veçanërisht komunitetet vendase që nuk janë të mësuar me praninë e pajisjeve dhe makinerive të rënda.

Zbutja:

- Zbatimi i rreptë i Udhëzimeve të Bankës Botërore për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë nga ana e Kontraktorit
- Sigurimi i shërbimeve të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë (ndihma e parë, pika e shpëlarjes së syve)
- Shkrimi i procedurës së emergjencave për kantieret në zona të largëta
- Mundësimi i trajnimit bazë të punëtorëve mbi Shëndetin dhe Sigurinë në Punë
- Sigurimi nga ana e Kontraktorit që punëtorët të përdorin PMP-të
- Njoftimi publik në kohën e duhur mbi punimet e planifikuara të ndërtimit.

➤ **Rreziqet e zjarrit**

- Zjarret mund të shkaktohen si pasojë e zjarreve të ndezura për qëllime të ndryshme dhe nga burime ose veprimtari të tjera, dhe kjo mund të përbëjë rrezik serioz për shëndetin dhe sigurinë.

Zbutja:

- Caktimi i një pike grumbullimi në rast zjarri
- Caktimi i zonave të posaçme për ndezjen e zjarreve në kampin e ndërtimit
- Zhvillimi i planit të gatishmërisë dhe reagimit në rast emergjence nga ana e Kontraktorit në përputhje me Udhëzimet e Bankës Botërore për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë

➤ **Problematikat e Trafikut**

- Projekti parashikohet të rrisë numrin e turistëve në zonat e përzgjedhura, prandaj, pritet që trafiku të rritet pas zbatimit të projektit
- Pritet një rritje e mundshme në lëndimet dhe vdekjet e shkaktuara nga aksidentet rrugore

Zbutja:

- Sigurimi i zonave të përshtatshme të parkimit
- Zbatimi i opsioneve më të mira të sigurisë gjatë transportit për të parandaluar aksidentet rrugore
- Përdorimi i pajisjeve të kontrollit të shpejtësisë (ngadalësuesit)
- Mirëmbajtja e rregullt e mjeteve dhe pajisjeve
- Zbatimi i udhëzimeve të Bankës Botërore për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë

➤ **Rreziqet Natyrore**

- Reziqet natyrore si përmytjet, zjarret, tërmetet, rëniet e strukturave ndërtimore, strukturat e vjetra monumentale mund të jenë fatale dhe të shkaktojnë lëndime serioze të forcës punëtore ose turistëve.

Zbutja:

- Zhvillimi i një Plani të Gatishmërisë dhe Reagimit në rast Emergjence (PGRE) nga ana e Njësisë Zbatuese të Projektit në përputhje me Udhëzimin e Bankës Botërore për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë. PGRE duhet të përmbajë minimalisht informacion të përcaktuar në Udhëzimin e Bankës Botërore për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë.
- Vendosja e fiksive të zjarrit në vende të ndryshme të zonës së projektit
- Kryerja e përshtatjeve për menaxhimin e fatkeqësive në zonat me gjasa për fatkeqësi

➤ **Marrja e Tokës dhe Zhvendosja**

- Ndërhyrjet e nënprojekteve mund të kërkojnë hapësirë të caktuar toke që mund të shkaktojë shqetësime sociale, humbje të mjeteve të jetesës dhe mund të përshkallëzojë konfliktet sociale dhe kulturore ndërmjet njerëzve.

Zbutja:

- Trajtimi i problematikave të Marrjes së Tokës dhe Zhvendosjes në përputhje me rregulloret kombëtare dhe politikën e Bankës Botërore mbi Zhvendosjen e Pavullnetshme (OP/BP 4.12)
- Rihartimi i projektit kur është e mundur për të minimizuar marrjen e tokës
- Konsultimi me pronarët/përdoruesit/komunitetet e pronës në fjalë dhe marrja e miratimit të tyre në fazën e hershme të procesit të zhvillimit të projektit
- Lejimi i personave të prekur që të rikuperojnë pronat e tyre (duke përfshirë të mbjellat) përpara mobilizimit të kantierit për fillimin e punës
- Sigurimi i pagesës së kompensimit të drejtë dhe të duhur për të gjithë personat e prekur përpara nisjes së veprimtarive të ndërtimit në përputhje me dispozitat e KPZH-së.
- Marrja e lejeve të zhvillimit të kërkuara nga Asambletë përkatëse përpara fillimit të punës

- **Ndikimet e tërthorta**

- Projekti mund të ketë disa ndikime të tërthorta në veçoritë e ndjeshme mjedisore dhe sociale të zonave të projektit.

Zbutja:

- Zhvillimi i planit të menaxhimit për mbrojtjen e liqeneve në zonat e projektit, në rast se ndonjë nga veprimtaritë e projektit ndodhet pranë trupave ujore, veçanërisht liqeneve.
- Zhvillimi dhe zbatimi i planit të menaxhimit për nënprojektet që mund të ndikojnë habitatet e ndjeshme.

Ndikimi i përgjithshëm dhe udhëzimet e zbutjeve të propozuara për adresimin e ndikimeve të konsiderueshme paraqiten në tabelën 8.

Tabela 8: Ndikimi Mjedisor dhe Social dhe Zbutja

Ndikimi Mjedisor, Social dhe Shëndetësor	Masat Zbutëse të Propozuara
Cilësia e Ajrit	<p>Faza e ndërtimit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ngarkesat e dherave/rërës dhe çimentos gjatë transportit do të mbulohen mirë për të reduktuar ngritjen e niveleve të pluhurit mbi ato të pranueshme. • Grumbujt e dherave të ekspozuar dhe rrugët e pashtruara të kalimit do të spërkatën me ujë për të kontrolluar nivelet e pluhurit. • Do të përdoren karburant dhe lubrifikantë me cilësi të mirë në mjetet, pajisjet dhe makineritë. • Do të sigurohet që pirgjet me rërë që transportohen për punimet e ndërtimit të jenë të mbuluara me mushama të gomuar për të parandaluar shpërhapjen e grimcave me anë të erës dhe ujit. • Do të fiken motorët e mjeteve, makinerive dhe pajisjeve të tjera kur nuk janë në përdorim. • Do të kryhet shërbim dhe mirëmbajtje e rregullt e planifikuar e të gjitha mjeteve dhe pajisjeve për të minimizuar emetimet e gazrave. • Punimet e ndërtimit dhe ato civile do të pakësohen ose kontrollohen për të reduktuar emetimet nga pajisjet dhe makineritë në përdorim. <p>Faza operationale</p> <ul style="list-style-type: none"> • Do të vendosen shenja të përshtatshme rrugore në rrugët e pashtruara për të kufizuar shpejtësinë e mjeteve • Do të vendosen ngadalësues shpejtësie të projektuar dhe ndërtuar siç duhet në rrugët e kalimit
Dridhja dhe Zhurma	<p>Faza e ndërtimit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Gërmimet dhe veprimtaritë ndërtimore do të kryhen gjatë orëve të ditës. • Përzierësi i betonit dhe makineritë dhe pajisjet e tjera të ndërtimit do të vendosen larg receptorëve mjedisorë të ndjeshëm. • Pajisjet dhe makineritë e ndërtimit do të mirëmbahen dhe do t'iu kryhet rregullisht shërbimi për të reduktuar prodhimin e zhurmës gjatë përdorimit. • Do të fiken motorët e mjeteve, makinerive dhe pajisjeve të tjera kur nuk janë në përdorim. • Punimet tokësore dhe veprimtaritë e tjera ndërtimore do të pakësohen ose do të kontrollohen për të reduktuar prodhimin e zhurmës gjatë ndërtimit. • Banorët fqinjë dhe aktivitetet tregtare do të njoftohen paraprakisht lidhur me projektin përpara përgatitjes së kantierit nga Kontraktori • Puna nuk do të kryhet gjatë orëve/periudhave të ditës/vitit të ndjeshme me qëllim shmangien e shqetësimit të faunës. <p>Faza Operacionale</p> <ul style="list-style-type: none"> • Do të vendosen shenja të dukshme në vende të posaçme që lajmërojnë turistët për zhurma të larta që mund të shqetësojnë faunën apo veprimtari të tjera.
Ndërhyrjet Pamore	<ul style="list-style-type: none"> • Do të informohet publiku mbi projektin nëpërmjet shenjave dhe tabelave të posaçme përpara aksesimit të kantierëve nga ana e Kontraktorit; • Veprimtaritë ndërtimore do të kryhen në seksione me qëllim reduktimin e ndikimeve të ndryshimit dhe ndërhyrjeve pamore për publikun e përgjithshëm. • Kantieret e ndërtimit do të jenë të veçuara nga publiku. • Në kantieret e ndërtimit do të ndiqen masat e mirëmbajtjes së duhur, si pastrimi. • Do të sigurohet që zona të jetë e pranueshme pas ndërtimit sipas dispozitave të kontratës. • Objektet për turistët do të projektohen dhe ndërtohen në mënyrën e duhur për t'iu përshtatur me mjedisin natyror.
Ndotja e Burimeve Ujore	<p>Faza e ndërtimit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Punimet nuk do të ekzekutohen në kushte atmosferike agresive si reshjet ose stuhitë. • Në asnjë seksion të trupave ujorë nuk duhet të hidhen mbetje të ngurta, karburante ose naftë.

	<ul style="list-style-type: none"> • Ndërtimi do të kryhet në seksione për të minimizuar ndikimet dhe ekspozimin e dherave. • Materialet e gërmuara dhe lymi, që nuk mund të përdoren, do të hidhen në zonat e përshtatshme sipas Planit të Menaxhimit të Mbetjeve të përgatitur nga Kontraktori dhe të miratuar nga Asambleja. • Në zona të pjerrëta do të ngrihen barriera të përkohshme sedimenti për të parandaluar depërtimin e lymit në rrjedhat ujore. • Mirëmbajtja, mbushja me karburant dhe pastrimi i mjeteve dhe pajisjeve do të kryhet në punishte jashtë kantierit duke zbatuar masa të përshtatshme për parandalimin e rrjedhjeve. <p>Faza operacionale</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në zonat turistike do të ngrihen mjedise të përshtatshme sanitare për shmangien e shkarkimit të mbetjeve në trupat ujorë. • Komunitetet pritëse do të pajisjen me tualete të mjaftueshme dhe do të sensibilizohen për përdorimin e tyre me qëllim shmangien e kryerjes së nevojave në publik.
<p>Prodhimi dhe hedhja e mbetjeve</p>	<p>Duhet të zbatohen parimet e Reduktimit, Riciklimit, Ripërdorimit dhe Rikuperimit për menaxhimin e mbetjeve nëpërmjet veprimeve të mëposhtme:</p> <p>Faza e ndërtimit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Materialet e gërmuara nga toka, në masën maksimale të mundshme, do të ripërdoren për mbylljen e gropave me qëllim reduktimin e mbetjeve. • Mbetjet e ngurta të gërmuara nga kanalet e kullimit që janë të papërshtatshme për mbylljen e gropave do të grumbullohen në kantier, do të lihen të zbrazen dhe do të grumbullohen për t'u hedhur në landfillet e miratuara. • Do të sigurohet dorëzimi i numrit të nevojshëm të materialeve të ndërtimit në kantier me qëllim reduktimin e gjasave për tepricë materiale. • Do të vendosen kosha në kantier për mbajtjen e përkohshme të mbeturinave si mbajtësit e lubrifikantëve, pakot e ujit të pijshëm dhe çantat mbajtëse/materialet e paketimit. • Do të sigurohet përdorimi i duhur i materialeve të ndërtimit, si tubat, lateritet, rëra etj., për të reduktuar mbetjet. • Kontraktori do të punojë sipas një Plani të përgatitur dhe të miratuar për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta. <p>Faza Operacionale</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në pika të posaçme do të vendosen kosha mbeturinash për përdorim nga publiku. • Në vende të përshtatshme do të vendosen shenja paralajmëruese kundër ndotjes, bashkërisht me sanksionet e mundshme. • Do të bëhen marrëveshje me shoqëritë e grumbullimit të mbetjeve nëpërmjet Asamblesë me qëllim grumbullimin dhe hedhjen e rregullt të mbetjeve të ngurta.
<p>Shëndeti dhe Siguria publike</p>	<p>Faza e ndërtimit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Punimet në kanalet e ekspozuara dhe materialet nga toka, në masën maksimale të mundshme, do të përfundojnë përpara gërmimeve të reja dhe hapjes së kanaleve të rinj. • Zonat e punimeve do të kufizohen në mënyrën e duhur me qëllim shmangien e shkelësve kureshtarë, veçanërisht fëmijëve. • Përreth zonave të punimeve do të vendosen shenja paralajmëruese për të shkurajuar shkelësit. • Kontraktorët do të garantojnë sigurinë e duhur në kantieret e ndërtimit për të shmangur vjedhjen ose shkatërrimin e pronës. • Do të sigurohet shikueshmëri gjatë natës nëpërmjet ndriçimit të përshtatshëm. <p>Faza Operacionale</p> <ul style="list-style-type: none"> • Duhet të nxiten drejtuesit e komunitetit që të krijojnë komitete vëzhgimi për të përmirësuar sigurinë • Duhet të punohet me policinë për të ngritur stacione policie në të gjitha pikat turistike kryesore • Pikat e ndihmës së parë do të jenë të disponueshme në të gjithë kantieret me përshtatjet e duhura me pikat shëndetësore vendase për të trajtuar urgjencat.
<p>Shëndeti dhe Siguria në Vendin e Punës</p>	<p>Faza e ndërtimit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Duhet të angazhohen mjeshtrë me përvojë për punimet e ndërtimit.

	<ul style="list-style-type: none"> • Të gjithë punëtorët duhet të udhëzohen/orientohen në mënyrën e duhur mbi sigurinë. • Kontraktorët do të kenë Politika dhe Procedura për Shëndetin dhe Sigurinë me qëllim orientimin e veprimtarive të ndërtimit. • Pajisjeve dhe makinerive do t’iu kryhen shërbimet rregullisht për të siguruar që janë në gjendje të mirë pune. • Duhet të mundësohen kuti të ndihmës së parë në kantier si dhe një person i trajnuar për dhënien e ndihmës së parë, duhet të mundësohen dhe të zbatohet përdorimi i pajisjeve mbrojtëse personale (PMP) të përshtatshme, si çizme mbrojtëse, xhaketa reflektuese, kaska, doreza për duart, tapa veshësh, maska mbi hundë etj. • Do të kërkohet dëshmi kompetence për të gjithë operatorët e pajisjeve/makinerive dhe kjo do të vërtetohet nëpërmjet shqyrtimit të licensave ose dokumenteve të vlefshme të drejtuesve ose operatorëve. • Do të zbatohen të gjitha rregullat dhe rregulloret e kantierit. • Do të vendosen sanksione në rastet e mosrespektimit të procedurave të sigurisë. ✓ Takimet në kantier duhet të rrisin ndërgjegjësimin mbi Shëndetin dhe Sigurinë në Punë. <p>Faza Operacionale</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mbikëqyrësit e parkud do të pajisjen me PMP për mbrojtjen kundër kafshëve të rrezikshme • Mbikëqyrësit e parkud do të armatosen për mbrojtjen kundër gjuetarëve pa leje. • Pikat e ndihmës së parë do të jenë të disponueshme në të gjithë kantieret me përshtatjet e duhura me pikat shëndetësore vendase për të trajtuar urgjencat.
<p>Problematikat e marrjes së tokës dhe kompensimit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Konsultimi me pronarët/përdoruesit/komunitetet e pronës në fjalë dhe marrja e miratimit të tyre në fazën e hershme të procesit të zhvillimit të projektit • Lejimi i personave të prekur që të rikuperojnë pronat e tyre (duke përfshirë të mbjellat) përpara mobilizimit të kantierit për fillimin e punës • Sigurimi i pagesës së kompensimit të drejtë dhe të duhur për të gjithë personat e prekur përpara nisjes së veprimtarive të ndërtimit në përputhje me dispozitat e KPZH-së. • Marrja e lejeve të zhvillimit të kërkuara nga Asambletë përkatëse përpara fillimit të punës
<p>Mbajtja e mjeteve të jetesës</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Duhet të sigurohet pagesa e kompensimeve të përshtatshme ndaj PPP-ve sipas KPZH-së. • Komuniteteve vendase do t’iu jepen mundësi punësimi dhe të tjera sa më shumë të jetë e mundur.
<p>Rreziqet Natyrore</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i një Plani të Gatishmërisë dhe Reagimit në rast Emergjence (PGRE) nga ana e Njësisë Zbatuese të Projektit në përputhje me Udhëzimin e Bankës Botërore për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë. PGRE duhet të përmbajë minimalisht informacion të përcaktuar në Udhëzimin e Bankës Botërore për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë. • Duhet të vendosen fikse të zjarrit në vende të ndryshme të zonës së projektit • Duhet të kryhen përshtatje për menaxhimin e fatkeqësive në zonat me gjasa për fatkeqësi
<ul style="list-style-type: none"> • Aksidentet nga Zjarri 	<ul style="list-style-type: none"> • Caktimi i një pike grumbullimi në rast zjarri • Caktimi i zonave të posaçme për ndezjen e zjarreve në kampin e ndërtimit • Kontraktori duhet të zhvillojë një Plan të Gatishmërisë dhe Reagimit në rast Emergjence (PGRE) në përputhje me Udhëzimet e Bankës Botërore për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë.

5.4 Strategjia për Zbutjen e Dhunës me Bazë Gjinore (DHBGJ)

Manifestimet e DHBGJ-së përfshijnë, por pa u kufizuar:

- Dhunën fizike (si goditjen me shpullë, me shqelm, të qëlluarin, ose përdorimin e

- armëve);
- Abuzimin emocional (si poshtërimin sistematik, sjelljet kontrolluese, trajtimin degradues, ofendimet dhe kërcënimet);
- Dhunën seksuale, ku përfshihet çdo formë e kontaktit seksual pa pëlqim, përfshirë përdhunimin;
- Martesën e hershme/me detyrim, që është martesë e një individi kundër dëshirës së vet dhe që shpesh ndodh përpara moshës 18 vjeç, e quajtur ndryshe dhe martesë e fëmijëve;
- Abuzimin ekonomik dhe mohimin e burimeve, shërbimeve dhe mundësive (si kufizimi i aksesit në burime financiare, shëndetësore, arsimore ose të tjera me qëllim kontrollimin ose nënshtrimin e personit); dhe
- Trafikimin dhe rrëmbimin për shfrytëzim.
- Dhuna nga partneri intim (DHPI) është dhunë e ushtruar nga një partner aktual ose i mëparshëm, që përfshin një sërë aktesh dhune.

Ndaj, PZHIUT-ja mund të ketë ndikime të mundshme të padëshiruara të disa pjesëtarë të komunitetit dhe është e rëndësishme që këto incidente të identifikohen herët dhe të sigurohet ndërhyrje në kohën e duhur. Këto problematika mund të adresohen brenda kuadrit të MSHA-së për projektin. Megjithatë, për shkak të natyrës delikate të rasteve të abuzimit seksual dhe nevojës për të respektuar privatësinë dhe dëshirat e të mbijetuarve, teknikat e shqyrtimit mund të merren në konsideratë ndryshe nga metodat e përgjithshme të MSHA-së.

- **Vlerësimi i rrezikut të DHBGJ-së**

Duke marrë parasysh zonat e shumta të projektit që mund të kenë shqetësime të ndryshme lidhur me DHBGJ-në, propozohet që në fillim të zbatimit të Projektit, të punësohet një specialist për DHBGJ-në nga NJZP-ja për të kryer vlerësimin e rrezikut të DHBGJ-së me qëllim përcaktimin e nivelit të vëmendjes dhe opsioneve dhe teknikave të zbutjes që nevojiten në secilën zonë të projektit.

- **Projektimi i MSHA-së së ndjeshme ndaj DHBGJ-së**

MSHA-ja e përgatitur për projektin do të shërbejë si baza e projektimit dhe zbatimit të mekanizmave për adresimin e çështjeve të DHBGJ-së. Natyra e ndjeshme dhe konfidenciale e DHBGJ-së do të kërkojë caktimin e një stafi të kualifikuar në terren në zonat e projektit, të cilët do të identifikojnë dhe raportojnë të gjitha rastet tek autoritetet e posaçme.

6.0 Kuadri i Menaxhimit Mjedisor dhe Social

Ky seksion i KMMS-së ofron udhëzime për Projektin lidhur me procedurat që duhet të ndiqen dhe standardet që duhet të përmbushen gjatë zbatimit të projekteve në përputhje me dispozitat kombëtare të mbrojtjes dhe ato të Bankës Botërore. Ky seksion mbulon shqyrtimin mjedisor dhe social të nënprojekteve, monitorimin dhe fuqizimin institucional për zbatimin e nënprojekteve.

6.1 Procesi i Shqyrtimit Mjedisor dhe Social

Sipas OP 4.01 të Bankës Botërore, të gjitha ndikimet e mundshme të padëshiruara në popullatat njerëzore ose në zonat me rëndësi mjedisore, ku përfshihen ligatinat, pyjet, kullotat dhe habitatet e tjera natyrore, janë specifike për zonën; të kthyeshme; dhe për to mund të zhvillohen lehtësisht masa zbutëse.

Shqyrtimi është hapi i parë në procesin e analizës së hollësishme të nënprojekteve, dhe qëllimi i tij është identifikimi i ndikimeve të mundshme të nënprojekteve të propozuara dhe përcaktimi i masave që synojnë të parandalojnë ose të minimizojnë ndikimet negative. Konkretisht, shqyrtimi identifikon rreziqet mjedisore dhe sociale që lidhen me nënprojektin e propozuar dhe përcakton llojin e dokumentacionit të nevojshëm të vlerësimit të ndikimit për zbatimin e nënprojektit. Nënprojektet e shqyrtuara si të Kategorisë A nga FSHZH-ja ose Banka Botërore do të jenë të pranueshme për financim.

Të gjitha aktivitetet e PZHIUT-së do t'i nënshtrohen një shqyrtimi mjedisor për të parandaluar ekzekutimin e projekteve me ndikime të konsiderueshme negative mjedisore. Ndikimet mjedisore vlerësohen dhe gjykohen nga shkalla dhe vlera e efekteve mjedisore të shkaktuara mbi mjedisin fizik, biologjik, ekonomik ose social. Shkallët e ulët, e mesme ose e lartë përfaqësojnë ndikimin ose nivelin e rëndësisë lidhur me një faktor të caktuar. Niveli i ndikimit varet nga kohëzgjatja, kthyeshmëria, shkalla përfitimi, rëndësia etj. Projekti do të ketë përjasjen e propozuar në vijim për adresimin e problematikave mjedisore dhe sociale dhe do të përfshijë instrumentet e mëposhtme mbrojtëse:

- Këtë Kuadër të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (KMMS) të përgatitur para vlerësimit dhe miratimit të PZHIUT-së për të orientuar performancën e përgjithshme mjedisore dhe sociale të Projektit.
- Dy PMMS për aktivitetet që do të fillojnë vitin e parë të cilat janë identifikuar në kohën e vlerësimit: (i) rehabilitimi i kalldrëmit të rrugëve që çojnë në Kalanë e Beratit; dhe (ii) rehabilitimi i shkallareve në qytetin e Sarandës;
- Një shqyrtim paraprak për nënprojektet e identifikuar (për vitin e parë dhe vitet e mëvonshme të zbatimit të projektit) të zgjedhur në përputhje me kriteret specifike, do të identifikojë çështjet që do të përfshihen në Termat e Referencës për Studimet e Fizibilitetit dhe projektimet e detajuara. TeR-et për Studimet e Fizibilitetit do të përfshijnë dispozita për masat mbrojtëse mjedisore dhe sociale, duke përfshirë ndikimet afatgjata, në mënyrë që produktet (SF, projektimi) të përgatiten duke marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në mjedis.
- Gjatë ose pas Studimeve të Fizibilitetit (SF), do të kryhen shqyrtime shtesë nga FSHZH-ja për nënprojektet e propozuara, për të përcaktuar nëse nevojiten Plane të Posaçme për Menaxhimin Mjedisor dhe Social ose VNMS.

- Do të përgatitet Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS) dhe/ose Planet e Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS), dhe instrumente të tjera mbrojtëse sipas nevojës (p.sh. listat mjedisore të kontrollit, Planet e Veprimit për Zhvendosje (PVZH), etj.) nga konsulentë të përzgjedhur nga projektuesi për të gjitha investimet pas përfundimit të Studimeve të Fizibilitetit dhe detajet teknike do të jenë në dispozicion gjatë zbatimit të projektit në vijim të udhëzimit të përcaktuar në këtë KMMS;
- Instrumenti kryesor do të jetë PMMS-ja për të monitoruar të gjitha ndikimet që lidhen me ndërtimin. Shqyrtimi shtesë i projektit do të përcaktojë nëse janë të nevojshëm instrumente të tjerë.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH) do të jetë përgjegjës për të gjitha veprimtaritë e mbrojtjes dhe gjithashtu do të kryejë shqyrtimin mjedisor dhe social paraprak kryesor të nënprojektit të propozuar duke përdorur listën e kontrollit të sugjeruar në **Aneksin 1**. NJKP-ja, nën Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) do të kryejë mbikëqyrjen dhe udhëzimin e NJZP-së.

Në bazën e vlerësimit paraprak të veprimtarive të propozuara, përfituesi do të plotësojë një formular shqyrtimi dhe do t'ia dorëzojë atë FSHZH-së. Bazuar në formularin e shqyrtimit, specialisti mjedisor i FSHZH-së do t'i caktojë nënprojektit kategorinë (Kategoria A, B ose C) për të identifikuar llojin e dokumentit të procesit të vlerësimit mjedisor (due diligence) për secilin nënprojekt. Më konkretisht, gjatë përcaktimit të rrezikut, duhet të merret në konsideratë:

- a. lloji, vendndodhja, ndjeshmëria dhe shkalla e Projektit, duke përfshirë konsideratat fizike të Projektit; llojin e infrastrukturës, vëllimin e mbetjeve të rrezikshme dhe menaxhimin dhe hedhjen e tyre.
- b. kapaciteti dhe angazhimi i Huamarrësit për të menaxhuar këto rreziqe dhe ndikime në një mënyrë që përputhet me Politikën e Mbrojtjes, duke përfshirë politikën e vendit, kuadrin ligjor dhe institucional; ligjet, rregulloret, rregullat dhe procedurat e zbatueshme për sektorin e Projektit, duke përfshirë kërkesat rajonale dhe vendore; kapacitetin teknik dhe institucional të Huamarrësit; historikun e Huamarrësit lidhur me zbatimin e mëparshëm të Projektit; dhe burimet financiare dhe njerëzore të disponueshme për menaxhimin e Projektit;
- c. fusha të tjera rreziku që mund të ndikojnë zbatimin e masave zbutëse mjedisore dhe sociale dhe rezultatet, në varësi të Projektit konkret dhe kontekstit në të cilin zhvillohet, duke përfshirë natyrën e zbutjes dhe teknologjisë së propozuar, konsideratat lidhur me stabilitetin, konfliktin dhe sigurinë në vend dhe/ose në rajon.

6.2 Procesi i Rishikimit Mjedisor

Hapat e mëposhtëm tregojnë rrjedhën e procesit të përgatitjes së dokumenteve të procesit të vlerësimit mjedisor (due diligence):

Hapi 1: Shqyrtimi: Përfituesi (Bashkia ose shoqëria projektuese) përgatit konceptin e nënprojektit (këtu mund të përfshihet projektimi paraprak). Pas diskutimeve joformale me specialistin mjedisor të FSHZH-së, gjatë së cilave FSHZH-ja i bën me dije përfituesit kërkesat e vlerësimit mjedisor, FSHZH-ja do të ndihmojë përfituesin ose projektuesin të finalizojë formularin e shqyrtimit mjedisor në bazë të së cilit specialisti mjedisor i FSHZH-së do të përcaktojë nëse projekti është i pranueshëm për financim sipas KMMS-së.

Hapi 2: Analizimi: Pas formularit të miratuar mjedisor të shqyrtimit, specialistët mjedisorë të FSHZH-së i caktojnë nënprojektit kategorinë mjedisore (B1, B2, B3, që konsiderohen paralele të kategorive A, B dhe C të Bankës Botërore) dhe plotësojnë Raportin e Shqyrtimit dhe njoftojnë përfituesin lidhur me kujdesin e duhur të kërkuar. Megjithatë, përfituesi nuk përgatit dokumentin mjedisor të kujdesit të duhur, por është pjesë e kontratës së projektimit me FSHZH-në, por përgatitja koordinohet me përfituesin.

Në këtë kontratë, FSHZH-së mund t'i duhet të përgatisë dokumentet si më poshtë: VNMS-në paraprake dhe PMMS-në, ose t'i kërkojë MTM-së mendim nëse nevojitet VNMS-ja paraprake. Do të jetë përgjegjësia e përfituesit që të marrë lejet dhe licensat e posaçme që kërkohen nga ligji kombëtar me qëllim lehtësimin e procesit të autorizimit me MTM-në ose autoritetet e tjera përkatëse. Këto kërkesa konsiderohen të veçanta, por paralele me ato të parashtruara këtu (si pjesë e OP 4.01 dhe politikave të tjera të referuara) dhe përfituesi ka përgjegjësinë për t'i zbatuar ato.

Hapi 3: Përgatitja e Raporteve të Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social/Planeve të Menaxhimit Mjedisor dhe Social: Hartimi i Raporteve të Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social do të jetë pjesë e çdo kontrate projektimi të FSHZH-së dhe do të përgatiten në përputhje me kërkesat legjislative kombëtare për marrjen e një lejeje/autorizimi mjedisor. VNMS-ja do të përgatitet nga një ekspert i licensuar për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor (duke përfshirë të licensuarit nga QKL dhe ekstraktin e QKR). VNMS-ja paraprake do të zbatohet edhe Udhëzimet OP 4.01, OP 4.04 të Bankës Botërore për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë.

Në rastin e B3, përfituesi do t'i kërkojë MTM-së brenda një kohe të caktuar mendim nëse VNMS-ja paraprake është e nevojshme dhe do t'i bëjë FSHZH-së me dije vendimin. FSHZH-ja ose konsulenti i FSHZH-së do të kryejë përgatitjen e VNMS-së paraprake. Për çdo VNMS të kërkuar, MTM inspekton raportin e VNMS-së dhe të dhënat e paraqitura dhe konsultohet me ekspertët e vet dhe organe të tjera të posaçme, për shembull të trashëgimisë kulturore, Agjencinë e Zonave të Mbrojtura, etj. Më pas, në mënyrë të shkruar, përgatit një vendim të rekomanduar lidhur me miratimin ose refuzimin e nënprojektit, me arsyen(t) përkatëse.

Hapi 4: Autorizimi: Specialisti Mjedisor i Bankës Botërore do të rishikojë paraprakisht të gjitha kategoritë B1 dhe disa B2 deri sa të sigurohet që cilësia e rishikimit është e përshtatshme në FSHZH. Shumica e nënprojekteve B3 do të rishikohen pas.

Hapi 4: Bërja publike dhe konsultimit: Përfituesi dhe FSHZH (duke përfshirë projektuesin) do të kryejnë publikimin dhe konsultimin (takimin) për VNMS-në dhe/ose PMMS-në, përpara ofertimit të punimeve (dhe pas miratimit të VNMS-të nga MTM-ja). Dokumentet do të publikohen në faqen e internetit të FSHZH-së si dhe në faqen e internetit të bashkisë. Pas finalizimit, projektuesi do t'i dërgojë FSHZH-së dokumentet e finalizuara për ripublikim, së bashku me minutat e konsultimit. VNMS-ja e finalizuar do të bëhet sërish publike në të dyja faqet.

Hapi 5: Aplikimi për Lejen/Autorizimin Mjedisor: Pas marrjes së autorizimit nga Banka Botërore dhe konsultimit publik, por përpara publikimit të Njoftimit për Oferta, do të nënshkruhet një Marrëveshje Investimi me përfituesin e nënprojektit. VNMS-ja dhe/ose PMMS është një pjesë thelbësore e ofertimit për nënprojektin dhe dokumentacionin e kontraktimit. Në varësi të llojit të kërkuar të VNMS-së (ose nëse nuk kërkohet), përfituesi do

të paguajë tarifën për lejen/autorizimin mjedisor ndaj Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit/Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, si dhe do të aplikojë për të marrë lejen mjedisore²⁷. Leja mjedisore duhet të lëshohet përpara nënshkrimit të kontratës së punimeve. . Çdo modifikim/përmirësim i kërkuar nga autoriteti lejues do të jetë përgjegjësi e Kontraktorit të Projektimit për ta reflektuar.

7.0 Kuadri dhe Përshtatjet Institucionale

7.1 Përshtatja Institucionale

Zbatimi i Projektit do të integrohet në strukturat institucionale ekzistuese. Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH) do të vazhdojë të jetë Njësia kryesore Zbatuese e Projektit (NJZP) me përgjegjësi që përfshijnë aspektet e besueshmërisë, menaxhimit financiar (MF) të të ardhurave nga huaja dhe prokurimi i mallrave, punimeve dhe shërbimeve për projektin; pajtueshmërinë me masat e mbrojtjes sociale dhe mjedisore; dhe sigurimin e komunikimit me qytetarët dhe konsultimin, si dhe komunikimin rutinë me Bankën Botërore. Njësia e Koordinimit të Projektit (NJKP) nën Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) do të kryejë mbikëqyrjen dhe udhëzimin e NJZP-së.

Palët e tjera të interesit me rëndësi do të jenë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM), Ministria e Kulturës (MK) si dhe bashki të caktuara në jug të Shqipërisë. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit do të rishikojë vlerësimin mjedisor të veprimtarive infrastrukturore që kërkojnë leje mjedisore. Ministria e Kulturës do të jetë përgjegjëse për mbështetjen e FSHZH-së gjatë shqyrtimit të koncepteve të veprimtarisë dhe miratimit të projekteve që përfshijnë restaurimin ose përmirësimin e siteve të trashëgimisë kulturore.

Bashkitë e përzgjedhura mbështetën MZHU-në për identifikimin e zonave dhe veprimtarive specifike për mbështetjen e projektit, ndër të tjera. Ato do të vazhdojnë të jenë përgjegjëse për mbajtjen e takimeve periodike për angazhimin e qytetarëve së bashku me ofrimin e informacionit për fushatat e qytetarëve, që do t'u shpjegojnë të gjitha palëve të interesit qëllimet e projektit, përfitimet dhe ecurinë e zbatimit dhe shpërndarjen dhe adresimin e komenteve nga komuniteti si dhe mekanizmin e shqyrtimit të ankesave. Bashkitë e përzgjedhura duhet që të sigurojnë dhe pjesëmarrjen e grave në të gjitha proceset e angazhimit komunitar.

7.2 Kapaciteti Zbatues i FSHZH-së

FSHZH-së do t'i duhet të përmirësojë kapacitetin e brendshëm për zbatimin dhe monitorimin e performancës së KMMS-së dhe dispozitave të tij, dhe të ndërtojë kapacitetin specialistëve të posaçëm të mbrojtjes mjedisore dhe sociale që iu janë caktuar detyra të veçanta si: (i) Koordinimi i përgatitjes së dokumenteve të procesit të vlerësimit mjedisor (due diligence) me përfituesin; (ii) Rishikimi i dokumenteve të procesit të vlerësimit mjedisor (due diligence), (iii) Përgatitja, bashkërisht me njësitë zbatuese, e programeve vjetore të punës dhe buxheteve lidhur me PMMS-të; (iv) Monitorimi i ecurisë së projektit lidhur me pajtueshmërinë me udhëzimet e KMMS-së dhe sigurimin që zbatimi i përgjithshëm i projektit të vijojë pa probleme; (v) Kryerja e mbikëqyrjes së kantierit të ndërtimit; (vi) Mbledhja dhe menaxhimi i informacionit lidhur me projektin dhe llogaritë (për shembull, monitorimi dhe raportet mjedisore dhe sociale, shqyrtimit mjedisor dhe social); dhe (vii) Organizimi dhe ofrimi i seancave trajnuese.

Njësia Zbatuese e FSHZH-së përfshin një Specialist Mjedisor, një Specialist të Angazhimit të Qytetarëve dhe një Specialist social, me të paktën 5 vite përvojë në çështjet përkatëse. Krahas kësaj, FSHZH-ja mund të punësojë ose të vërë në dispozicion stafin mbështetës dhe konsulentët që do të punojnë sipas nevojës, bazuar në nevoja të caktuara të veprimtarive të projektit.

7.3 Përshtatjet Institucionale të Marrjes së Tokës dhe Procesi i Zhvendosjes

Ministria e Zhvillimit Urban ka përgjegjësinë më të lartë për zbatimin e të gjithë komponentëve të projektit, bashkërisht me FSHZH-në. Do të krijohet një komitet i përbërë nga PPP/Autoritetet e Projektit për të qenë përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Procedurës së Zhvendosjes. FSHZH-ja do të bashkëpunojë me të gjitha institucionet vendore për të siguruar një zbatim të suksesshëm të Procedurës së Zhvendosjes (PVZH/PVZSH). **NJQV-të (Bashkitë, Njësitë Administrative)** janë përfituesit fundorë të zbatimit të projektit. Nga institucionet kërkohet mbështetje e vazhdueshme dhe prania përgjatë gjithë ecurisë së projektit. **Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme** për çdo Rreth në zonën e Projektit, nën autoritetin e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, janë përgjegjëse për identifikimin dhe verifikimin e kufijve të pronave dhe pronësisë. **Zyrat e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (ish-Zyrat Kadastrale)** në Qark, do të qartësojnë certifikatat e ndarjes së tokës për tokat bujqësore, që nuk janë regjistruar dhe transferuar zyrtarisht në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. **Bashkitë** dhe Qarqet do të jenë përgjegjëse për koordinimin e procedurave të zbatimit dhe ekzekutimit të kompensimit.

Specifikimet në qoftë se do të ndërmerret një PVZH për projektin janë subjekt i përditësimeve të mëtejshme, nga FSHZH-ja, në përputhje me zhvillimet e veprimtarive të projektit dhe miratimet e Bankës Botërore.

7.4 Plani i Ngritjes së Kapaciteteve dhe Trajnimit

Zbatimi i PZHIUT-së kërkon njohuri të veçanta për përfituesit dhe operatorët e angazhuar në faza të ndryshme të zbatimit të projektit. Stafi i punës do të ndjekë një sërë trajnimesh. Stafi i përcaktuar do të pajiset me trajnimin, aftësitë dhe njohuritë e nevojshme që do t'iu mundësojnë të kryejnë me efikasitet rolin e personave mbrojtës. Ngritja e kapacitetit do të përfshijë workshop-e trajnuese si zbatimi i KMMS-së, raportimi KMMS/PMMS, Udhëzimet e Bankës Botërore etj.

Stafi mjedisor dhe social i FSHZH-së, si dhe konsulentët të cilët përgatitën dhe mbikëqyrin nënprojektet, do të vazhdojnë të marrin trajnim të posaçëm mjedisor dhe social nga specialistët mjedisorë dhe socialë të Bankës Botërore. Trajnimi i parë i këtij lloji u zhvillua gjatë përgatitjes së Financimit Shtesë, dhe trajnime të ngjashme do të kryhen rregullisht më tej. Trajnimet do të kryhen nga një konsulent i jashtëm me njohuri mbi kërkesat e menaxhimit të mjedisit për Shqipërinë, duke përfshirë njohuri thelbësore për politikën mbrojtëse dhe kërkesat e Bankës. Një plan i mundshëm për ngritjen e kapaciteteve dhe trajnimin për PZHIUT-në është paraqitur më poshtë.

Tabela 9. Plani i Propozuar i Ngritjes së Kapaciteteve që do të zbatohet përpara muajit dhjetor 2020

Përshkrimi i trajnimit	Moduli i trajnimit	Përgjegjësia	Pjesëmarrja	Shpeshtësia	Kostot si Shumë e vetme (EURO)
Trajnimi për Politikën e Mbrojtjes	<ul style="list-style-type: none"> - Mobilizimi/pjesëmarrja e komunitetit dhe përfshirja sociale - Mekanizmi i Shqyrtimit të 	Konsulenti i jashtëm	Stafi i FSHZH-së, Stafi i NJQV-ve, Stafi i IMK-së,	2 ditë	800

	<p>Ankesave/Llogaridhënie Sociale</p> <ul style="list-style-type: none"> - Trashëgimia Kulturore - Masat mbrojtëse sociale (Masat mbrojtëse Mjedisore të marrjes së tokës/pasurive) 		inxhinierët e çdo niveli në këto institucione, MZHU etj.		
Trajnimi mbi Zbatimin e KMMS-së	<ul style="list-style-type: none"> - Konceptet themelore të KMMS-së - Konceptet Themelore për Kuadrin e Zhvendosjes dhe Pjesëmarrjes - Dispozitat për Kuadrin e Zhvendosjes dhe Pjesëmarrjes - Profili i PPP-ve dhe identifikimi i PPP-ve të përshtatshëm - Rolet dhe përgjegjësitë - Mekanizmat e monitorimit - Identifikimi i Problemeve Mjedisore dhe Sociale - Mekanizmat e Shqyrtimit - Metodologjia për kompensimin ose transferimin e tokës dhe disbursimi përkatës - Organizimi Institucional - Kërkesat e Raportimit 	Konsulenti i jashtëm	Stafi i FSHZH-së, Stafi i NJQV-ve, Stafi i IMK-së, inxhinierët e çdo niveli në këto institucione, MZHU	3 ditë	1,200
Udhëzimi dhe Mjetet	<ul style="list-style-type: none"> - Dokumentet e udhëzimit, Listat e kontrollit, Formularët - TeR, Udhëzimet për Planifikimin Teknik 	Konsulenti i jashtëm	FSHZH, NJZP, NJKP, MIE, MTM	1	400
Komunikimi	<ul style="list-style-type: none"> - Radio, Diskutime në televizion, reklama në gazeta mbi problematikat lidhur me KMMS/KPZH 	Konsulenti i jashtëm		1 ditë	400
Trajnim përsëritës	<ul style="list-style-type: none"> - Konceptet themelore të KMMS-së - Konceptet Themelore për Kuadrin e Zhvendosjes dhe Pjesëmarrjes - Dispozitat për Kuadrin e Zhvendosjes dhe Pjesëmarrjes - Profili i PPP-ve dhe identifikimi i PPP-ve të përshtatshëm - Rolet dhe përgjegjësitë - Mekanizmat e monitorimit - Identifikimi i Problemeve Mjedisore dhe Sociale - Mekanizmat e Shqyrtimit - Metodologjia për kompensimin ose transferimin e tokës dhe disbursimi përkatës - Organizimi Institucional Kërkesat e Raportimit 	Specialisti Mjedisor Specialist social	Stafi i FSHZH-së, Stafi i NJQV-ve, Stafi i IMK-së, inxhinierët e çdo niveli në këto institucione, MZHU	Vjetor	800
	Gjithsej				3,600

8.0 Procesi i Konsultimit mbi KMMS dhe PZHIUT³⁴

8.1 Procesi i Konsultimit mbi KMMS

Politikat e Bankës Botërore kërkojnë që raportet mjedisore për projektet të jenë të disponueshme për grupet e prekura nga projekti, OJQ-të vendase dhe publikun e gjerë. Rezultatet e procesit të vlerësimit mjedisor dhe social të Projektit do të jenë në dispozicion të publikut; kështu të gjitha palët e interesit do të konsultohen për dokumentet e masave mbrojtëse të projektit të paktën një herë (për projektet e kategorisë B) gjatë procesit. Kjo është në përputhje me Politikën e Bankës Botërore mbi Aksesin në Informacion dhe Vlerësimin Mjedisor OP 4.01. Konsultimi publik kërkohet që të kryhet për dokumentet lidhur me kujdesin e duhur ndaj projektit në përgjithësi. Për sa i përket Projektit PZHIUT, KMMS, si dhe PMMS-të ose VNMS-të specifike për kantierin që do të përgatiten për çdo veprimtari (nënprojekt) gjatë zbatimit të projektit do të bëhen publike.

Minutat e takimit për konsultimin publik do të publikohen në faqen e internetit të FSHZH-së, por do të përdoren dhe media të tjera elektronike ose të shtypura për të siguruar pjesëmarrjen e gjerë të palëve të interesit, duke përfshirë gazetave vendase, adresën zyrtare të e-mail të FSHZH-së, etj. Objektivat e konsultimeve publike ishin:

- Informimi i publikut dhe palëve të interesit në lidhje me objektivat dhe zhvillimet e projektit dhe efektet e pritshme sociale dhe mjedisore.
- Mbledhja e informacionit dhe të dhënave nga publiku dhe / ose nga komunitetet që do të preken nga projekti
- Sigurimi i pjesëmarrjes së publikut dhe komuniteteve vendase në procesin dhe mbështetjen për projektin

U mbajtën takime me zyrtarët kryesorë dhe ndikuesit e opinionit për të vlerësuar nivelin e dijenisë dhe përfshirjes në projekt, shqetësimet lidhur me zbatimin e projektit, dhe për marrjen e dokumenteve të posaçme ose informacionit bazë. Minutat e Takimit të konsultimit gjenden në **Aneksin 8**. Shkurtimisht, pikat kryesore të diskutimit të takimit u fokusuan në prezantimin e draft dokumentit dhe informacionit në Anekset e KMMS-së.

8.2 Konsultimi me Popullatat e Prekura

Konsultimi është procesi gjatë së cilit mblidhet informacion për të marrë vendime që ndikojnë komunitetin. Pjesëtarët e komunitetit informohen, lidhen dhe përfshihen në shërbimet dhe veprimtaritë që lidhen me ta, dhe ndihen se kanë një rol për të luajtur. Në mënyrë që të ndodhë konsultim efikas, komunitetet duhet të informohen dhe të angazhohen. Kjo ndodh kur aksesin në informacion është i barabartë, kur ka shkëmbim informacioni të vazhdueshëm, konsultim dhe pjesëmarrje të mirë ndërmjet palëve të interesit.

Për të siguruar angazhimin efikas të qytetarëve dhe për të siguruar që interesat e personave të prekur janë plotësisht të përfshira në proces, do të kryhen një grup veprimtarish të përqendruara në angazhimin e qytetarëve. Niveli i konsultimit që do të kryhet në projekt diskutohet në vijim. Veprimtaritë e tjera përfshijnë vlerësimin e nevojave të pjesëmarrjes, workshop-e konsultimi të palëve të interesit, monitorimin pjesëmarrës dhe mekanizmin e shqyrtimit të ankesave.

³⁴ (Ky seksion do të rishikohet në mënyrë përfundimtare pas procesit të konsultimit gjatë takimit. Aneksi Nr. 10 është planifikuar të mbulojë Minutat e Takimit, që do të plotësohen pas takimit të konsultimit).

Informim: Projekti do të informojë komunitetin me informacion të balancuar dhe objektiv për t'i ndihmuar që të kuptojnë projektin PZHIUT, alternativat dhe mundësitë.

Konsultim: Njësia Zbatuese e Projektit do të marrë komente nga komuniteti lidhur me analizat, alternativat dhe vendimet. Zakonisht, këtu përfshihet zhvillimi i një qëndrimi paraprak ose të preferuar përpara bërjes publike për të marrë përshtypjet e komunitetit.

Përfshirje: Kjo mund të përfshijë komunitetin në faza të ndryshme të projektit për gjetjen e përgjigjeve të posaçme për problematikën, në vend të seancave të gjera të përgjithshme për marrjen e komenteve. Metodën mund të përfshijnë fokus grupet, workshop-et, komitetet këshillimore dhe konsultimet online.

Bashkëpunim: Bashkëpunimi komunitar mund të nxitet nëpërmjet komiteve drejtuese, tavolinave të negociimit, konsultimeve online, tryezave të rrumbullakëta të politikave, paneleve të qytetarëve, konferencave kërkimore dhe partneriteteve formale dhe joformale.

Komunikimi me personat e prekur, si dhe me pjesëtarët e tjerë të komunitetit që do të shprehin interes për projektin, do të mbahet gjatë gjithë procesit, nga hartimi i projektit, zbatimi deri në përfundim. Komuniteti do të informohet për marrëveshjet e menaxhimit të ankesave dhe të dhënat e kontakteve të personave të caktuar për të menaxhuar çështjet dhe ankesat. Gjithashtu do të jepet informacion i përditësuar që nevojitet për të siguruar informimin dhe angazhimin e publikut në veprimtaritë e projektit nëpërmjet faqes së internetit të FSHZH-së dhe medias sociale.

8.3 Mekanizmat e Shqyrtimit të Ankesave

Mekanizmi i Shqyrtimit të Ankesave (MSHA) mundëson një mekanizëm për adresimin e shqetësimeve dhe ankesave, ndërmjetësimin e konflikteve dhe shkurtimin e kohës së çështjeve ndërgjyqëse që shkaktojnë vonesë të projekteve infrastrukturore. Ky mekanizëm shërben si një mënyrë për plotësimin e kërkesave, parandalimin dhe adresimin e shqetësimeve të komunitetit, reduktimin e rreziqeve dhe asistimin e proceseve më të mëdha që krijojnë ndryshime sociale pozitive. Objektivi kryesor i MSHA-së është zbatimi dhe mbajtja e një procedure për trajtimin e shqetësimeve mjedisore dhe sociale të palëve të interesit të projektit. Kjo procedurë do të përfshijë një mekanizëm shqyrtimi të përshtatur me rreziqet e identifikuar të projektit dhe ndikimet e padëshiruara, duke u përqendruar te palët e interesit.

MSHA-ja është ngritur sipas projektit mëmë që përbëhet nga Komiteti i Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) në NJZP-në e FSHZH-së me përfaqësues të bashkive të përzgjedhura dhe një përfaqësues të PPP-ve. KSHA-ja drejtohet nga Drejtori i Projektit në NJZP-në e FSHZH-së. Funkcioni i Mekanizmit të Shqyrtimit të Ankesave (MSHA) duhet të mbahet dhe monitorohet nga NJZP-ja e FSHZH-së gjatë zbatimit të projektit. Hapat e përgjithshëm të procesit të ankimit përbëhen nga hapat e mëposhtëm që do të përfshijnë një proces të dhënies së komenteve në mënyrë që ankuesit të marrin përgjigje brenda afateve kohore të dakordësuara:

- Regjistrimi/marrja e Ankesave.
- Përcaktimi dhe zbatimi i veprimit të shqyrtimit.
- Verifikimi i veprimit të shqyrtimit.
- Monitorimi dhe Vlerësimi; dhe
- Pakënaqësia dhe veprimi alternativ

Regjistrimi/marrja e Ankesës. NJZP-ja do të ngrejë një qendër të MSHA-së në komunitet/qtytezë si pjesë e konsultimit që do të kryhet për projektin. Qendra e MSHA-së do të jetë e aksesueshme për personat e prekur nga projekti dhe turistët dhe palët e tjera të interesit. MSHA-ja do të përcaktojë role, afate kohore, procedura dhe përgjegjësi të qarta. Ai do të ketë një mekanizëm monitorimi të integruar për të kontrolluar reagueshmërinë ndaj ankesave ose ankimeve të bëra. Format e ndryshme të marrjes së ankesave do të përshkruhen qartë bashkërisht me fazat e ndryshme që përbëjnë procesin. MSHA-ja do të punojë me Komitetin Vendor të Ankesave (KVA) për gjetjen e zgjidhjeve.

Përcaktimi dhe zbatimi i veprimit të shqyrtimit. Kur regjistrohet një ankesë/mosmarrëveshje, do të kërkohet veprimi i Komitetit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA), dhe do të organizohen takimet e ndërmjetësimit me palët e interesuara. Do të mbahen minutat e takimeve. KSHA-ja, fillimisht do të shqyrtojë bazën e ankesës dhe më pas do të përcaktojë veprimin e shqyrtimit gjatë konsultimit me ankuesin dhe palën përkatëse nëse nevojitet. Në të kundërt, ekipi i shqyrtimit të ankesave do t'i komunikojë ankuesit pranimin e ankesës, veprimin e propozuar të shqyrtimit dhe afatin kohor për zbatimin e veprimit.

Verifikimi i veprimit të shqyrtimit. Ekipi i shqyrtimit të ankesave do të vizitojë pronën e prekur ose do të lidhet me ankuesin për të konfirmuar zbatimin e veprimit të shqyrtimit. Nëse ankuesi është i pakënaqur me rezultatin e propozimit ose veprimit të shqyrtimit, mund të merren hapa të mëtejshëm për të zgjidhur problemin ose për të arritur një marrëveshje me mirëkuptim. Verifikimi duhet të përfundojë brenda një jave nga ekzekutimi i veprimit të shqyrtimit.

KSHA-ja do të mbajë një regjistër të ankesave të marra dhe të rezulttit të përpjekjeve për të zgjidhur ankesat dhe do ta përfshijë këtë informacion në raportin e monitorimit dhe vlerësimit. Ligji i Shpronësimit parashikon një proces apelues kundër vendimit të propozuar për kompensim. Krahas kësaj, ligjet e Planifikimit Urban dhe të Politikës së Ndërtimit lejojnë apelimet administrative kundër një vendimi për prishjen e ndërtimeve të paligjshme. Ankesat e mëtejshme mund të bëhen në gjykatat e rrethit. Zyra e Avokatit të Popullit në Tiranë merr ankesat nga qytetarët kundër veprimeve të qeverisë që prekin të drejtat e tyre. Stafi i projektit do të luajë gjithashtu një rol në zgjidhjen e ankesave. Shqipëria ka kaluar një periudhë tranzicioni në qeverinë e saj vendore, për shkak të ndryshimeve që vijnë nga Reforma Administrative-Territoriale, e cila solli ndryshime radikale në funksionimin e NJQV-ve. Duke pasur parasysh ndryshimet e pushtetit vendor dhe hapat e shpjeguar më sipër, komiteti i ankesave do të krijohet brenda bashkisë përkatëse ose çdo institucioni tjetër të zgjedhur vendor.

Sipas projektit mëmë, personat që kanë ankesa ose pyetje mbi nënprojektet nuk kishin përdorur qendrën e MSHA-së, dhe MSHA-ja zyrtare e krijuar për projektin nuk ishte vendosur në punë. Popullsia vendase zakonisht ankohet drejtpërdrejt të kontraktorit për problematikat që lidhen me ndërtimin. Stafi i FSHZH-së përgjegjës për nënprojektin, duke përfshirë dhe stafin mjedisor dhe social, zakonisht informohet për ankesat drejtpërdrejt nga ankuesi ose kontraktori, dhe mund të kryejë ndërmjetësimin midis kontraktorit dhe ankuesve nëse dhe si është e nevojshme. Për prishjen e tre kafeneve në Syrin e Kaltër, pronarët e kafeneve të prekura iu drejtuan sistemit gjyqësor në vend të MSHA-së së projektit. Regjistri i ankesës nuk ishte përgatitur për të ndjekur ankesat e paraqitura në projektin mëmë. FSHZH-ja do të përmirësojë MSHA-në për FSH-në duke krijuar një regjistër ankesash, dhe

duke caktuar një oficer ankesash që do të regjistrojë ankesat e paraqitura dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre, nën udhëzimin e Specialistëve mjedisorë dhe socialë të Bankës Botërore.




Figura 4: Grafiku i Procesit të MSHA-së

9.0 Monitorimi dhe Vlerësimi Mjedisor dhe Social

Planet e monitorimit do të zhvillohen për të ndjekur ecurinë e masave mbrojtëse në nivelin e KMMS-së dhe veprimtarisë së nënprojektit. Planet e propozuara janë paraqitur në tabelën e mëposhtme. Tabela konfirmon treguesit e verifikueshëm si dhe përgjegjësitë për veprimet e ndryshme të monitorimit. Problematikat e monitorimit në nivelin e KMMS-së përfshijnë konfirmimin e shpërndarjes së dokumentit të KMMS-së si dhe veprimtaritë e ngritjes së kapaciteteve dhe trajnimit.

Përgjegjësitë për monitorimin dhe vlerësimin janë të ndara ndërmjet FSHZH-së dhe Ministrisë së Zhvillimit Urban. FSHZH është përgjegjëse për mbajtjen e të dhënave, menaxhimin dhe monitorimin e brendshëm të MSHA-së pasi komiteti do t'i raportojë drejtpërdrejt drejtorit të FSHZH-së, ose një specialisti të caktuar. Ministria e Zhvillimit Urban është përgjegjëse për monitorimin e jashtëm dhe vlerësimin e zbatimit të projektit nëpërmjet krijimit të Njesisë së Pavarur të Monitorimit.

9.1 Monitorimi i brendshëm

- **Monitorimi Mjedisor**

Monitorimi i mjedisit fizik duhet të kryhet në faza të ndryshme të projektit për të siguruar pajtueshmëri me standardet e mjedisit fizik dhe për të shmangur dëmtime të mundshme të mjedisit fizik si rezultat i veprimtarive të projektit. Monitorimi do të identifikojë papajtueshmëritë me standardet e mjedisit dhe do të nxisë institucionet/autoritetet përgjegjëse të ndërmarrin hapat e nevojshëm për të kontrolluar/shmangur dëmtimin e mjedisit. Rezultatet e analizës duhet të krahasohen me udhëzimet dhe standardet kombëtare dhe të Bankës Botërore.

Përgjegjësia për monitorimin mjedisor në terren të veprimtarive të kontraktorit është e përfituesit (NJQV-ve) dhe FSHZH-së. NJQV-të dhe FSHZH-ja, të caktuara si përgjegjëse, do të kryejnë monitorim të rregullt mujor në terren të punimeve civile për të verifikuar zbatimin nga ana e Kontraktorit të kërkesave të përcaktuara në PMMS-të, për të identifikuar ndonjë problematikë ose rrezik mjedisor të hasur, dhe për të siguruar zbatimin e duhur të veprimeve korrigjuese të përcaktuara. Në rast të konstatimit të ndonjë papajtueshmërie me PMMS-të, FSHZH-ja do të udhëzojë kontraktorët mbi masat korrigjuese dhe do të monitorojë nga afër ecurinë e tyre të mëtejshme.

Gjithashtu, edhe bashkitë do të kryejnë monitorim për të siguruar që kushtëzimi mjedisor gjatë zbatimit do të përmbushet, bazuar në kërkesat legjislative që rrjedhin nga leja mjedisore. Ato do të duhet t'i raportojnë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit/Agjencisë Kombëtare të Mjedisit siç përcaktohet në leje, gjithashtu dhe FSHZH-së.

Ekipe të Bankës Botërore do të mbikëqyrin zbatimin e masave mbrojtëse mjedisore dhe sociale për projektin në përgjithësi dhe për secilin nënprojekt. Ato do të kryejnë misione periodike të monitorimit si dhe vizita të posaçme në terren sipas nevojës. Ekipe të Bankës Botërore do të miratojnë Planin e Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS) dhe do të ndjekin zbatimin e tij sipas KMMS-së.

Roli i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit si autoriteti kombëtar partner në këtë projekt lidhur me problematikat mjedisore do të jetë monitorimi i zbatimit të lejes mjedisore për secilin nënprojekt kurdo të jetë e nevojshme. Në rastet kur projekti ndodhet në një zonë të mbrojtur, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit do të monitorojë zbatimin e punimeve për mirëmbajtjen pas përfundimit.

- **Monitorimi Social**

FSHZH do të jetë e ngarkuar me detyrën e monitorimit dhe vlerësimit të PPP-ve, dhe procedurave që lidhen me nevojat dhe ankesat e tyre. Siç u përmend më lart, FSHZH-ja do të jetë përgjegjësjë përfundimtare për dy procedura:

- Monitorimin e Komitetit të Ankesave
- Monitorimin e përgjithshëm të brendshëm të PVZH dhe PVZSH.

Procedurat e monitorimit të brendshëm lidhen me:

- Takimet e konsultimit publik.
- Censurin, inventarët e pasurive, vlerësimet dhe studimet socio-ekonomikë të përfunduara.
- Ankesat e paraqitura dhe statusi i tyre.
- Pagesat e disbursuara të kompensimit; dhe
- Raportet e paraqitur të monitorimit.

Veprimet e Monitorimit të Brendshëm nuk janë të kufizuara dhe ato mund të përfshijnë pjesëmarrjen në procese etj. Raportet e monitorimit të brendshëm do të përgatiten dhe do të paraqiten pranë përfaqësuesit të FSHZH-së dhe do të ndahen me specialistë dhe partnerë të tjerë.

9.2 Monitorimi dhe Vlerësimi i Jashtëm

Do të caktohet një Konsulent i Pavarur Monitorimi (KPM) për të monitoruar procesin e shpronësimit dhe kompensimit, si dhe zbatimin e kërkesave për të verifikuar nëse kompensimi, zhvendosja dhe rehabilitimi do të zbatohen në përputhje me PVZH-në e dakordësuar. Gjithashtu, KPM do të përfshihet në procedurat e ankimimit për t'u siguruar që shqetësimet e ngritura nga PPP-të do të adresohen. Konkretisht, KPM do të kryejë veprimet si më poshtë:

- Rishikimin e rezultateve të monitorimit të brendshëm të PVZH-së dhe shqyrtimin e pajtueshmërisë së përgjithshme.
- Kontrollin e rastësishëm në terren për të verifikuar pagesën e kompensimit dhe kohën e pagesës.
- Intervista me kampione rastësore nga njerëzit e prekur nga projekti në zona të ndryshme për të vlerësuar dijeninë e tyre dhe shqetësimet lidhur me procesin e shpronësimit dhe të drejtat e tyre pronësore.
- Kontrollin e llojeve të ankesave të bëra dhe funksionimin efektiv të mekanizmit të shqyrtimit të ankesave duke pyetur personat e prekur dhe duke rishikuar ankesat dhe ecurinë e procesit.
- Vlerësimin e efikasitetit të përgjithshëm të shpronësimit dhe nxjerrjes së mësimave për t'u përdorur si orientim në të ardhmen.
- Përcaktimin e përshtatshmërisë së përgjithshme të të drejtave për të arritur objektivat.

Monitorimi i ecurisë dhe i performancës së PVZH/PVZHSH do të mbulojë të gjitha fazat duke filluar nga përgatitja, zbatimi, deri në përfundim. Duke përdorur informacionin e hartuar me anë të monitorimit të PVZH-së, MZHU në bashkëpunim me FSHZH-në do të jetë në gjendje të vërë në dukje ndryshimet që mund të ketë ndodhur para dhe pas shpronësimit.

Tabela 10: Monitorimi Mjedisor dhe Social

Ndikimi negativ i identifikuar	Masa zbutëse e propozuar	Treguesi i performancës	Përgjegjësia për monitorimin	Mjetet e monitorimit	Shpeshësia e rekomanduar e monitorimit
Cilësia e ajrit, zhurma dhe dridhjet	<ul style="list-style-type: none"> Oraret e punës dhe programi i ndërtimit do të koordinohen në mënyrë racionale për të gjitha shoqëritë e ndryshme të ndërtimit dhe inxhinierisë që do të jenë në kantonier. Zyrat dhe komunitetet fqinje do të informohen paraprakisht për të gjitha shembjet/veprimtaritë ndërtimore. Firmat e ndërtimit dhe inxhinierike do të përzgjidhen për projektin në bazë të aftësisë së tyre për ndjekur praktika të pranueshme inxhinierike dhe disponueshmërisë së pajisjeve të përshtatshme për të siguruar nivele të ulëta zhurme dhe emetimesh që ndikojnë cilësinë e ajrit. Ngarkimi dhe transporti i mbeturinave të shembjes do të kryhet gjatë orëve të ditës dhe do të shmanget përdorimi i pajisjeve relativisht të zhurmshme gjatë natës; Grumbujt e mbeturinave do të mbulojnë për të parandaluar shpërhapjen e pluhurit në ajër; Përzjerja e çimentos në kantonier, gurëve ranorë dhe materialeve të tjera ndërtimore do të kryhet në hapësira të kufizuara dhe këto materiale do të ruhen në një zonë të mbyllur ose do të mbulojnë fort; Do të përcaktohet limiti i shpejtësisë për mjetet e ndërtimit dhe transportit si brenda dhe jashtë kantonierit të projektit për të shmangur shpërhapjen e pluhurit; dhe Do të vendoset një depozitë uji në kantonier për të lagur ose spërkatur vazhdimisht me ujë hapësirat me qëllim reduktimin e pluhurit nga punimet tokësore. Do të vendosen shenja të përshtatshme rrugore në rrugët e pashtruara për të kufizuar shpejtësinë e mjeteve Do të vendosen ngadalësues shpejtësie të projektuar dhe ndërtuar siç duhet në rrugët e kalimit 	<p>Përgatitje e programit të veprimtarive ndërtimore në kantonier</p> <p>Informimi i zyrave dhe komuniteteve fqinje</p> <p>Përzgjedhja e firmave në bazë të kriterëve të përcaktuara qartë</p> <p>Ngarkimi dhe transportimi i mbeturinave gjatë ditës</p> <p>Mbulimi i grumbullit të mbeturinave</p> <p>Hapësira të kufizuara për përzjerjen e çimentos</p> <p>Informimi i shoferëve të projektit për limitet e aplikueshëm të shpejtësisë</p> <p>Spërkatje e shpeshë me ujë për reduktimin e pluhurit Shenja rrugore në rrugët e pashtruara Ngadalësues shpejtësie</p>	NJZP, NJQV, Inxhinieri Mbikëqyrës	Raportimi	Fillimi i ndërtimit çdo muaj gjatë ndërtimit
Burimet Ujore dhe Ndotja	<ul style="list-style-type: none"> Punimet nuk duhet të ekzekutohen në kushte atmosferike agresive si reshjet ose stuhitë. Në asnjë seksion të trupave ujorë nuk duhet të hidhen mbetje të ngurta, karburante ose naftë. Ndërtimi duhet të kryhet në faza për të minimizuar ndikimet dhe ekspozimin e dherave. Materialet e gërmuara dhe lymi, që nuk mund të përdoren, do të hidhen në zonat e përshtatshme sipas Planit të Menaxhimit të Mbetjeve të përgatitur nga Kontraktori dhe të miratuar nga autoriteti përkatës. Në zona të pjerrëta do të ngrihen barrierat të përkohshme sedimenti për të parandaluar depërtimin e lymit në rrjedhat ujore. Mirëmbajtja, mbushja me karburant dhe pastrimi i mjeteve dhe pajisjeve do të kryhet në punishte jashtë kantonierit duke zbatuar masa të përshtatshme për parandalimin e rrjedhjeve. Do të ngrihen objekte të mbljedhjes dhe menaxhimit të mbetjeve për komunitetin, turistët dhe Qendrat e Zgjidhjeve për NVM-të me qëllim minimizimin e mbetjeve dhe ndotjes së ujërave 	<p>Moskryerje e punimeve gjatë motit të papërshtatshëm</p> <p>Nuk duhet të hidhen mbetje në trupat ujorë</p> <p>Kryerje e punimeve të ndërtimit në faza Hedhje e materialeve të papërdorshme në zonat e posaçme sipas</p> <p>Planit të Menaxhimit të Mbetjeve</p> <p>Ndërtimi i barrierave të përkohshme në zona të përshtatshme</p> <p>Punishte jashtë kantonierit për mirëmbajtjen e mjeteve</p> <p>Sigurimi i objekteve për mbljedhjen dhe trajtimin e mbetjeve</p>	NJZP, NJQV, Inxhinieri Mbikëqyrës	Inspektim në terren	Ditor Ditor Mujor Ditor Javor Tremujor
Ndërhyrjet Pamore	<ul style="list-style-type: none"> Do të informohet publiku mbi projektin nëpërmjet shenjave dhe tabelave të posaçme përpara aksesimit të kantonierëve nga ana e Kontraktorit; Veprimtaritë ndërtimore do të kryhen në seksione me qëllim reduktimin e ndikimeve të ndryshimit dhe ndërhyrjeve pamore për publikun e përgjithshëm. Kantonieret e ndërtimit do të jenë të veçuara nga publiku. Në kantonieret e ndërtimit do të ndiqen masat e mirëmbajtjes së duhur, si pastrimi. Do të sigurohet një kantonier i pranueshëm pas ndërtimit sipas dispozitave të kontratës. Objektet do të projektohen dhe ndërtohen për t'u përshtatur me mjedisin ekzistues. 	<p>Sinjalistika dhe tabela</p> <p>Ndarja e përshtatshme e ndërtimit</p> <p>Vende të mbyllura Kantonieret e ndërtimit të rregullta</p> <p>Zonë e pranueshme pas ndërtimit</p> <p>Përshtatja e objekteve me mjedisin ekzistues</p>	NJZP, NJQV, Inxhinieri Mbikëqyrës	Inspektim në terren	Parandërtimor Javor
Problematikat e marrjes së tokës, zhvendosjes dhe kompensimit.	<ul style="list-style-type: none"> Duhet të shmangët shpërngulja ose zhvendosja sa më shumë të jetë e mundur nëpërmjet hulumtimit të vendndodhjeve alternative, rigjurmëzimit dhe opsioneve të tjera të realizueshme të projektit. Kur shpërngulja ose zhvendosja është e pashmangshme, duhet të kryhet konsultimi me pronarët/përdoruesit/komunitetet e pronës në fjalë dhe të merret miratimi i tyre në fazën e hershme të procesit të zhvillimit të projektit. Duhet të krijohet një plan veprimi për zhvendosjen për të orientuar kompensimin e ndikimeve Duhet të lejohen personat e prekur që të rikuperojnë pronat e tyre (duke përfshirë të mbjellat) përpara mobilizimit të kantonierit për fillimin e punës Duhet të sigurohet pagesë kompensimi e drejtë dhe e duhur për të gjithë personat e prekur përpara nisjes së veprimtarive të ndërtimit në përputhje me dispozitat e KPZH-së. Duhet të merren lejet zhvillimit të kërkuara nga autoritetet përkatëse përpara fillimit të punës Do të ngrihet dhe zbatohet një mekanizëm zyrtar për shqyrtimin e ankesave 	<p>Shpërngulje/zhvendosje minimale</p> <p>Konsultime të hershme sipas planit të angazhimit të projektit</p> <p>Kompensim në përputhje me PVZH</p> <p>Rikuperim i pronave të personave të prekur</p> <p>Kompensimi i drejtë dhe i duhur i personave të prekur</p> <p>Marrja e lejeve</p> <p>Ngritja e mekanizmit të shqyrtimit të ankesave</p>	NJZP, KPM, BB	Raportet	Faza e Projektimit Parandërtimor
Problematikat e	<ul style="list-style-type: none"> Duhet të sigurohet pagesa e kompensimeve të 	Pagesa e kompensimeve	NJZP, KPM, BB	Raportet/intervista	Dy herë në vit

jetesës	<ul style="list-style-type: none"> përshtatshme ndaj PPP-ve sipas KPZH-së; Komuniteteve vendase do t'iu jepen mundësi punësimi dhe të tjera sa më shumë të jetë e mundur. Duhet të kryhen trajnime të shpeshta gjatë punës mbi kurset e mikpritjes për punonjësit e turizmit me qëllim rritjen e vizitave turistike dhe biznesit Stafi do të trajnohet për t'iu bërë trajnues mbrojtës për përfituesit 	<p>Punësimi i pjesëtarëve të komunitetit vendas</p> <p>Punonjës të trajnuar</p> <p>Staf i trajnuar</p>			
Shëndeti dhe siguria e komunitetit	<p>Faza e ndërtimit</p> <ul style="list-style-type: none"> Punimet në kanalet e ekspozuara dhe materialet nga toka, në masën maksimale të mundshme, do të përfundojnë përpara gërmimeve të reja dhe hapjes së kanaleve të rinj. Zonat e punimeve do të kufizohen në mënyrën e duhur me qëllim shmangien e shkelësve kureshtarë, veçanërisht fëmijëve. Përreth zonave të punimeve do të vendosen shenja paralajmëruese për të shkurajuar shkelësit. Kontraktorët do të garantojnë sigurinë e duhur në kantieret e ndërtimit për të shmangur vjedhjen ose shkatërrimin e pronës. Do të sigurohet shikueshmëri gjatë natës nëpërmjet ndriçimit të përshtatshëm. Punëtorët e ndërtimit do të edukohen lidhur me çështjet e shëndetit personal dhe komunitar. Do të sigurohet mbrojtje, si për shembull me anë të rezervativëve, kundër sëmundjeve seksualisht të transmetueshme dhe veçanërisht për dhunën seksuale ndaj grave dhe të miturve në komunitet Kontraktori do të mundësojë procedura për identifikimin dhe raportimin e dhunës me bazë gjinore të ushtruar nga punëtorët dhe mekanizma për trajtimin e autorëve dhe të mbijetuarve si pjesë e planit të veprimit për DHBGJ-në. Pas përfundimit të punimeve, të gjitha instalimet e përkohshme do të hiqen, të gjithë impiantet dhe pajisjet do të largohen, mbetjet dhe materialet e tepërta dhe mbeturinat do të hiqen nga kontraktori, dhe kantieri do të lihet i pastër dhe i rregullt Buldozeri, ekskavatori hidraulik, pompat, gjeneratori, mjetet dhe pajisjet e makineritë e tjera të përdorura për projektin do të shpërngulen në kantieret e reja ose të tjera të projektit në vend që menaxhohen nga Kontraktori. Duhet të nxiten drejtuesit e komunitetit që të krijojnë komitete vëzhgimi për të përmirësuar sigurinë Do të krijohen procedura për shmangien/zbutjen e rasteve të dhunës seksuale ndaj grave dhe të miturve si dhe procedura për mbështetjen e të mbijetuarve 	<p>Mbyllje e kanaleve në kohën e duhur</p> <p>Kufizim i përshtatshëm i zonave të punës</p> <p>Vendosje e shenjave paralajmëruese Ofrim i sigurisë</p> <p>Ndriçim i përshtatshëm gjatë natës</p> <p>Edukimi i punëtorëve mbi çështjet shëndetësore</p> <p>Disponueshmëri e procedurave për identifikimin dhe raportimin e DHBGJ-së</p> <p>Çmontim dhe heqje e instalimeve të përkohshme pas ndërtimit</p> <p>Shpërngulje e pajisjeve pas ndërtimit</p> <p>Krijimi i komiteeve vëzhguese</p> <p>Zbatim i procedurave për shmangien e dhunës seksuale</p>	<p>NJZP, NJQV, Inxhinieri Mbikëqyrës</p>	<p>Inspektim në terren/Raportim</p>	<p>Mujor</p>
Menaxhimi i Trafikut	<ul style="list-style-type: none"> Kontraktori do të paraqesë plane të menaxhimit të trafikut që do të miratohen nga autoritetet përkatëse dhe klienti, nëse është e nevojshme Duhet të kryhen përshtatje alternative të posaçme për minimizimin e ndikimit të shoferët dhe këmbësorët në zonat turistike ekzistuese Punimet do të kryhen në kohën e duhur për të minimizuar shqetësimin e shoferëve dhe këmbësorëve Do të vendosen shenja të përshtatshme rrugore në rrugët e kalimit për të kufizuar shpejtësinë e mjeteve Do të ndërtohen ngadalësues shpejtësie të projektuar siç duhet në rrugët e kalimit 	<p>Miratim i planeve të menaxhimit të trafikut</p> <p>Përshtatje alternative të transportit</p> <p>Përfundim i punimeve në kohën e duhur</p> <p>Shenja rrugore me limit shpejtësie Ngadalësues shpejtësie</p>	<p>NJZP, NJQV, Inxhinieri Mbikëqyrës</p>	<p>Vizual/Raportim</p>	<p>Parandërtimor</p> <p>Tremujor</p>
Dhuna me Bazë Gjinore (Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual dhe Ngacmimi Seksual)	<ul style="list-style-type: none"> Stafi duhet të trajnohet rregullisht mbi Mikpritjen dhe mbrojtjen kundër dhunës, veçanërisht gratë/vajzat Për shkak të natyrës delikate të rasteve të abuzimit seksual dhe nevojës për të respektuar privatësinë dhe dëshirat e të mbijetuarve, teknikat e shqyrtimit duhet të merren në konsideratë ndryshe nga metodat e përgjithshme të MSHA-së. NJZP-ja mund të punësojë një specialist për DHBGJ-në për të kryer vlerësimin e rrezikut të DHBGJ-së me qëllim përcaktimin e nivelit të vëmendjes dhe opsioneve dhe teknikat e zbutjes që nevojiten në secilin zonë të projektit nëpërmjet hartimit të një Plani Veprimi për DHBGJ-në. Plani i Veprimit për DHBGJ-në do të përfshijë hartëzimin e ofruesve të shërbimeve, krijimin e rrugëve të qarta të referimit për reagimin ndaj DHBGJ-së, planeve të sensibilizimit dhe mbulimit për DHBGJ-në, dhe kodit të sjelljes për punonjësit e projektit etj. Kontraktori do të zbatojë Planin e Veprimit për DHBGJ-në me mbështetjen e specialistit për DHBGJ ose një ofruesi shërbimesh të identifikuar. Nëse është e nevojshme, në çdo komunitet të projektit do të vendoset staf i trajnuar në terren që do të ketë për detyrë identifikimin dhe raportimin e të gjitha rasteve të autoritetet e posaçme 	<p>Staf i trajnuar për mikpritjen Mekanizëm i ndryshëm</p> <p>shqyrtimi për rastet e DHBGJ-së</p> <p>Punësim i specialistit për DHBGJ</p> <p>Plani i zbatuar i veprimit</p> <p>Staf i trajnuar në terren në komunitetet e projektit</p>	<p>NJZP, BB, NJQV, Inxhinieri Mbikëqyrës</p>	<p>Raportet/ Intervistat</p>	<p>Tremujor</p>
Shëndeti dhe siguria në vendin e punës	<ul style="list-style-type: none"> Të gjithë punëtorët duhet të udhëzohen/orientohen në mënyrën e duhur mbi sigurinë. Kontraktorët do të kenë Politika dhe Procedura për Shëndetin dhe Sigurinë me qëllim orientimin e veprimtarive të ndërtimit. Pajisjeve dhe makinerive do t'iu kryhen shërbimet rregullisht për të siguruar që janë në gjendje të mirë pune. Duhet të siguroni që në kantier të ketë kuti të ndihmës së parë dhe një person të trajnuar për dhënien e ndihmës së parë. Duhet të mundësohen dhe të zbatohet përdorimi i pajisjeve mbrojtëse personale (PMP) të përshtatshme si çizmet mbrojtëse, xhaketat reflektuese, kaskat, dorezat e duarve, tapat e veshëve, maskat mbi hundë etj. 	<p>Trajnim i punonjësve mbi sigurinë Krijimi i politikave të shëndetit dhe sigurisë</p> <p>Pajisjet në gjendje të mirë pune</p> <p>Kuti të ndihmës së parë në kantier Sigurim dhe përdorim i PMP-ve</p> <p>Dëshmi kompetencë të operatorëve</p>	<p>NJZP, NJQV, Inxhinieri Mbikëqyrës</p>	<p>Raportet</p>	<p>Javore / Tremujore</p>

	<ul style="list-style-type: none"> Do të kërkohet dëshmi kompetence për të gjithë operatorët e pajisjeve/makinerve dhe kjo do të vërtetohet nëpërmjet shqyrtimit të licensave ose dokumenteve të vlefshme të drejtuesve ose operatorëve. Do të zbatohen të gjitha rregullat dhe rregulloret e kantierit. Do të vendosen sanksione në rastet e mosrespektimit të procedurave të sigurisë. Takimet në kantier duhet të rrisin ndërgjegjësimin mbi Shëndetin dhe Sigurinë në Punë. Punëtorët e ndërtimit do të edukohen lidhur me çështjet e shëndetit personal dhe publik. Duhet të ofrohet mbrojtje, për shembull prezervativë, kundër sëmundjeve seksualisht të transmetueshme dhe pasojave të abuzimit (veçanërisht atij seksual) ndaj pjesëtarëve të komunitetit priës 	<p>Zbatimi i rregullave</p> <p>Aplikim sanksionesh sipas rastit</p> <p>Dijeni mbi SHSP Edukimi i punëtorëve mbi çështjet shëndetësore</p>			
Trashëgimia Kulture	<ul style="list-style-type: none"> Duhet të identifikohet në mënyrën e duhur dhe të konsultohet autoriteti i zakonshëm përgjegjës për ruajtjen e faltoreve vendase dhe vendeve të trashëgimisë Duhet të dakordësohen ritet e nevojshme kulturore me komunitetin dhe të kryhen përpara aksesit në kantier dhe në periudha kohore të paracaktuara 	<p>Njohja e autoritetit të zakonshëm</p> <p>Kryerja e riteve</p>	NJZP	Raportet	Parandërtimore

Referencat

1. Albania Development Fund: Project for Rehabilitation of Regional and Local Roads [Fondi Shqiptar i Zhvillimit: Projekti për Rehabilitimin e Rrugëve Rajonale dhe Vendore], Shqipëri. KMMS. Dhjetor 2017
2. Albania Environmental Services Project: Environmental Assessment Report [Projekti i Shërbimeve Mjedisore në Shqipëri: Raport i Vlerësimit Mjedisor] 2013
3. Haki Kola & Enkeleda Pjetri Albania Country Report: FAO Forest and Climate Change in Eastern Europe and Central Asia [Raporti për Shqipërinë: OUB Pyjet dhe Ndryshimet Klimatike në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore], 2010.
4. VNMS paraprake për “Rigjallërimin e Shëtitores “Naim Frashëri”, Sarandë 2016
5. PMMS për rehabilitimin e shkallareve të Sarandës, Sarandë, korrik 2016
6. VNMS i Trans Adriatic Pipeline Shqipëri, Aneksi 5 - Baza referuese dhe Metodologjia e Vlerësimit të Ndikimit
7. Banka Botërore: Financimi Shtesë për Projektin për Integrimin Urban dhe Zhvillimin e Turizmit Raporti Nr: PAD3782. Korrik 2020

Anekset:

Aneksi 1: Lista e kontrollit të shqyrtimit për Problematikat e Mbrojtjes Mjedisore dhe Sociale

Informacioni i Projektit dhe Detajet e personit të kontaktit	Vendndodhja		
Emri i shqyrtuesit kryesues		Data e shqyrtimit	
Emri i rishikuesit kryesues		Data e rishikimit	

Detajet e nënprojektit: Vendosni hartën e vendndodhjes (koordinatat e gjatësisë - gjerësisë (në GPS) nëse disponohen):	
Lloji i veprimtarisë: Çfarë do të kryhet, kush do ta kryejë, cilat janë objektivat dhe rezultatet	
Kostot e përlogaritura:	
Data e propozuar e Fillimit të Punimeve:	
Data e parashikuar e Përfundimit të Punimeve:	
Skicat teknike/specifikimet e rishikuara:	Po/Jo

Të dhënat fizike	
Sipërfaqja e kantierit të nënprojektit në ha	
Zgjerim ose ndryshime në përdorimin e tokës ekzistuese	
A ka pronë ekzistuese?	
Planet për ndërtimin, lëvizjen e dherave, ndryshimet në mbulimin e tokës	

Informacioni Mjedisor Paraprak	Po/Jo	Nuk ka informacion	Detaje/Shënime
A përfshin ndërtim të ri dhe zgjerim të veprimtarisë veprimtaria e propozuar?			
A përfshin veprimtaritë e rehabilitimit veprimtaria e propozuar?			
A është veprimtaria e propozuar e përfshirë në Aneksin I të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor (lista e Projekteve për të			

cilat kërkohet VNM e plotë)?			
A kërkon veprimtaria e propozuar lloje të tjera VM-je sipas legjislacionit kombëtar?			
A do të përdorë projekti burime natyrore si toka, ujërat, materialet ose energjia, veçanërisht burime që janë të paripërtëritshme ose në sasi të kufizuar?			
A do të kryhen veprimtaritë e projektit në sitet e trashëgimisë arkeologjike ose kulturore apo mund t'i ndikojë ato?			
A krijon pluhur, ndotës ose lëndë të rrezikshme, toksike ose të dëmshme në ajër veprimtaria e projektit?			
A do të jetë burim zhurme dhe dridhesh projekti?			
A do prodhojë projekti sasi të konsiderueshme mbetjesh (të rrezikshme, të parrezikshme, inerte)?			
A do të gjenerojë projekti shkarkime të shtuara të ujërave të ndotura?			
A ka ndonjë veprimtari që do të shkaktojë ndryshime fizike të trupave ujqorë?			
A ka gjasa për ndryshime fizike të terrenit, ndotjes së tokës, ngarkesave të sedimentit, erozionit etj.?			
A ka ndonjë zonë në ose përreth vendndodhjes që përdoret nga specie të mbrojtura, me rëndësi ose delikate të faunës ose florës, për shembull për shumim, fole, ushqyerje, pushim, dimërim, migrim, që mund të ndikohen nga Projekti?			
A do të jetë Projekti në ose pranë disa zonave të ndjeshme ose të mbrojtura?			
A ka ndonjë zonë ose veçori me vlerë të lartë peizazhi ose pamore në ose përreth vendndodhjes që mund të ndikohet nga Projekti?			
A do të ndikojë ky Projekt ndonjë habitat kritik (pyll, ligatinë, moçalishte, ekosisteme ujore)?			

Informacioni Paraprak Social dhe për Tokën	Po/Jo	Nuk dihet	Detaje/Shënime
A do përfshijë ndërtime të reja fizike ndërhyrja?			
A përfshin ndërhyrja përmirësimin ose rehabilitimin e objekteve fizike ekzistuese?			

A ka gjasa që ndërhyrja të shkaktojë ndonjë dëmtim të përhershëm ose humbje të strehimit, pasurive të tjera, përdorimit të burimeve, duke përfshirë ato që mund			
A është vendi i përzgjedhur për këtë punë pa barrë dhe a ka nën zotërim tokë qeveritare/komunitare? A ka pasur përdorim të mëparshëm të tokave nga subjektet private duke përfshirë tokat publike/shtetërore? Nëse po, ju lutemi t'i nërshkruani ato			
A kërkon kjo ndërhyrje e projektit përvetësim të tokës private?			
Nëse vendi është në pronësi private, a mund të blihet kjo tokë nëpërmjet një zhvendosjeje të negociuar?			
Nëse ngastra e tokës duhet të merret, a janë madhësia aktuale e ngastrës dhe statusi i pronësisë të njohur?			
A do të humbasin pronarët e prekur të tokës më shumë se 20% të sipërfaqes së tokës së tyre / strukturës, për shkak të dhurimit?			
A ka njerëz pa titull pronësie që jetojnë/bëjnë biznes/kanë nën pronësi pasuri jo tokë (për shembull ndërtesa, gardhe etj.) në vendet e propozuara të projektit që do të përdoren për punime civile? A ka gjasa për ndikime të përkohshme?			
A duhet që persona të largohen nga toka, ose të mbyllin veprimtaritë e biznesit, tregtare/jetesës në mënyrë të përhershme ose të përkohshme (gjatë ndërtimeve)?			
A do të ketë humbje / dëmtim të tokave bujqësore, të mbjellave në rritje, pemëve?			
A do të ketë humbje të të ardhurave dhe kushteve jetesës?			
A ka ndodhur ndonjë përvetësim i mëparshëm i tokës dhe a është përvetësuar toka e identifikuar?			

Nëse iu përgjigjët me “Po” ndonjëherë nga pyetjet e mësipërme, ju lutemi t'i referoheni Kuadrit të Politikës për Zhvendosje të Projektit lidhur me masat zbutëse, dhe të njoftoni menjëherë ekipin e detyrave të Bankës.

Aneksi 2. Termat e Referencës për KMMS

Projekt

Republika e Shqipërisë
Projekti për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin (PZHIUT)
(P155875)

Termat e Referencës për Kuadrin e Menaxhimit

Mjedisor dhe Social (TeR)

Konteksti

Qeveria e Shqipërisë (QSH) është duke zbatuar një program reformues ambicioz me qëllim përshpejtimin e rritjes ekonomike, krijimin e vendeve të punës, forcimin e besimit tek qeverisja dhe përparim në procesin e integrimit Evropian. Pjesë e kësaj përpjekje e QSH-së është avancimi drejt një përjasje për zhvillimin rajonal. Projekt Ligji për Zhvillimin Rajonal është në fazën e fundit të miratimit dhe ka për qëllim të krijojë katër Hapësira për Zhvillimin Rajonal (HZHR) dhe Agjenci të Posaçme për Zhvillimin e Rajoneve. Kjo reformë ka për qëllim të arrijë (i) efekte të dukshme përmes një përjasje të integruar dhe harmonizimit të programeve në një territor të caktuar, (ii) forcimin e kohezionit për zhvillimin e territorit përmes zbatimit të strategjive të zhvillimit rajonal dhe në një afat të mesëm (iii) krijimin e kapaciteteve për përfitimin dhe përdorimin e Fondeve Strukturore të BE dhe financime të tjera. Kjo reformë është në hapat e para së bashku me proceset e tjera që nevojiten për zhvillim në nivel rajonal.

Qeveria e Shqipërisë gjatë viteve të mëparshme nëpërmjet Ministrisë së Zhvillimit Urban (MZHU) ka zhvilluar instrumente strategjike me rëndësi për zhvillimin e territorit në nivel kombëtar duke përfshirë Jugun e Shqipërisë. MZHU sapo ka përfunduar përgatitjen e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Territorit (SKZHT) dhe Strategjinë për Menaxhimin e Bregdetit (SMB). Këto dokumente strategjike (SKZHT, SMB) demonstrojnë një vizion të shëndetshëm dhe një drejtim strategjik për zhvillimin e vendit për 15 vitet në vazhdim (2015-2030).

Në kontekstin e reformës territoriale dhe me rritjen e konkurrueshmërisë për fonde, në hapësirat e reja fiskale, QSH-ja ka vendosur që Banka Botërore të fokusohet dhe të mbështesë Jugun e Shqipërisë në kuadër të Projekti për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin (PZHIUT). Ky rajon është konsideruar prioritet për shkak të pasurive natyrore dhe vlerave kulturore, presionit të zhvillimit i cili mund të ndikojë negativisht territorin në qoftë se planifikimi i qëndrueshëm urban nuk merr në konsideratë aspektet sociale dhe mjedisore. Projekt propozimi është parë si një mundësi për të demonstruar vlerën e një përjasje të integruar në nivel rajonal, veçanërisht me synimin e nxitjes së potencialit të kapitalit të sektorit privat. PZHIUT-ja pritet të luajë një rol të rëndësishëm dhe demonstrojë një përjasje të integruar inovative për zhvillimin rajonal në harmoni me SKZHT-në e re dhe SMB-në.

1. Informacione paraprake mbi Projektin

Objektivat e Projektit

Projekti i propozuar PZHIUT -së do të jetë një katalizator për zhvillimin rajonal në jug të Shqipërisë, duke nxitur përfitimin e fondeve nga partnerët e tjerë të zhvillimit dhe Fondi i Zhvillimit Rajonal. Projekti do të mbështesë vizionin e Qeverisë Shqiptare për të promovuar zhvillimin rajonal duke përmirësuar infrastrukturën urbane, rritjen e vlerave kulturore dhe forcimin e kapaciteteve institucionale për të mbështetur zhvillimin ekonomik vendor në zonat e përzgjedhura në jug të Shqipërisë. Projekti do të ofrojë një model për replikim në rajone të tjera për të përdorur një qasje të integruar për të nxitur ndihmat dhe sektorët konkurrues për një rritje të qëndrueshme ekonomike. Duke pasur parasysh se SKZHT-ja dhe SMB-ja kanë identifikuar turizmin dhe kulturën (turizmit i bazuar në kulturë) si një nga drejtimet kryesore të zhvillimit ekonomik në jug të Shqipërisë, projekti pritet të financojë aktivitetet që kanë për qëllim promovimin e zhvillimit të një ekonomie vendore të qëndrueshme, konkurruese dhe të larmishme duke vënë në dukje potencialin e njohur të sektorit të turizmit.

Komponentët e Projektit

Komponenti 1. Përmirësimi urban dhe përmirësimi i infrastrukturës (50 milion \$ amerikan). Ky komponent do të financojë hartimin dhe zbatimin e përmirësimit urban dhe përmirësimin e infrastrukturës komunale në qendrat e specializuara urbane të zgjedhura primare dhe zonave për rreth tyre. Ky komponent është i ndarë në dy nënkomponentë plotësues: Nënkomponenti 1A, i cili do të përqendrohet në qendrat e zgjedhura parësore dhe të specializuara me përmirësime urbane dhe investime për përmirësimin e infrastrukturës; dhe Nënkomponenti 2A, i cili do të përqendrohet në shtimin e pasurive të trashëgimisë kulturore dhe vendeve turistike përgjatë korridoreve që lidhin qendrat parësore dhe të specializuara. Investimet për përmirësimin urban dhe përmirësimin e infrastrukturës (Nënkomponenti 1A) pritet të përfshijnë përmirësimin e hapësirave publike (p.sh. parqet), rrjetet e rrugëve dhe infrastrukturën përkatëse (d.m.th. trotualet, dritat e rrugëve), rehabilitimin e infrastrukturës komunale bazë (p.sh. rrjetet e furnizimit me ujë), dhe restaurimi i fasadave dhe çatave të ndërtesave historike. Nënkomponenti A2 pritet të financojë nxjerrjen në pah të pasurive kulturore përmes restaurimit të pasurive të zgjedhura (d.m.th. muzetë, pazaret, vendet turistike) dhe përmirësimin e infrastrukturës mbështetëse, si aksesit i miljes së fundit, qendrat e vizitorëve dhe sinjalistika. Ky komponent do të financojë gjithashtu përgatitjen e studimeve të nevojshme të fizibilitetit, dizajnet inxhinierike, mbikëqyrjen e ndërtimit dhe aktivitetet e monitorimit dhe vlerësimit të projektit.

Komponenti 2. Ndërtimi i kapaciteteve institucionale (8.0 milion \$ amerikan). Ky komponent do të financojë aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve për të përmirësuar menaxhimin komunal dhe zhvillimin ekonomik vendor me bazë turizmin. Këto aktivitete do të bazohen në vlerësimet e kryera nga Programi 36 i Partneritetit Urban i administruar nga Banka dhe qeveria Austriake. Për më tepër, në njohje të rolit që njësitë e qeverisjes vendore luajnë në mbështetjen e zhvillimit ekonomik, ky komponent do të financojë edhe aktivitete që synojnë ta shfrytëzojnë në maksimum nxitësit e rritjes vendore, siç është turizmi. Këto mund të përfshijnë hartimin dhe zbatimin e planifikimit dhe menaxhimit të destinacionit, promovimin, mbërritjen vendore dhe fushatat e ndërgjegjësimit; aktivitetet e marketingut dhe promovimit; zhvillim i forcave të afta të punës; dhe aktivitetet e monitorimit dhe vlerësimit të performancës. Ky komponent mund të mbështesë edhe aktivitete që synojnë forcimin e produktit dhe lidhjeve të tregut midis sektorit të turizmit dhe ekonomisë vendore. Projekti nuk pritet të përfshijë aktivitete që ndikojnë në

planifikimin e përdorimit të tokës, siç është zhvillimi i planeve territoriale vendore ose investime që kanë ndikime të rëndësishme në mjedis.

Komponenti 3: Mbështetja e zbatimit (2.0 milion \$ amerikan). Ky komponent do të mbështesë zbatimin e projektit, duke përfshirë: (i) kontraktimin e ekspertëve vendorë për të ndihmuar njësinë zbatuese dhe komunat pjesëmarrëse në zbatimin e nën-projekteve; (ii) mirëmbajtjen e sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të projektit MV; (iii) kostot operative të lidhura me projektin e njësisë zbatuese përfshirë tarifat e këshillimit, shpenzimet e udhëtimit brenda vendit; (iv) trajnimin e stafit dhe personave të tjerë të lidhur me zbatimin e projektit; dhe (v) auditimin vjetor të llogarive të projektit.

Zona e propozuar e projektit

Projekti i propozuar pritet të përqendrohet në jug të Shqipërisë duke përfshirë zonën ndërmjet Vlorës dhe Sarandës duke mbuluar bregdetin dhe pjesën në brendësi (përfshirë Beratin, Përmetin dhe Gjirokastrën). Kjo zonë është te përmendur në SMB-në për turizmin e saj dhe potencialin kulturor të zhvillimit ekonomik. Projekti i propozuar pritet të mbështesë qendrat urbane parësore dhe të specializuara - siç është përcaktuar në SMB dhe SKZHT - në Jug të Shqipërisë dhe zonave për rreth tyre. Investimet pritet të përqendrohen në përmirësimin e infrastrukturës urbane në zonat e përzgjedhura urbane në jug të Shqipërisë dhe në rritjen e trashëgimisë së zgjedhur kulturore dhe pikat turistike përgjatë korridoreve lidhëse. Sipas financimit shtesë, shtohen edhe dy site të tjera, Ksamili dhe Orikumi, të cilat janë pjesë e Bashkisë Sarandë dhe Vlorë.

5. Marrëveshjet për Zbatimin e Projektit të Propozuar.

